

R E V

Revoluzioni Yt Financiar

FUQIA E PREHJES

O L U C

GARY KEESEE

I O N I

I dashur mik ne Krishtin,

Lutja jonë është që ky burim mësimor do të jetë bekim dhe inkurajim për ty! Të lutem ndihu i lirë ta ndash këtë material me miqtë, familjen dhe anëtarët e kishës tënde. Gjithashtu, mund të vizitosh FLNFree.com për të shkarkuar kopje shtesë dhe për më shumë mësimë në gjuhën tënde.

Perëndia të do dhe ka një plan të mrekullueshëm për jetën tënde! Të mësonim si operon Mbretëria e Perëndisë e ndryshoi jetën tonë për mirë, dhe besojmë se do të ndodhë njësoj edhe për ty!

Me dashuri në Krishtin

Gary dhe Drenda Keesee



P.S. Mos harro të vizitosh website-in tonë FLNFree.com për të shkarkuar më shumë nga mësimet tona falas në gjuhën tënde!

R E V

Revolucioni Yt Financiar

FUQIA E PREHJES

O L U C

GARY KEESEE

I O N I

Your Financial Revolution
The Power of Rest. Albanian. By Gary Keesee
Copyright © 2023 by Gary Keesee

Originally printed In English
ISBN:978-1-945930-03-4
Faith Life Now
P.O. Box 779
New Albany, OH 43054
1-(888)-391-LIFE

This book is a free gift from the author and is NOT FOR SALE

You can reach Faith Life Now Ministries on the Internet at
www.faithlifenow.com.

Botuar nga origjinali në Shqip
Revolucioni Yt Financiar
Fuqia e prehjes. Shqip. Nga Gary Keesee
E drejta e autorit © 2023 nga Gary Keesee

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta e autorit
© 2009 Shoqëria Biblike Shqiptare. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me
leje. Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas
përdorimit të tyre.

Ky libër është një dhuratë nga autori dhe NUK ËSHTË PËR SHITJE
Mund të kontaktosh me Faith Life Now Ministries në internet, në adresën
www.faithlifenow.com.

Dua t'ia kushtoj këtë libër bashkëshortes sime, Drendës, pasi kanë qenë inkurajimi, pasioni për gjërat e Perëndisë dhe dashuria për familjen e saj dhe për mua që më kanë frymëzuar gjatë gjithë këtyre viteve. Së bashku, ne e kemi vërtetuar se të gjitha ëndrrat bëhen vërtet realitet!

Gary Keese

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
KAPITULLI 1: Prehja - Bazat	11
KAPITULLI 2: Të drejtat ligjore	23
KAPITULLI 3: Përgjigjja jote është Mbretëria	41
KAPITULLI 4: Gjeta një çelës kryesor të Mbretërisë!	59
KAPITULLI 5: Të fluturosh është më mirë sesa të ecësh	71
KAPITULLI 6: Jeta ka gjëra më të rëndësishme sesa pagimi i faturave !	89
KAPITULLI 7: Kjo është e pamundur!	101
KAPITULLI 8: Racioni i dyfishtë	111
KAPITULLI 9: Mëse mjaftueshëm!	123
KAPITULLI 10: Misteri i racionit të dyfishtë	143

HYRJE

Dita që u larguam nga shtëpia në fermë ishte një ditë e hidhur, por edhe e ëmbël. Kishim jetuar në atë shtëpi ferme të vjetër, të vogël e të shkatërruar për rreth nëntë vjet dhe tani po ngarkoja kutitë e fundit në furgonin tonë. Po nisesha drejt shtëpisë sonë të re të cilën e kishim ndërtuar vetë: një shtëpi 715 metra katrorë, e stilit georgian, e vendosur mbi një fushë të bukur prej 22 hektarë në Ohajo, me 8 hektarë pyje dhe kënetë përreth. Deri para pak vitesh do të kishte qenë një ëndërr e vështirë për t'u imagjinuar.

Edhe pse po e linim shtëpinë në fermë, unë e doja atë shtëpi të vjetër. Po, me gjithë dritaret e thyera, qilarin e papastër dhe sulmet e vazhdueshme të bletëve për sa kohë jetuam atje. Sa shumë kujtime më vinin në mendje. Dy prej pesë fëmijëve të mi kishin lindur në dhomën e ndenjes.

Atje kishim kaluar shumë kohë të mira, por edhe shumë kohë stresi financiar dhe dëshpërimi. Na ishte dashur të mësonim shumë gjëra. Edhe pse tani është e vështirë ta imagjinosh, por kur u zhvendosëm në atë shtëpi të vjetër ferme nëntë vjet më parë, mezi arrinim që ta paguanim qiranë mujore prej 300 dollarësh. Të dyja makinat tona ishin shumë të vjetra dhe kishin përshkuar me qindra kilometra, megjithatë prapë i linim peng. Në atë kohë dukej sikur u kishim para borxh të gjithëve. Kishim dhjetë karta krediti të përdorura dhe të anuluar; dy hua kompanive financiare; sigurisht, pagesat për dy makinat tona; detyrimet ndaj IRS-së; dhjetëra mijëra dollarë që ua kishim borxh të

afermve, dhe lista vazhdon. Ne jetonim në mbijetese financiare, duke lënë peng shumicën e gjërave që zotëronim, ndonjëherë vetëm për të blerë ushqime. Gjërat që zotëronim ishin shumë të vjetra e të thyera dhe i kishim blerë të përdorura që në fillim.

Situata jonë financiare e mjerueshme e asaj kohe nuk premtonte aspak shpresë për një të ardhshme të ndritshme. Të jem i sinqertë, nuk shihja shumë shpresë se gjërat mund të ndryshonin. E doja familjen time, kisha një bashkëshorte të bukur, por po i zvarritja nëpër një ferr financiar!

Merrja antidepresantë, përballesh me kriza paniku dhe jeta ime konsumohej nga frika e përditshme. Shisja sigurime jete, jetoja me përqindjet dhe nuk nxitoja për askund, përveçse drejt humnerës financiare. Ngadalë po zhyteshim gjithnjë e më shumë në borxhe derisa nuk na mbetën më mundësi huamarrjeje. Pikërisht në këtë pikë unë u shkatërrova emocionalisht. Paniku dhe frika e pushtuan mendjen time. Kisha frikë edhe të dilja nga shtëpia, që, meqë ra fjala, nuk është gjë e mirë nëse do të fitosh përqindje nga shitjet.

Bashkëshortja ime kujtoi se do ta humbte bashkëshortin dhe frika se do t'i rriste e vetme katër fëmijët që kishim në atë kohë, e përndiqte atë. Por ajo është një besimtare e fortë në fuqinë e lutjes dhe nuk hoqi dorë nga unë. Së bashku u lutëm dhe më pas vendosëm të zbulonim parimet e Mbretërisë së Perëndisë. Ndërsa filluam të kërkonim përgjigje dhe parime nga Perëndia, shpresa nisi të gufonte në zemrat tona kur pamë mrekulli të njëpasnjëshme teksa i zbatonim ato që Perëndia na tregonte.

Një natë ndodhi një çast vendimtar kur Perëndia më tregoi se duhet të hapja kompaninë time në fushën financiare për t'i ndihmuar njerëzit të shpëtonin nga borxhet dhe për t'u mësuar parimet që Ai po m'i tregonte. Në atë kohë, të hapja një kompani për t'u treguar njerëzve se si të shpëtonin nga borxhet dukej disi e çuditshme, pasi ne kishim ende shumë borxhe për vete. Ne u lutëm për këtë, por Zoti na tha se, kur të lëviznim dhe të fillonim t'i jepnim mësim parimet e Tij, edhe ne do të gjenim liri. Hapja e kompanisë ishte një ecje me besim meqë nuk kishim asnjë ide se si ta bënim këtë, por nuk hoqëm dorë. Kompania u rrit dhe të ardhurat që solli e nxorën familjen tonë plotësisht nga borxhi në dy vjet e gjysmë. Në kapitullin e radhës do të flas pak më shumë për kompaninë tonë, por, tani për tani, dije se jeta

jonë ndryshoi në mënyrë drastike! Nuk ka mënyrë për ta shpjeguar se çfarë do të thoshte të ndiheshim të lirë, se si na dukej të futeshim në një distributor makinash dhe të paguanim me para në dorë për një makinë të re. Se si ndiheshim që e projektuam, ndërtoam dhe e paguam shtëpinë tonë të re. Ajo që po shijonim ishte përtej asaj që mund të kishim imagjinuar.

Po, shtëpia në fermë ruante shumë kujtime. Ndërsa shkova të merrja kutinë e fundit në shtëpi, kalova pranë gruas sime që po qëndronte në dhomën e vogël të ngrenies. Ajo më vështroi me lot në sy. Ata nuk ishin lot trishtimi; ata ishin lot gëzimi si dhe lot emocioni ndërsa ajo kujtonte gjithçka që Perëndia na kishte mësuar atje. Edhe unë po i përmbaja lotët teksa i hodha një vështrim të fundit dhomave me radhë, duke kujtuar me emocione të trazuara gjithçka që kishte ndodhur atje. Ne po e mbyllnim një kapitull të jetës sonë dhe po hynim në një territor të ri. Çfarë na priste tani? Udhëtimi sapo na kishte zhvendosur nga depresioni, mungesa e shpresës në një të ardhme plot shpresë. Kur dola jashtë me kutinë e fundit, ndalova dhe u ktheva për ta parë edhe një herë shtëpinë me një buzëqeshje. “Jo, nuk do të më marrë malli për ty. Tani kam një vend më të mirë.”

Sigurisht, ishte emocionuese që po zhvendoseshim në shtëpinë tonë të re. Por gjëja më e mirë e udhëtimit tonë ishte që më së fundi do të vinte prehja! Mund të mendoja për të ardhmen time dhe jo vetëm për të paguar faturat. Gjatë viteve, të jetuarit në prehjen e Tij ka qenë një ëndërr e vërtetë! Shlyerja e makinave tona është prehje. Shlyerja e borxheve është prehje. Shlyerja e shtëpisë së ëndrrave në truallin 22 hektarë është prehje. Buzëqeshja që shoh në fytyrën e bashkëshortes sime kur del të bëjë psonisje dhe nuk ka përse të shqetësohet për paratë

**NDËRSA FILLUAM TË KËRKONIM
PËRGJIGJE DHE PARIME NGA
PERËNDIA, SHPRESA NISI TË
GUFONTE NË ZEMRAT TONA
KUR PAMË MREKULLI TË
NJËPASNJËSHME TEKSA I
ZBATONIM ATO QË PERËNDIA
NA TREGONTE.**

është prehje. Përveç se kemi gjithçka që na nevojitet, të kesh para që të mund t'u japësh të tjerëve qindra mijëra dollarë dhe të mbështetësh Ungjillin është prehje. Por me siguri ndryshimi më i madh në jetën time ishte që nuk shkoja çdo ditë drejt presionit dhe frikës që e rrethonin

jetën time në ato vitet e mëparshme. Mundësia për të ëndërruar sërish për gjëra të mira dhe jo thjesht për të mbijetuar edhe një javë më shumë është prehje.

AJO QË DRENDA DHE UNË ZBULUAM ËSHTË NË DISPOZICIONIN TËND PO AQ SA ISHTE NË DISPOZICIONIN TONË.

Po, dita që po futja kutitë e fundit në furgon për të nisur udhëtimin drejt shtëpisë sonë të re ishte e ëmbël dhe e hidhur. Por më beso, ëmbëlsia e prehjes që Drenda dhe unë zbuluam ngadhënjente kaq shumë mbi

mendimet e hidhura të lënies pas të atyre kujtimeve, saqë u ndjemë sërish si dy fëmijë të moshës shkollore, duke qeshur dhe ëndërruar së bashku.

E di se çfarë po mendon. Ah sikur ta kisha atë gjë. Ah sikur ta kisha atë përvojë dhe të qeshja, ëndërroja sikur të mund të përqendrohesh në diçka tjetër përveç pagimit të faturave. Megjithëse mund të të duket e vështirë ta besosh në këtë pikë në libër, të siguroj se ajo që Drenda dhe unë zbuluam është po aq në dispozicionin tënd sa edhe tonin. Lutja ime është që, ndërsa ta tregojmë historinë tonë, edhe ti të inkurajohesh t'i zbatosh ligjet dhe parimet e Perëndisë në jetën tënde.

Në të vërtetë nuk është aq e vështirë; mjafton vetëm ta zbulosh fuqinë e prehjes!

Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirttrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!

– Mateu 11:28-30

KAPITULLI 1

PREHJA - BAZAT

TË PREHESH – të vendosesh ose mbështetesh në mënyrë që të qëndrosh në një pozicion të caktuar, një çast ose interval çlodhjeje ose ndërprerjeje të angazhimit në një veprimtari stresuese. (Google.)

A je i lodhur? A je i ngarkuar shumicën e ditëve dhe nuk e arrin kurrë qëllimin? A po i nxit nevoja jote për para vendimet e tua se ku do të punosh, si do të punosh dhe sa shumë do të punosh? A të duket sikur nuk do të shpëtosh kurrë nga borxhi? A të duket sikur po përjeton garën proverbiale të miut? Nëse po, nuk je vetëm.

A e ke parë ndonjëherë rrotën e kavjes? Jam i sigurt se po, por nëse nuk e ke parë, është një rrotë që vendoset në kafazin e kavjes. Kavja mund të ngjitet në rrotë dhe të vrapojë, e të vrapojë, e të vrapojë derisa të sfilitet. Por ajo rrotë ka vetëm një problem. Pavarësisht sa shpejt apo sa shumë vrapon kavja, kur lodhet shumë dhe zbret, ai gjendet në po të njëjtin vend ku e filloi. Asgjë nuk ka ndryshuar. Ai mund t'i fshijë djersët nga fytyra e tij me qime me një ndjenjë arritjeje. Por nuk ka arritur asgjë që mund t'i vlejë për pozitën e tij në jetë; ai është ende i mbyllur në kafaz dhe nuk gëzon liri. Kështu përmblihet pak a shumë jeta e shumë njerëzve sot, në mos e shumicës, si dhe jeta e tyre financiare. Ata lodhen shumë gjithë javës dhe bien të dërrmuar në një shpërqendrim të shkurtër në fundjavë; por kur vjen e hëna në mëngjes, ata e gjejnë veten saktësisht në të njëjtën vendndodhje si javën e mëparshme. Gjithçka që kanë bërë është që kanë mbijetuar edhe një javë.

Kjo ishte tabloja e jetës sime për nëntë vite të gjatë. Punoja 15 deri në 18 orë në ditë, isha i zellshëm dhe punoja fort, por pasi paguaja të dhjetën, faturat dhe taksat, nuk më mbetej asgjë. Zakonisht kisha më pak se sa më duhej dhe ngadalë e bëra zakon të merrja borxh për të mbijetuar. Kur rritej presioni financiar, unë vrapoja edhe më fort, por pa dobi. Kur ndaloja dhe e vlerësoja ecurinë time, kisha ecur së prapthi.

Sigurisht, kjo çoi në disa pasoja emocionale të rënda. Shkurajimi dhe frika që luftoja çdo ditë ndikoi me ngadalë në mendjen dhe në trupin tim fizik. Krizat e panikut, frika e madhe dhe paraliza filluan ta pushtonin me ngadalë trupin tim. Doktorët nuk arrinin ta gjenin se çfarë nuk shkonte tek unë. Frika i konsumonte kaq shumë mendimet e mia, sa që nuk dija nëse doja të jetoja apo të vdisja. Të jetuarit duke lënë peng gjëra dhe huazimi i parave nga të afërmit vazhdoi për rreth nëntë vjet! Tashmë nuk kishte më asgjë për të lënë peng dhe vlerësimi im për veten ishte shumë i ulët! Kisha marrë fund. Mund ta mblidhje me një kaci vetëvlerësimin tim së bashku me ndonjë gëzim që më kishte mbetur në jetë.

Kreditorët po rreshtoheshin për të më paditur dhe kjo ishte koha kur ndodhi! Telefonata erdhi në mes të dëshpërimit që rrethonte çdo frymëmarrje timen. Telefonata erdhi sikurse edhe telefonatat e tjera të mëngjesit: “Z. Keesee, siç e dini, ju i keni borxh klientit tonë shumë X para. Kur mendoni se mund të na e sillni? Epo, z. Keesee, kështu thatë edhe herën e fundit që ju telefonova. Nëse nuk na i sillni paratë për tri ditë, klienti im do t’ju padisë për këtë borxh. A e kuptoni Z. Keesee? Tri ditë. Mirupafshim.”

Telefonata më goditi si një tonelatë tullash. Jo se nuk e dija se sa e mjerueshme ishte situata jonë financiare. Nuk kisha para. Gjithçka që zotëroja ishte e thyer. Frigoriferin e kisha bosh. Familja ime e bukur po flinte afër vatrës së zjarrit për të qëndruar ngrohtë pasi nuk kishim para për naftë për ngrohje. Nuk kisha ku të drejtohesha. Miqtë dhe familjarët e mi ishin lodhur së paguari për jetën time. I pështjelluar, u ngjita me ngadalë nëpër shkallë deri në dhomën e gjumit dhe u shtriva mbi shtrat. Qava dhe i thirra Zotit për ndihmë.

Mendoj se u habita se sa shpejt më foli Zoti. Nuk ishte një zë i dëgjueshëm, por një zë që papritmas u ngrit me forcë nga shpirti im

deri në mendjen time. Gjëja e parë që më tha Zoti ishte që lëmshi në të cilin gjendesha nuk kishte asnjë lidhje me Të. Mendoj se e tha këtë pasi unë isha pak i pështjelluar se përse Ai, nga këndvështrimi im, nuk na kishte ndihmuar. Ne shkonim në një kishë të madhe, ishim bujarë kur mund të ishim dhe e paguanim të dhjetën në pjesën më të madhe të kohës. Përkundrazi, Ai tha se arsyeja përse gjendesha në këtë lëmsh ishte sepse nuk e kisha mësuar kurrë se si funksiononte Mbretëria e Tij. Ai më tha se Mbretëria e Tij nuk funksionon si mbretëria e tokës për sa i përket parave dhe, nëse doja të isha i lirë, më duhej ta mësoja sistemin e Mbretërisë së Tij për menaxhimin e financave.

Mbaj mend që zbrita me vrap poshtë dhe e kapa Drendën dhe i thashë se Zoti sapo më kishte folur dhe se përgjigjja ishte Mbretëria e Tij. Sigurisht, ishim pak të paqartë, pasi kujtonim se e kuptonim se çfarë ishte Mbretëria e Tij. Tek e fundit, sikurse thashë, ne shkonim në një kishë të madhe, të dy e donim Perëndinë dhe e dinim se ishim në rrugën drejt qiellit. Por, sikurse do ta mësonim së shpejti, në të vërtetë dinim shumë pak rreth Mbretërisë së Tij dhe se si funksiononte ajo.

Isha i emocionuar që Perëndia më kishte folur dhe ma kishte zbuluar përgjigjen – Mbretëria e Tij. Kuptimi i kësaj mbetej për t'u kuptuar më vonë, por isha i inkurajuar. Realiteti është se nuk e kisha idenë se çfarë nënkuptonte Perëndia me fjalën *mbretëri*. Por do të zbuloja se ajo fjalë përmbante vërtet përgjigjen që Drenda dhe unë e kishim dëshiruar dhe kërkuar.

Atë ditë, Drenda dhe unë bashkuam duart dhe u lutëm. Së pari, u penduam para Perëndisë që nuk kishim shpenzuar kohë për ta mësuar me baza Fjalën e tij dhe se si funksionon Mbretëria e Tij për sa i përket financave. Së dyti, u pendova para saj, si kryetar i familjes, që i kisha përfshirë në këtë lëmsh. U lutëm të dy dhe ramë dakord se ishim të vendosur për të mësuar se si funksiononte Mbretëria dhe për të jetuar një jetë ndryshe nga ajo që kishim jetuar për nëntë vitet e fundit.

Mënyra më e mirë për ta përshkruar atë që ndodhi më pas është të shohim një çelës drite. Hyr në një dhomë që është e errët dhe thjesht lëviz çelësin. Dritë! Mund të shohësh. Kjo ishte ajo që ndodhi kur Perëndia filloi të na mësonte për Mbretërinë e Tij. Ishte njëlloj sikur dikush të kishte ndezur një çelës drite dhe ne mund të shihnim atë që

nuk e kishim parë kurrë më parë. Ne filluam ta kuptonim se Mbretëria e Perëndisë është një qeveri me ligje që nuk ndryshojnë. E kuptuam se mund t'i mësonim ato ligje dhe të lidheshim me fuqinë dhe urtësinë e Perëndisë për të krijuar pasurinë që na duhej.

Ishim shumë të emocionuar, por ende shumë të pështjelluar. Shumë histori të mrekullueshme ndodhën ndërsa Perëndia filloi të na mësonte se si funksiononte Mbretëria e Tij. Nuk do t'i zbuloj këtu shumë nga ato historitë e hershme, pasi ato janë zbuluar në librin e parë të kësaj serie "*Revolucioni Yt Financiar: Fuqia e Besnikërisë*". Mund ta sigurosh një kopje të tij në adresën garykeese.com ose në Amazon.com. Duhet të marrësh gjithashtu librin tim "*Faith Hunt*" (Gjuetia e besimit) që të kthen në fillim fare kur Zoti filloi të më mësonte se si të siguroja nëpërmjet gjuetisë së drerëve. Por për t'i rënë shkurt, më lejo të të jap një shembull këtu.

Sikurse e thashë, ishim deri në grykë me borxhe e pa asnjë rrugëdalje. Detyrimet ndaj IRS-së, dyqanet e pengjeve, 10 karta krediti të përdorura dhe të anuluar dhe tri hua ndaj kompanive financiare me interes 28%. I kishim borxh dentistit, pastrimit kimik, prindërve tanë dhe miqve tanë. U kishim borxh të gjithëve. Nuk kishte shpresë në tokësoren. Biznesi im i shitjeve nuk po shkonte mirë, megjithëse punoja shumë. Por tani, pasi e pamë Mbretërinë të bënte disa gjëra vërtet të jashtëzakonshme (sërisht, lexoji historitë në dy librat e përmendur më lart), ne u inkurajam se përgjigjja jonë ishte Mbretëria. Nuk e kishim idenë se si, por ishim të sigurt se ishin në rrugën e duhur.

Më pas, një mbrëmje, Perëndia më dha një ëndërr dhe në atë ëndërr më tregoi se duhet ta lija kompaninë time aktuale me të cilën kisha qenë për nëntë vitet e fundit dhe të hapja kompaninë time: dhe, dëgjoje këtë, për t'i ndihmuar njerëzit të shpëtonin nga borxhet. E di, çmenduri, apo jo? Dua të them, po ta kisha ditur si të shpëtoja nga borxhet do ta kisha bërë këtë vite më parë. Por kjo është pikërisht ajo që bëri Ai. Në fakt, u trondita pak. Nuk e kisha idenë se si ta filloja kompaninë time ose çfarë përfshinte kjo gjë. Por një kompani për t'i ndihmuar njerëzit të shpëtonin nga borxhet? Ej, unë kisha vetë nevojë që dikush të ma thoshte këtë gjë!

Ndërsa fillova të lutesha për këtë, pata një përvojë jetëndryshuese

me Frymën e Shenjtë lidhur me mënyrën se si mund të ndodhte. Kjo ndodhi në një nga telefonatat e klientëve të mi për biznesin e sigurimeve. Ah, harrova të të them se, ndërkohë që ndodhi e gjithë kjo, isha në industrinë e shërbimeve financiare si shitës sigurimesh dhe titujsh. E di, është si ai hidrauliku me lavamanin që pikon, që rregullon problemin e çdokujt por lë pas dore të tijin. Megjithëse po dështoja ngadalë në pozicionin tim në shërbimet financiare, përvoja që kisha fituar në njohuri të përgjithshme në atë fushë gjatë nëntë viteve të mëparshme ishte tanimë shumë e rëndësishme për atë që Perëndia do të më tregonte së shpejti.

Ndërsa isha ulur me klientin tim dhe të shoqen në tryezën e kuzhinës së tyre, bëmë prezantimin e zakonshëm, që nënkuptonte një pamje të gjendjes së tyre financiare duke bërë pyetje të ndryshme dhe plotësuar atë që e quanim fleta e të dhënave. Këto të dhëna do të përdroreshin kryesisht për të përcaktuar se sa sigurim jete duhet të kishin. Ndërsa po shikonim listën e tyre të borxheve, të dy u shqetësuan dhe gruaja filloi të qante duke e përshkruar se sa të dëshpëruar ndiheshin të dy. Ata punonin të dy punë me kohë të plotë dhe nuk mbyllnin dot asnjë muaj.

Atëherë, pasi kisha jetuar vetë në atë mënyrë për nëntë vjet dhe me Perëndinë që kishte filluar të më mësonte mua dhe Drendën rreth Mbretërisë, mund ta imagjinosh se sa keq më vinte për ta. Ashtu si unë dhe Drenda, ata ishin të krishterë por pa asnjë njohuri se si funksiononte Mbretëria. Në atë kohë, nuk mund të shpjegoja vërtet shumë rreth Mbretërisë përveç disa gjërave fillestare që Perëndia na i kishte treguar, që i ndava me ta dhe, sigurisht, u tregova disa nga historitë e mrekullueshme që kishim parë të ndodhnin në situatën tonë.

Është e qartë se mund ta kuptoja që sigurimi i jetës nuk ishte problemi i tyre kryesor. Kalova pak kohë duke ua shpjeguar atë që po më mësonte Perëndia rreth Mbretërisë, por doja të bëja diçka që të mund t'u ofroja edhe përgjigje reale financiare lidhur me situatën e tyre.

Atë mbrëmje në zyrë, kur po mbyllja ditën time dhe po klasifikoja përgjigjet normal të skedarëve dhe mesazheve që duhet t'u përgjigjesha, papritmas më erdhi një mendim. Po sikur të shihja përtej problemit të sigurimit të jetës dhe t'i hidhja një vështrim të gjatë e të kujdesshëm të gjithë tablosë financiare? A kishte ndonjë gjë që mund ta bëja? Po sikur

të filloja të kërkoja për para? Ajo që dua të them me këtë është: po sikur të mund të gjeja mënyra më ekonomike për të bërë gjëra që tashmë po i bënin? Qëllimi im ishte i thjeshtë: të gjeja mënyra më ekonomike për t'i bërë gjërat që po i bënin tashmë dhe më pas t'i aplikonin paratë që gjenin në fluksin monetar dhe borxhin e tyre. Dukej si një propozim i thjeshtë, por nuk dija shumë për ndonjë fushë tjetër financiare jashtë fushës së sigurimeve të jetës. Dhe më duhet të them se kjo ishte përpara kohës së internetit. Kërkimi që do të duhej të bëja do të bëhej sipas mënyrës së vjetër: me telefon dhe në numërorin telefonik (faqet e verdha).

Punova për këtë një javë të tërë pasi më kishin planifikuar një takim me këtë klient përsëri javën e ardhshme. U habita se sa shumë para mund të liroja për përdorim në një muaj ndërsa gjeta kohën për të hetuar në thellësi secilën fushë. Kur mbarova, shuma arrinte deri në qindra dollarë në muaj. Mblodha me makinë llogaritëse të gjitha borxhet e tyre dhe më pas i përdora fondet e lira për pagesat e tyre të zakonshme mujore. Kur preka butonin e llogaritjes ia ngula sytë përgjigjes në ekran: 6,2 vjet. Përgjigja 6,2 vjet ishte koha e plotë që do t'i duhej klientit tim që t'i paguante të gjitha borxhet e tij, duke përfshirë hipotekën e shtëpisë, pa i ndryshuar të ardhurat. Po, e lexove saktë, pa i ndryshuar të ardhurat e tij mujore. U trondita dhe u binda se kisha bërë një gabim, ndaj e bëra llogarinë nga e para derisa u binda se kisha përgjigjen e saktë. A ishte e mundur kjo? Përse nuk e dinin të gjithë këtë?

Rrëmbeva shpejt dosjet e disa klientëve të tjerë që i kisha afër dhe bëra një skanim të shpejtë të tyre dhe gjeta të njëjtat rezultate. Secili prej tyre mund t'i shlyente borxhet për 5 deri në 7 vjet, duke përfshirë hipotekën, pa i ndryshuar të ardhurat mujore. Isha vonuar në zyrë duke i përfunduar llogaritjet e mia, por kur u nisa për në shtëpi, isha i gëzuar. Nëse ajo që gjeta ishte e vërtetë dhe të gjitha llogaritjet e mia tregonin se ishte, atëherë kjo ishte diçka e madhe, vërtet e madhe.

Isha kureshtar se si mund të reagonte klienti im ndaj këtij lloji informacioni. Për takimin tim të radhës vendosa t'i shtypja shifrat në një prezantim të thjeshtë njëfaqësh. Objektivi im ishte që thjesht t'u jepja atyre shpresë. Unë nuk fitoja asgjë, pasi e dija se nuk kishte gjasa t'ua shisja sigurimin e jetës. Por e dija se edhe ata do të donin të

dëgjonin se çfarë kisha zbuluar. Javën e ardhshme i rishikova sërish llogaritjet e mia dhe u binda se kisha të drejtë.

Kur i rashë ziles së derës, ndjeva një pritshmëri me ankth për takimin tonë. Ndërsa u ula në tryezën e kuzhinës, u thashë se çfarë kisha bërë gjithë javës me shifrat e tyre. Ua tregova me ngadalë numrat që kisha shtypur, duke ua shpjeguar se si kisha arritur te paratë që mund të liroja, së bashku me çdo emër kompanie dhe shifër që do të duhej për ta zbatuar atë që ua kisha treguar. E kuptoja që ata po emocionoheshin ndërsa paratë e përdorshme po shtoheshin. Por kur arrita në përfundimin se do të çliroheshin nga borxhi pas plotësisht 6,2 vjetësh, përfshirë ai i shtëpisë së tyre, me të ardhurat e tyre aktuale, të dy filluan të qanin, kësaj here me gëzim. Qëndruan të ulur aty me lotët që u rridhnin mbi faqe dhe nuk pushuan së thëni se sa të habitur ishin nga rezultatet. Ata kërcyen dhe më dhanë një përqafim dhe atë mbrëmje kaluam së bashku një kohë të mrekullueshme festimi.

Le të tregohemi të sinqertë: A do të të thotë IRS-ja se si të paguash më pak taksa? A do të të thotë bankieri se si ta shmangësh pagimin e interesit? Jo, i gjithë sistemi është ndërtuar për të t'i marrë paratë, jo për të t'i mbrojtur ato. E dija se ajo që kisha zbuluar duhej t'i mësohej çdo familjeje në Amerikë! Ajo mbrëmje pati një ndikim dramatik tek unë dhe doja që të bëja të njëjtën gjë për çdo klient që takoja.

Ndaj, i armatosur me atë informacion dhe me konfirmimin e ëndrrës që më dha Perëndia, Drenda dhe unë e lamë kompaninë e sigurimeve me të cilën punoja dhe hapëm kompaninë tonë, duke bërë pikërisht atë që kisha bërë për atë klient. Në ato vitet e para kompaninë tonë e quajtëm “Faith-Full Family Finances” (“Financat Familjare Plot Besim”). Emri e tregonte qartësisht se cili ishte qëllimi ynë: nëse e kuptojmë Mbretërinë dhe besimin, financat e tua do të mbusheshin. E pranoj se nuk ishte një emër shumë i mirë për një kompani – provo ta thuash dhjetë herë me radhë – por funksionoi. Më pas e ndryshuam emrin në “Forward Financial Group”, siç është sot dhe vazhdon të jetë i fortë.

Të jem i sinqertë, financat tona personale nuk ishte shtuar ende. Kishim ende gjithë ato borxhe për të shlyer, por e dinim se e kishim gjetur udhën që duhet të përshkonim. Kur e nisëm kompaninë tonë të

re, ishim të emocionuar dhe pak në ankth në të njëjtën kohë. Na u desh të mësonim se si krijohet dhe drejtohet një kompani, por pengesa më e madhe me të cilën u përballëm ishte se si të fitonim para duke e bërë këtë gjë. Sfidat jonë ishte se e ndienim se nuk duhet dhe nuk donim t'u kërkonim njerëzve para për t'i ndihmuar të çliroheshin nga borxhet. Kjo ishte një pengesë e madhe për të cilën kaluam shumë kohë duke u lutur dhe duke kërkuar alternativa. Pa kaluar në hollësi, Zoti na tregoi një strategji të jashtëzakonshme për ta krijuar kompaninë tonë dhe për ta pozicionuar atë për të nxjerrë fitime pa i faturuar klientët tanë.

Më pas, na u desh të gjenim një mënyrë për t'i përsheptuar llogaritjet e gjata me dorë që po bëja me të dhënat e klientëve të mi. E dija se më nevojitej një program kompjuterik i personalizuar për ta bërë atë që po bëja, por nuk dija asgjë rreth kompjuterëve ose se si ta gjeja një person për ta bërë atë gjë. Sërish, Perëndia bëri një punë të mrekullueshme. Mora një telefonatë nga një person shumë larg shtëpisë sonë, i cili kishte dëgjuar për ne. Ai donte të shihte si klient se çfarë bënim ne. I pëlqeu ajo që bënim dhe, ndërsa po flisnim, zbulova se ai ishte programues kompjuterësh dhe kishte kompaninë e tij me kohë të pjesshme. Fola me të për nevojën tonë dhe ai, me shumë entuziazëm, tha se dëshironte të na ndihmonte me atë që po bënim. I thashë se po fillonim kompaninë tonë dhe nuk kishim ende fondet për ta paguar për punën që na ofroi, edhe pse na kishte ofruar një ulje të madhe për punën e tij. Ai këmbënguli që ta bënte punën dhe tha se mund ta paguanim kur t'i kishim paratë. Dhe kjo ishte ajo që bëmë.

Njerëzit e pëlqyen biznesin tonë. Tek e fundit, përse jo? Ishte falas dhe njerëzve u pëlqen të gjejnë para dhe të çlirohen nga borxhet. Biznesi filloi mbarë dhe ne mundëm të çliroheshim nga borxhet në dy vjet e gjysmë. Shumë shpejt patëm mbi 300 përfaqësues që e përhapën planin tonë në mbarë vendin. Krahas mundësisë për të paguar me para në dorë për makinat tona, ne vazhduam të ndërtonim dhe të paguanim për shtëpinë e ëndrrave. Kompania jonë u rrit dhe na ka mundësuar të dhurojmë qindra mijëra dollarë për të mbështetur Ungjillin dhe njerëzit me kalimin e viteve.

“Plani për borxhin” siç e quajmë ne, vazhdon të jepet falas edhe sot, pas 30 vitesh. Misioni i kompanisë u rrit me kalimin e viteve. Ne

vazhduam të përqendroheshim në investimet për pension pas krizës financiare të vitit 2001 dhe sigurisht krizës së vitit 2008, ku miliona njerëz humbën 50% deri në 80% të kursimeve të tyre të pensionit. Ne studiuam mundësi të sigurta investimi dhe e hapëm atë sektor të biznesit tonë në vitin 2001. E them me krenari se, nga më shumë se njëqind milionë dollarë që i menaxhojmë aktualisht për klientët tanë, asnjë prej tyre nuk ka humbur as edhe një qindarkë të investimeve gjatë 16 viteve të shkuara të kaosit financiar në vendin tonë dhe në botë. Dhe sipas planit tonë, nuk ka asnjë pagesë, as tarifë administrimi, as komision të agjentit të përfshirë në fillim ose çdo vit për klientët tanë të investimeve. Nëse je lodhur së rrezikuarit me paratë e pensionit, mund të komunikosh me “Forward Financial Group” në numrin 1 (800) 815 0818 ose në faqen Forwardfinancialgroup.com për më shumë informacion.

E mrekullueshme apo jo? Një ide e thjeshtë nga Fryma e Shenjtë i ndryshoi jetët tona përgjithmonë! Po, na u desh ta provonim, por Perëndia na tregoi se ku të ecnim. “Geri, çfarë ndjeve kur u çlirove nga borxhet?” Paqe! Prehje! Mendoje pak. Ne kaluam nga keqfunksionimi i rëndë financiar në çlirim të plotë nga borxhet, duke paguar me para në dorë për makinat tona, shtëpinë tonë dhe gjithçka tjetër që na duhej. Për nëntë vite të gjatë kam përjetuar një presion të tejskajshëm çdo minutë të çdo dite. Nuk kisha prehje. Nuk kishte rëndësi se çfarë dite jave ishte, apo nëse ishte ditë pushimi. Nuk kisha paqe. Problemet e mia financiare më ndiqnin kudo që shkoja. Vuaja nga sikleti dhe poshtërimi i vazhdueshëm për shkak të gjendjes sonë financiare. Frika ishte shoku im i përhershëm, krizat e panikut dhe antidepresantët një mënyrë jetese në kulmin e dëshpërimit tim.

Me të gjitha ndryshimet financiare dhe, sigurisht, duke pasur të gjitha gjërat që na duheshin në rregull, ti mund të tundohesh të mendosh se financat tona personale në vetvete ishin fitorja. Po, ishte fitore e madhe që më në fund i kishim gjërat që na duheshin, por ngazëllimi i vërtetë ishte të shihnim se si funksiononte Mbretëria e Perëndisë. Ndërsa Drenda dhe unë e pamë Mbretërinë të funksiononte sërish e sërish, shpesh thoshim: “A e pe atë?”

Ashtu si me një çelës drite që ndizet, gjithçka është e qartë në

dritë; mund të shohësh. Të kesh mundësinë të shohësh pasi ke qenë i verbër dhe ke jetuar pa përgjigje është një përvojë e mrekullueshme. Gjetja e thesarit tonë të vërtetë, Mbretëria e Perëndisë, ishte thjesht e mrekullueshme. Është e thjeshtë të përpiqem të të them se si u ndjeva:

**NJË IDE E THJESHTË
NGA FRYMA E SHENJTË
I NDRYSHOI JETËT TONA
PËRGJITHMONË! PO, NA U
DESH TA PROVONIM VETË,
POR PERËNDIA NA TREGOI
SE KU TË ECNIM.**

për herë të parë në jetën time pati prehje!

Drama u ndërpre! Në të kaluarën, po të na shpohej goma e makinës, kjo kthehej në një krizë madhore emocionale. “Ku do t’i gjejmë paratë? A mund ta shtyjmë edhe pak me kartat?” Por sot, nëse për ndonjë arsye makina do të shpërthente, thjesht do t’i thosha sime shoqeje: “Çfarë ngjyre e do kësaj here?” Pa dramë, pa panik, pa

borxh, thjesht prehje. Ne mund t’i përmbahemi detyrës dhe qëllimit tonë. Nuk jetojmë më një jetë mbijetese, mund t’i kushtohemi JETËS!

Prandaj po ju them: mos u shqetësoni për jetën tuaj, për atë që do të hani ose do të pini, as për trupin tuaj, për atë që do të vishni. A nuk është vallë jeta më me vlerë se ushqimi dhe trupi më me vlerë se veshja? Vini re zogjtë e qiellit: ata nuk mbjellin, nuk korrin dhe nuk mbledhin në hambare; megjithatë Ati juaj qiellor i ushqen. A nuk vleni ju shumë më tepër se sa ata?

- Mateu 6:25-26

Gjatë këtyre 36 viteve të fundit, jam ulur me mijëra njerëz në tryezat e kuzhinës së tyre dhe i kam diskutuar financat e tyre në një nivel shumë personal. Kam folur me turma prej mijëra vetash në mbarë botën dhe një gjë që e gjej kudo ku shikoj është se çdokush kërkon prehje!!!! Çdokush e pret me padurim fundjavën, pushimet ose pensionin – për të ndaluar dhe për të pushuar.

Disa studime të fundit që kam lexuar kanë zbuluar se rreth 70% e amerikanëve nuk e pëlqejnë punën e tyre dhe nga ata 70%, 20%

nuk përpiqen dhe supozohet se e urrejnë punën e tyre. Përse shkojnë për të bërë diçka që e urrejnë? Në çfarë lloj stresi po jetojnë për të duruar kaq shumë dhimbje emocionale çdo ditë? Për ta thënë hapur, ata janë skllevër. (Të gjithë ishëm. Jemi rritur në një botë ku e vetmja mënyrë për të pasur sukses është të kesh para të mjaftueshme për të pasur mundësi. Por për shumicën e njerëzve nuk është kështu.) Ëndrrat e tyre për të pasur sukses veniten para një jete mbijetese ndërsa e gjejnë veten në punë pa rrugëdalje në të 30-at, 40-at ose edhe të 50-at.

Një statistikë e kohëve të fundit tregon se 69% e popullsisë amerikane nuk ka as një mijë dollarë kursime¹. Stresi dhe trauma emocionale në të cilën jetojnë shumica e njerëzve e shtrembëron sensin e tyre të identitetit dhe vetëvlerësimit. Ëndrrat mënjanohen për t'ia lënë vendin nevojave urgjente dhe ai që mbizotëron është zhgënjimi. Gëzimi largohet.

Mbaj mend që një ditë po flisja me një pastor rreth financave. Ai më tha se e donte shërbimin e tij dhe i donte njerëzit, por çdo ditë zgjohej me ngazëllim derisa i kujtohej situata e tij financiare. Ai e përshkroi si një re të madhe e të zezë që ia pengon dritën e diellit, ndërsa mendimet e shkurajimit formoheshin në mendjen e tij dhe e mbanin peng të një mendësie mbijetese, dëshpërimi financiar dhe skllavërimi pa vizion.

Në vend që të jetosh, shikon të tjerët se si fitojnë. Hollivudi ka fituar miliarda duke u treguar botës njerëz të tjerë që fitojnë në ekranin e madh. Njerëzit që nuk e shohin veten të fitojnë personalisht, gjejnë disa minuta për t'u arratisur nga monotonia e tyre dhe i jetojnë ëndrrat e tyre duke parë njerëz të përsosur që jetojnë jetë të përsosura në ekranin e madh.

TË JETOSH NJË JETË ME STRES FINANCIAR... NUK KA QENË PLANI I PERËNDISË NË FILLIM DHE NUK ËSHTË PLANI I PERËNDISË PËR TY SOT.

¹ Niall McCarthy, "Survey: 69% of Americans Have Less Than \$1,000 in Savings," *Forbes*, September 23, 2016, <https://www.forbes.com/sites/niallmccarthy/2016/09/23/survey-69-of-americans-have-less-than-1000-in-savings-infographic/#30d27351ae67>.

Sportet fitojnë aktualisht miliarda dollarë në vit nga spektatorët anembanë botës. Në vitin 2017, NFL fitoi më shumë se 7,8 miliardë; Super Bowl, rreth 15,5 miliardë; dhe kjo vetëm në një lojë!² 3 Njerëzve u pëlqen të brohorasin që të fitojë skuadra e tyre e parapëlqyer.

Por ajo që duhet të kuptojmë është se ne të gjithë jemi të paracaktuar dhe të krijuar për të fituar – të jemi në luftë, të jemi në lojë dhe në fund të fitojmë. Mungesa e shpresës financiare është normalja, jo përjashtimi, për shumicën e njerëzve – prandaj e vetmja arrati është duke jetuar jetën që e ëndërrojmë të gjithë nëpërmjet jetës së të tjerëve. Çfarë të tërheq në fitimin e lotarisë? Përse ishte aq e famshme shfaqja televizive “*Kush do të bëhet milioner*”? Përse janë skemat e pasurimit ende tundim sot? Përgjigjja? PREHJA! Të gjithë janë lodhur së vrapuari, të gjithë janë lodhur së u zgjuari me peshën e sigurimit për nevojat që ua rrëmbejnë ëndrrat. Por të jetuarit e një jete me stres financiar nuk është diçka e re; në fakt, ka ekzistuar për aq kohë sa njeriu ka qenë mbi tokë. Megjithatë, ky nuk ishte plani fillestar i Perëndisë dhe nuk është plani i Perëndisë për ty as sot.

² Michael David Smith, “Packers’ Books Show NFL teams Split \$7.8 Billion in National Revenue,” NBC Sports, <http://profootballtalk.nbcsports.com/2017/07/12/packers-books-show-nfl-teams-split-7-8-billion-in-national-revenue/>.

³ Joe D’Allegro, “Super Bowl Billions: The Big Business Behind the Biggest Game of the Year,” CNBC, January 22, 2017, updated February 2, 2017, <https://www.cnbc.com/2017/01/20/super-bowl-billions-the-big-business-behind-the-big-game.html>.

KAPITULLI 2

TË DREJTAT LIGJORE

Dëshpërim: ja kështu do ta përshkruaja jetën tonë përpara se ta kuptonim se si të prehemi. Nëntë vjet është një kohë e gjatë për të jetuar në kaos dhe stres financiar. Mbjaj mend se sa herë kam hedhur vështrimin nga ferma jonë 34 hektarë që e morëm me qira për 300 dollarë në muaj, që me vështirësi arrinim ta paguanim, megjithëse jashtë mase e lirë, dhe se si pyesnim veten nëse do të zotëronim ndonjëherë një tokë të tillë.

Pronari do të ndërtonte një fushë golfi në atë pronë dhe donte të linte dikë që të jetonte atje vetëm për ta ruajtur pronën derisa ta fillonte projektin, që e kishte parashikuar të ndodhte tre deri në pesë vjet më pas. Shtëpia e vjetër e fermës ofrohej “siç ishte” dhe ai nuk do të paguante asnjë riparim gjatë asaj kohe. Ne e morëm dhe pasi e lyem dhe pastruam mirë e mirë, shtëpisë së vjetër i ra një nur i veçantë. Plani ynë ishte të qëndronim atje për tre vjet, më pas të zhvendoseshim, por në tetë vjet atje ende nuk kishim arritur të zotëronim ndonjë gjë.

Pasi Perëndia më foli rreth Mbretërisë dhe si filluam t’i studionim dhe zbatonim parimet dhe ligjet e Mbretërisë, gjërat nisën të ndryshonin. Në fillim financat tona nisën të përmirësoheshin; u emocionuam shumë edhe me fitoret më të vogla. Më kujtohet se si bleva një makinë pjatolarëse për shtëpinë e vjetër dhe Drenda dhe unë ishim shumë të lumtur, sidomos ajo! Megjithëse ndonjëherë ndihmoja me larjen e pjatave, isha i zënë edhe me biznesin. Duke qenë se në atë kohë kishim katër fëmijë në shtëpi, ajo lante enë vazhdimisht. Mbjaj mend që, kur e sollëm makinën pjatolarëse, thashë diçka të tillë: “A të besohet që sapo e paguam me para në dorë makinën e re pjatolarëse?” E di që

po mendon: “Ua, çfarë ka kaq madhështore një makinë pjatolarëse e re?” Epo, që ta kuptosh më mirë, duhet të shihje pajisjet e tjera të shtëpisë sonë në fermë. Edhe soba, edhe frigoriferi ishin ngjyrë jeshile avokadoje dhe kishin 25 vjet. Prandaj, krahasuar me to, blerja e një makine pjatolarëse të re ishte një fitore e madhe për ne.

Në kapitullin e kaluar tregova se si Perëndia më dha një ëndërr dhe një plan për të filluar një biznes që do të bëhej përgjigjja ndaj kaosit tonë financiar. Mbase po mendon: “Do të doja që Perëndia të më thoshte diçka të tillë.” Lajmi i mirë është se Ai dëshiron ta bëjë këtë, por ka disa gjëra që duhet t’i dish lidhur me mënyrën se si funksionon Mbretëria përpara se të mund ta shfrytëzosh atë lloj ndihme. Drejtimi që mora atë ditë në ëndërr ndodhi vetëm për shkak të asaj që po na mësonte Perëndia rreth Mbretërisë së Tij dhe ishte një rezultat i drejtpërdrejtë i zbatimit të asaj çka na kishte treguar. Megjithëse e kam trajtuar me shumë hollësi Mbretërinë në librin tim të fundit, më duhet ta përsëris sërisht këtu për të krijuar një bazament mbi të cilin do të punojmë.

Njerëzit më pyesin se çfarë nënkuptoj me Mbretërinë e Perëndisë. Unë nuk kisha njohuri rreth Mbretërisë së Perëndisë edhe pse isha i krishterë. E dija se kur të vdisja do të shkoja në qiell, por nuk e kuptoja Mbretërinë e Perëndisë dhe mënyrën se si funksiononte në të vërtetë. Për ta kuptuar këtë koncept, ti duhet të kuptosh se çfarë do të thotë fjala *mbretëri*. Në kuptimin e drejtpërdrejtë, do të thotë sundimi i një mbreti. Mbretëria e një mbreti funksionon sipas fjalës së mbretit. Fjalët e tij bëhen ligji që e rregullon sundimin e Tij dhe jetën e qytetarëve të tij. Një koncept tjetër që lidhet me mbretërinë është që një turmë me miliona njerëz nuk përbën një mbretëri. Mbretëria nënkupton një qeveri me ligje që imponojnë ligjet e mbretit ndaj çdo qytetari të ligjshëm të asaj mbretërie. Ky koncept që Perëndia ka një Mbretëri me ligje të përcaktuara që janë në dispozicion të çdo qytetari të ligjshëm të Mbretërisë së Tij duket të jetë i pavlefshëm në pjesën më të madhe të Krishterimit. Shumica e të krishterëve besojnë se Perëndia vendos se cilave lutje u përgjigjet ose ndaj kujt e tregon favorin e Tij. Ata besojnë se nëse agjërojnë për një kohë shumë të gjatë ose bëjnë më shumë vepra shpirtërore për Perëndinë, atëherë do ta kenë pëlqimin e Tij. Miku im, ti e ke tashmë pëlqimin e Tij.

Ju, pra, nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjestarë të familjes së Perëndisë.

- Efesianëve 2:19

Ti je jo vetëm një qytetar i Mbretërisë së Tij, por edhe një pjesëtar i vetë familjes së Tij, një bir ose bijë e Mbretit. Galatasve 4 e bën shumë të qartë se çfarë do të thotë kjo për ty dhe për mua.

Edhe them se për sa kohë trashëgimtari është i mitur, nuk dallohet fare nga skllavi, megjithëse është zot i të gjithave, por ai është nën kujdestarë dhe administratorë deri në kohën e caktuar nga i ati. Kështu edhe ne, sa ishim të mitur, ishim të robëruar nën elementet e botës, por, kur u mbush koha, Perëndia dërgoi Birin e tij, të lindur prej gruaje, të nënshtuar ligjit, që të shpengonte ata që ishin nën ligj, që ne të fitojmë birërinë. Dhe, duke qenë se jeni bij, Perëndia dërgoi Frymën e Birit të tij në zemrat tuaja që thërret: “Abba, Atë!” Prandaj ti nuk je më shërbëtor, por bir; dhe në qoftë se je bir, je edhe trashëgimtar i Perëndisë.

- Galatasve 4:1-7

Ti je një trashëgimtar i një prone të tërë si bir ose bijë dhe ke të drejta ligjore si një qytetar i Mbretërisë së Tij! Lejo që kjo të depërtojë tek ti për një moment: ti e ke tashmë gjithçka. Ti e ke gjithçka dhe nuk të nevojitet asgjë. Prandaj, lëri përgjërimit dhe të qarat. Ti nuk mund të përgjërrohesh për diçka që e ke tashmë. Perëndia nuk merr një vendim rast pas rasti lidhur me atë që do ta ndihmojë ose jo. Kushdo që është një bir ose bijë e Perëndisë e ka tashmë ndihmën e Tij.

**NDJENJAT JANË GJË E MIRË
DHE UNË DUA TA NDIEJ
PRANINË E PERËNDISË,
POR KUR BËHET FJALË
PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
NUK DUHET TË NDIHEM I
SHPËTUAR PËR TË QENË
I SHPËTUAR. ËSHTË NJË
ÇËSHTJE LIGJORE.**

Më lejo ta krahasoj këtë me të qenit një qytetar i Shteteve të Bashkuara. Nëse je qytetar, atëherë ti e ke tashmë mbështetjen e qeverisë së Shteteve të Bashkuara për të zbatuar atë që thotë ligji. Ky përfitim u përfshi në qytetarinë tënde. Prandaj, ti nuk mund të agjërosh dhe lutesh aq sa duhet për ta fituar ndihmën e Tij; Ai ta ka dhënë falas nëpërmjet asaj që bëri Jezusi. Prandaj shijoje atë. Ti e meriton!

Edhe na ringjalli me të, dhe me të na vuri të rrimë në vendet qiellore në Krishtin Jezus, për të treguar në epokat që do të vijjnë pasurinë e pamasë të hirit të tij, me anë të mirësisë ndaj nesh në Krishtin Jezus.

- Efesianëve 2:6-7

Shprehja “*dhe me të na vuri të rrimë në vendet qiellore*” bën fjalë për pozicionin tënd të ligjshëm në Mbretërinë e Perëndisë. Jezusi është i ulur në anën e djathtë të Atit, edhe ti gjithashtu, meqë je trupi i Krishtit. Prandaj, ti je një bashkëtrashëgimtar me Jezusin i gjithçkaje që ka Perëndia. E di se është e pabesueshme të mendosh për këtë, por është e vërtetë. Ti i ke të gjitha; ti je i familjes dhe pjesë e biznesit të familjes! Por për shkak se djalli është munduar të fshehë gjithçka që ti je dhe gjithçka që ti ke, shumica e njerëzve, edhe të krishterët, jetojnë sikur të jenë ende të skllavëruar nga sistemi i mallkimit të tokës i mbijetesës!

Çelësi që e ndryshoi jetën time ishte kur e kuptova se ishte dhe është një qeveri me ligje dhe unë, duke qenë qytetar, kam të drejta ligjore dhe përfitime në Mbretëri. Ndjenjat janë gjë e mirë dhe dua ta ndiej praninë e Perëndisë, por kur bëhet fjalë për çështjet ligjore, nuk kam nevojë ta ndiej se jam i shpëtuar për të qenë i shpëtuar. Është një çështje ligjore. Nuk është nevoja të ndihem një qytetar i Shteteve të Bashkuara për të qenë i tillë. Unë e di tashmë se është një çështje ligjore që përmbushet nga fakti që unë kam lindur këtu. Kur ti je në pozitën e duhur përpara Perëndisë dhe jeta jote bazohet në ligj dhe jo në ndjenja, gjërat ndryshojnë!

Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson: Dhe nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij.

- 1 Gjoni 5:14-15

Mendo për një çast për këtë shkrim të shenjtë; ai është një ndër të parapëlqyerit e mi. Nëse unë kërkoj diçka sipas vullnetit të Tij, e di se Ai e dëgjon! Këtu nuk bëhet fjalë për valët e tingullit të zërit që dëgjohen me veshë. Kjo është një deklaratë ligjore. Imagjino një gjyqtar dhe sallën e tij të gjyqit. Nëse një gjyqtar vendos ta dëgjojë një çështje, kjo do të thotë se ai ka rënë dakord ta zgjidhë atë në bazë të asaj që thotë ligji. Në rastin tonë, meqë jemi lutur sipas ligjeve të Mbretit, ne e dimë tashmë se Ai do ta zbatojë ligjin e Tij. Për rrjedhojë, jemi të sigurt për rezultatin; nuk është nevoja të hamendësojmë.

Për shembull, Shtetet e Bashkuara nuk janë mbretëri pasi ato nuk kanë mbret, por funksionojnë sipas ligjeve që janë të barabarta për të gjithë dhe në dispozicion të çdo qytetari të ligjshëm. Në të njëjtën mënyrë, Mbretëria e Perëndisë rregullohet gjithashtu sipas ligjeve, që janë në dispozicion të çdo qytetari pa anshmëri. Historitë që lexojmë në Bibël nuk janë aty vetëm për të na zbavitur, por për të na i ilustruar ato ligje që t'i mësojmë dhe t'i përdorim. Jezusi e përdori shumë herë shprehjen “Mbretëria e Perëndisë është si” kur ua shpjegonte njerëzve se si funksiononte Mbretëria. Jezusi u referohej ligjeve të Mbretërisë kur tregonte shëmbëlltyra, duke dhënë një tablo vizuale se si funksiononin ligjet ose duke identifikuar pse ndodh diçka. Sërisht, për një farë arsye, njerëzit nuk e kanë konceptin që Mbretëria e Perëndisë ka ligje që e rregullojnë funksionimin e saj. Shumë veta mendojnë se Perëndia mund të bëjë gjithçka që dëshiron të bëjë kur e dëshiron, sepse Ai është Perëndi. Unë jam dakord që Perëndia ka fuqinë të bëjë gjithçka që dëshiron të bëjë; megjithatë, Ai kufizohet nga ligjet e Tij. E di se kjo mund të të duket e çuditshme, por për ta vërtetuar idenë time, le t'i hedhim një vështrim të shpejtë Markut 6.

Por Jezusi u tha atyre: ‘Asnjë profet s’është i përbuzur përveç në vendlindjen e tij, në faretisin e vet dhe në shtëpinë e vet’. Dhe nuk mundi të kryejë aty asnjë vepër të pushtetshme, përveçse shëroi disa të lëngatë, duke vënë mbi ta duart. Dhe çuditej për mosbesimin e tyre.

- Marku 6:4-6

Kur e lexove këtë shkrim të shenjtë me siguri të kanë bërë përshtypje

disa gjëra në atë faqe që mund të të japin një fare ideje për funksionin e Mbretërisë.

Ai nuk mund të bënte asnjë mrekulli....

Pikë së pari, shumë të krishterë as nuk e kanë parë këtë shkrim të shenjtë dhe do të debatonin menjëherë me ty se, po të thoshe se ka situata në Bibël ku Jezusi nuk mund të shëronte, do të gabohesh. Por siç mund ta shohësh, Ai nuk mundej. Pasi ta kuptosh se Mbretëria funksionon sipas ligjeve, atëherë ti fillon ta shohësh më në thellësi këtë histori. Kuptueshmëria standarde e shumicës së të krishterëve do të ishte se Jezusi zgjodhi të mos i shëronte ata. Kjo do të kishte kuptim logjik po të mos e kuptoje ligjshmërinë e Mbretërisë. Duke e ditur që Jezusi e kishte fuqinë për t'i shëruar por nuk e bëri dhe duke mos e kuptuar juridiksionin e ligjshëm, natyrshëm do të arrije në përfundimin se Ai zgjodhi të mos shëronte. Çfarë tjetër mund të jetë?

Mund ta kesh dëgjuar dikë të thotë: “Perëndia e lejoi të ndodhte” ose “Perëndia e di më mirë”, ose “Perëndia e ka gjithçka nën kontroll” ose diçka të ngjashme kur dikush përmend një problem ose vështirësi që ai vetë ose një mik është duke kaluar. Kjo është pika ku ndalon i krishteri i zakonshëm. Duke mos i ditur ligjet e Mbretërisë dhe atë që e pengoi në të vërtetë Jezusin, i vetmi përfundim në të cilin mund të arrijë është se mund të mos ketë qenë vullneti i Perëndisë për t'i shëruar ata. Miku im, Bibla nuk thotë se Ai zgjodhi të mos i shëronte. Thotë se nuk i shëroi për shkak se u mungonte besimi. Atëherë e kupton se pengesa për shërimin në këtë histori nuk ishte mungesa e dëshirës së Perëndisë për ta bërë këtë, por përkundrazi, ligjet shpirtërore të juridiksionit në fuqi që e ndaluan fuqinë e Perëndisë.

Në histori të tjera, do të kuptosh se kishte arsye ligjore përse fuqia e Perëndisë kishte juridiksionin për ta sjellë vullnetin dhe dëshirën e Tij në një situatë ose jo, ashtu sikurse në këtë situatë. Prandaj, është jashtë mase urgjente që ti të mësosh se si funksionojnë këto ligje të Mbretërisë. Një ditë kur mund të të duhet një prekje nga qielli, nuk është mirë që fuqia e qiellit të anashkalohej, por përkundrazi, të ketë lirinë ta prodhojë vullnetin e Perëndisë në jetën tënde. Dhe kjo është

pikërisht arsyeja përse e shkrova këtë libër.

Për ta nisur me të vërtetë udhëtimin tënd, do të të rekomandoja që ta nisësh me një mendje të freskët dhe të kuptosh se duhet t'i flakësh përgjigjet e vjetra fetare që i ke dëgjuar gjithë jetën tënde lidhur me arsyen përse Perëndia bën ose nuk e bën diçka. Shpresoj që ta kesh kuptuar se duhet ta refuzosh shpjegimin e zakonshëm që jepet sa herë i referohemi arsyes përse Xhoni i vogël vdiq në moshë të re: "Perëndia e di më mirë, Ai e ka kontrollin", etj. Jo, ti duhet ta DISH përse Jezusi nuk mundi të shëronte dhe ligjet që e rregullojnë rrjedhën e fuqisë së Perëndisë në mbretërinë tokësore.

Ti duhet të dish përgjigjen për pyetjen: "Përse nuk mund të shëronte Jezusi?" Për shumicën e njerëzve, fakti që unë them se ka një përgjigje për këtë pyetje i bën të skandalizohen. Por po të them vetëm atë që thotë Bibla dhe më lejo ta përsërit që ti DUHET ta dish me patjetër përgjigjen për atë pyetje.

Përgjigja e thjeshtë dhe e shkurtër që e shpjegon përse Jezusi nuk mund të shëronte në atë histori është se qielli nuk e kishte juridiksionin ligjor për ta bërë këtë. Ai juridiksion jepet me anë të besimit nga një burrë ose grua në mbretërinë e tokës, që është plotësisht i bindur për atë që thotë qielli. Megjithëse të dy biem dakord se Jezusi e kishte fuqinë dhe dëshirën për t'i shëruar njerëzit, Ai nuk mundi ta bënte. Jezusi Vetë tha se pamundësia për të shëruar nuk ishte një dobësi nga ana e Tij, por ishte për shkak se njerëzit nuk kishin besim. Mbaje shënim këtë! Ky është një çelës i rëndësishëm! Besimi!

Në librin tim të mëparshëm shpenzova shumë kohë duke shpjeguar se çfarë është besimi, si funksionon ai, përse kemi nevojë për besim, përse Perëndia kërkon besim, si e marrim besimin dhe si e dimë që

**PREMTIMET E TIJ NA JAPIM
NJË PREMTIM SHËRIMI,
RIPËRTËRITJEJE, RRIJTJEJE
FINANCIARE E PLOT TË
TJERA: JO VETËM TË TË
PASURIT TË AFTËSISË PËR
T'I DURUAR VËSHITËRËSITË
OSE FATKEQËSINË.**

kemi besim. Do të ishte pak të thosha se kuptueshmëria jote e këtij ligji bazë të Mbretërisë është i rëndësishëm. Është çështje jete ose vdekje!

Kohët e fundit mora një buletin informativ nga një shërbim shumë i njohur i krishterë. Fatkeqësisht, përmbajtja e tij ishte tipike e asaj që besojnë shumica e të krishterëve. Më lejo të të tregoj këtu një pjesë të tij.

Ai fillon me një fjalë të rëndësishme nga **Ligji i Përtërirë 31:6**:

Tregohuni të fortë dhe trima, mos kini frikë, mos u trembni prej tyre, sepse Zoti, Perëndia yt, është ai vetë që ecën me ty; ai nuk do të të lërë dhe nuk ka për të të braktisur”.

Në vazhdim thuhet...

“Përse nuk e ndalon Perëndia terrorizmin dhe vuajtjen? Përse lejon që njerëzit të vdesin? Pyetjet janë të shumta dhe e vërteta e kësaj çështjeje është se ne nuk i dimë të gjitha përgjigjet. Nuk e dimë përse Perëndia lejon të ndodhin gjëra të caktuara. Ajo që dimë është se dashuria e Perëndisë është e përsosur. Rrugët e Tij janë më të larta se rrugët tona. Ne duhet t’i besojmë premtimet e Tij që nuk na thonë se Ai do të na japë më shumë nga ç’mund të përballojmë, por pavarësisht se çfarë na jep, Ai do të jetë me ne në çdo hap të rrugës.”

GABIM, GABIM, GABIM! Në fakt, Bibla na thotë pikërisht të kundërtën.

Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.

- 1 Korintasve 10:13

Premtimet e tij na japim një premtim shërimi, ripërtëritjeje, rritjeje financiare e shumë më tepër: jo vetëm të aftësisë për të duruar vështirësitë ose fatkeqësinë. Dashuria e përsosur ofron zgjidhje të përsosura. Mund të vazhdoj më shumë, por fatkeqësisht, kjo është ajo që besojnë shumica e njerëzve për Perëndinë. Se si mund ta mendojë dikush se Perëndia, dashuria e të cilit është e përsosur, do t’i jepte dikujt kancerin apo do

të refuzonte të shëronte kur e ka fuqinë për ta bërë këtë gjë, është e pakonceptueshme për mua. Kur i pyesin për këtë, sërish përgjigja e tyre e zakonshme është se rrugët e Tij nuk janë rrugët tona. Shaka është kjo? Ne nuk kemi dashuri të përsosur dhe nuk do t'ia bënim këtë fëmijës sonë! Përkundrazi, Ai i tregon shumë qartë rrugët e Tij në Fjalën e Tij.

Buletini informativ nënkuptonte se çfarëdo që na jep, Ai do të jetë aty me ne në çdo hap të rrugës ndërsa e kalojmë. A do të na japë Perëndia diçka që është e keqe? Jo. Kur Bibla na thotë se Ai është me ne dhe nuk do të na lërë kurrë, kjo do të thotë se Perëndia është pranë nesh dhe do t'i mbështesë premtimet e Tij! Miku im, doktrina se Perëndia është armiku ynë nuk është nga Perëndia. Ajo nuk përfaqëson Perëndinë të cilit i shërbej dhe shpresoj që të mos e pranosh atë. Nëse kisha jote të mëson gjëra të tilla pa vlerë, duhet të largohesh menjëherë!

Perëndia është dashuri dhe Fjala thotë se dashuria nuk ligësohet kurrë. Megjithatë, ajo që zvogëlohet është juridiksioni i Perëndisë, aftësia e Tij për të ndërhyrë në mbretërinë tokësore, gjë e cila shkaktohet nga besimi ynë. Sërish, kjo është një çështje ligjore, jo emocioni, ndjenje apo diçka tjetër. Është thjesht një çështje ligjore që ti duhet ta dish. Sikurse e thashë, meqë njeriu ka juridiksionin në mbretërinë tokësore, Perëndia nuk mund të bëjë çfarë të dojë. Marrëveshja jote me qiellin, besimi yt, nevojitet për t'i dhënë qiellit juridiksionin për ta sjellë fuqinë e Perëndisë në atë situatë dhe për të prodhuar drejtësinë. Mik, ti **duhet** ta dish se çfarë është besimi dhe përse duhet të merret nga Perëndia.

Nëse nuk e ke lexuar librin e mëparshëm (*Revolucioni yt financiar: Fuqia e Besimit*), më lejo të ta përsëris shpejt se çfarë është besimi. Megjithëse mund të supozosh se çdo i krishterë që e përdor fjalën *besim* do ta dinte se çfarë është, gaboresh. Duhet të bëjmë një mësim të shkurtër historie që të mund ta kuptojmë konceptin themelor të Mbretërisë që lidhet me juridiksionin ligjor.

Le t'i hedhim një sy vargjeve të **Romakëve 4:18-21**:

Ai, duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: "Kështu do të jetë pasardhja jote". Dhe, duke mos qenë aspak i dobët në besim, nuk i kushtoi kujdes trupit të tij, i bërë tashmë si i vdekur (ishte pothuaj

njëqind vjeç) as barkut të vdekur të Sarës. Madje as nuk dyshoi nga mosbesimi në lidhje me premtimin e Perëndisë, por u përforcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte.

Abrahami njihet si ati i besimit tonë. Ai ishte plotësisht i bindur se Perëndia e kishte fuqinë për ta bërë atë që i kishte premtuar. Besim do të thotë të jesh plotësisht i bindur, në marrëveshje me Perëndinë. Pa atë marrëveshje, Perëndia nuk mund të lëvizë në mbretërinë tokësore. Ndaj mund të pyesësh: “Përse do të kishte nevojë Perëndia që dikush të bëjë ndonjë gjë që do ta lejonte Atë të bëjë diçka ose ta ndalojë Atë të bëjë çfarëdo gjë që zgjedh? Ai është Perëndia.” Për t’iu përgjigjur asaj pyetjeje, ne duhet të hedhim një vështrim që në fillim, gjatë kohës së Adamit.

Ti e bërë për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe e vure përmbi veprat e duarve të tua; Ti i vure të gjitha nën këmbët e tij.” Sepse, mbasi i vuri të gjitha nën pushtetin e tij, nuk la asgjë pa iu nënshtruar. Por tani nuk shohim ende që të gjitha janë nën pushtetin e tij.

- Hebrejve 2:7-8

Ky shkrim i shenjtë i referohet Adamit dhe Evës në kohën e krijimit. Vër re se nuk kishte asgjë mbi tokë që nuk ishte nën juridiksionin e tyre të ligjshëm. Adamin e vendosën mbi tokë për ta sunduar atë me autoritetin e deleguar në emër të Mbretërisë së Perëndisë. Ai e sundonte të gjithë tokën.

Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe”.

- Zanafilla 1:26

Edhe një herë shohim se Adami sundoi mbi tokë me autoritet të deleguar dhe u kurorëzua me lavdi (vajosja ose fuqia) dhe nder

(pozicioni i autoritetit). Nuk kishte asgjë që të mos ishte nën pushtetin e tij. Në fakt, nëse e lexon historinë e krijimit, Adami në fakt iu vuri emra kafshëve, meqë ai ishte sundimtari i të gjithë planetit. Siç e dimë të gjithë, Adami e humbi pozitën e tij të autoritetit për shkak të Satanit, i cili e mashtroi Evën dhe e tundoj Adamin të kryente tradhti kundër qeverisjes së Perëndisë, gjë që ai e bëri. Te 2 Korintasve 4:4, Pali regjistron se Satani, nëpërmjet tradhtisë së Adamit, u bë perëndia i kësaj bote. Ai nuk tha se ishte një perëndi, por përkundrazi, perëndia i kësaj bote, që do të thotë se kishte autoritet shpirtëror të ligjshëm mbi këtë vend. Megjithëse njeriu vazhdoi të jetonte mbi tokë, shpirtërisht ai ishte i vdekur për Perëndinë. Shpirti i njeriut, që ishte krijuar për të ecur në bashkësi me Shpirtin e Perëndisë, u nda prej Tij. Njeriu filloi të ecte sipas shqisave, mendjes, vullnetit dhe emocioneve të tij.

Pastaj djalli e çoi në një mal të lartë dhe, për një çast, i tregoi të gjitha mbretëritë e botës. Dhe djalli i tha: "Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse m'u dha mua në dorë dhe unë ia jap kujt të dua. Në qoftë se ti, pra, duke rënë përmbys, më adhuron, do të jetë krejt jotja".

- Lluca 4:5-7

Ti do të vësh re se Satani thotë se pozicioni që ai mban mbi mbretërinë tokësore iu “**dha**” atij. Sigurisht, ne e dimë se ai që ia dha atij ishte ai që e zotëronte ligjërisht në fillim, pra Adami. Kjo është e rëndësishme. Në fakt, nëse Satani do të ishte përpjekur të futej në mënyrë të jashtëligjshme në mbretërinë tokësore, do ta kishin flakur menjëherë dhe me forcë prej saj. Nëse mund të imagjinosh një oficer policie që thërret përforcime, do të krijosh një ide të mirë përse po them se Satanin do ta kishin larguar me forcë. Distinktivi që mban oficeri nënkupton se e gjithë forca dhe fuqia e qeverisë së Shteteve të Bashkuara janë në dispozicion për t'i mbështetur fjalët e tij.

Kurora që mbajti Adami (pozicioni që mbajti), sundimi në emër të qeverisë së Perëndisë, solli gjithë fuqinë e Perëndisë për ta mbështetur atë. Për shkak të pozitës së Adamit mbi tokë, Satani nuk pati asnjë juridiksion mbi mbretërinë tokësore. Ajo sundohej nga Adami dhe

Eva. Mjetet e vetme ligjore të Satanit për të fituar juridiksion në mbretërinë tokësore kërkonin që Adami ta hiqte kurorën e tij, gjë që Satani nuk kishte autoritet t'ia impononte për ta bërë. Satani e dinte se i vetmi person që mund t'ia hiqte atë kurorë Adamit nga koka ishte vetë Adami. Për këtë arsye Satanit iu desh të përdorte planin e tij të mashtrimit. Cili ishte ai mashtrim? Satani la të kuptohej se Perëndia nuk ishte i besueshëm dhe nuk e kishte për zemër interesin e tyre më të mirë. Ai ia mbushi mendjen Evës se bindja e saj ndaj Perëndisë nuk sillte asnjë përfitim dhe se ligjet e Perëndisë nuk po e lejonin atë dhe Adamin të shpërbleheshin me diçka të dobishme.

Satanit iu desh t'i bindte Adamin dhe Evën të besonin ose të bënin aleancë me të dhe jo Perëndinë.

Me fjalë të thjeshta, ky është besimi. Besimi mund të përkufizohet si të qenit “plotësisht i bindur” për atë që thotë Perëndia. Adami dhe Eva e braktisën besimin në Fjalën e Perëndisë dhe, në vend të kësaj, bënë marrëveshje me fjalët që tha Satani. Më pas vepruan sipas bindjes së tyre, që e anuloi qëndrimin e tyre të drejtë në Mbretërinë e Perëndisë dhe i dha Satanit një mbështetje ligjore për t'u përfshirë në çështjet e njerëzve. Rezultati? Adami, i cili pati autoritet mbi mbretërinë e tokës, u dëbua shpirtërisht nga Perëndia kur bëri aleancë me Satanin! Adami e braktisi kurorën e tij, pozicionin e tij të autoritetit për të ndjekur Satanin. Duke e bërë këtë, ai në thelb e dëboi Perëndinë nga jeta e tij. Shumë njerëz do të thoshin: “Jo, nuk është e mundur; Adami nuk mund ta dëbonte Perëndinë nga mbretëria tokësore!” Por për sa i përket çështjeve të njerëzve, është e sigurt që e bëri. Më lejo të ta vërtetoj. Shikoji sërish vargjet te **Zanafilla 3:17-19**. Pasi Adami kishte mëkatuar, Perëndia shkoi tek ai dhe i tha:

Toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frutin e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh”.

Vër re që thotë: “*toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd*”.

Të jesh i mallkuar do të thotë thjesht mungesë e pranisë dhe bekimit të Perëndisë. Më parë autoritetin mbi tokë e kishte Adami, i cili e kishte ndërprerë juridiksionin ligjor të Perëndisë në mbretërinë tokësore. Në thelb, Perëndia po thotë: “Hej, Adam, për shkakun tënd duart e mia janë të lidhura. Nuk mund të të ndihmoj.” Më pas ai i thotë Adamit se mbijetesa e tij tashmë do të ishte në dorën e tij, me punë të vështirë dhe mundim të madh. Këtë e quaj “sistemi i mallkimit të tokës” për mbijetesë. Këtu jemi rritur të gjithë, në mbretërinë e mbijetesës dhe frikës. Ne mësuan të shqetësohemi dhe frika i ka sunduar mendimet tona qysh nga lindja jonë. Dua të kthehem më pas në këtë shkrim të shenjtë për të diskutuar më tej sistemin e mallkimit të tokës, por tani për tani dua të sigurohem që e kupton se si Satani e fitoi të drejtën për të vepruar në mbretërinë tokësore. Sërish, atij iu desh të gjente një burrë ose grua në mbretërinë tokësore që kishte juridiksion ligjor të dhënë nga Perëndia në mbretërinë e tokës për t’ia hapur derën. Adami kishte çelësin dhe Satani arriti ta mashtronte Adamin që t’ia hapte derën. Tani, le të shohim sërish vargjet te Hebrejve 2:7-8.

Ti e bërë për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe e vure përmbi veprat e duarve të tua; Ti i vure të gjitha nën këmbët e tij.” Sepse, mbasi i vuri të gjitha nën pushtetin e tij, nuk la asgjë pa iu nënshtruar. Por tani nuk shohim ende që të gjitha janë nën pushtetin e tij.

- Hebrejve 2:7-8

Vër re që ky shkrim i shenjtë thotë se Perëndia nuk la asgjë pa iu nënshtruar. Megjithëse ky shkrim i shenjtë përmend një ngjarje të shumë kohëve më parë, ai përdor fjalën “*la*” në kohën e tashme për të përshkruar gjendjen aktuale të njeriut mbi tokë. Megjithëse njeriu e humbi autoritetin e tij shpirtëror në mbretërinë tokësore nëpërmjet mëkatit të Adamit, ai nuk e humbi banimin e ligjshëm në tokë, prandaj është përdorur fjala “*la*”. Për shkak të qëndrimit të tij të ligjshëm në tokë dhe për shkak të mbërthimit të fortë shpirtëror të ligjshëm të Satanit mbi njerëzit, Perëndia nuk mund të vijë furishëm në mbretërinë e tokës

e ta shkelë Fjalën e Tij, ose Satani do të akuzonte për shkelje.

Perëndia duhet të gjejë një burrë ose grua në mbretërinë tokësore që do të bëjë marrëveshje me Të, që hap derën shpirtërore që Mbretëria e Perëndisë të ketë juridiksion ligjor këtu. Ashtu si Satanit iu desh të kalonte përmes Adam rojtarit, tani Perëndia duhet të punojë nëpërmjet burrave dhe grave, rojtarë të tokës, për t'i dhënë Mbretërisë juridiksion këtu. Besim do të thotë ta kesh zemrën dhe mendjen plotësisht të bindur për atë që thotë qielli. Që Mbretëria e Perëndisë të ketë juridiksion këtu, besimi duhet të jetë i pranishëm. Nuk do të shpenzoj kohë për të shpjeguar se si të marrësh besim ose si ta kuptosh nëse qëndron në besim. E gjithë kjo është trajtuar në librin tim të parë të kësaj serie. Për qëllimin e këtij diskutimi, unë dua vetëm të sigurohem që ti e di se çfarë është besimi dhe përse është e nevojshme që qielli të zhvendoset këtu në mbretërinë tokësore.

Atëherë, shpresoj ta kesh kuptuar më mirë përse Jezusi “nuk mund” të bënte shumë mrekulli në qytetin e Tij të lindjes: njerëzit atje nuk kishin besim. Prandaj, qielli nuk kishte asnjë juridiksion. Më lejo ta përfundoj këtë diskutim me një shkrim të shenjtë të rëndësishëm që do ta ilustrojë atë që po them.

Çdokush ka dëgjuar për Romakëve 10:10:

Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.

Ky shkrim i shenjtë është pjesë e asaj që të krishterët e quajnë Rruga e Romakëve, një fragment me katër shkrime të shenjta që na tregojnë se si të shpëtohem. Por a ke ndaluar për të menduar mirë për procesin që të tregon Romakëve 10:10? Ti beson ose arrin një marrëveshje me qiellin në zemrën tënde. Zemra jote që është në marrëveshje me qiellin ligjëron pushtimin e tokës nga qielli. Ky shkrim i shenjtë thotë se kur ti e beson qiellin, shfajësohesh. Drejtësi do të thotë administrim i ligjit. Prandaj, besimi në zemër të jep të drejtën ligjore përpara qiellit dhe tokës të kesh atë që thotë qielli, për shkak se e ligjëron qiellin në mbretërinë tokësore. Por vër re që asgjë nuk ndodh ende. Ky shkrim i shenjtë ka edhe një pjesë të dytë: “... me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.”

Pra, edhe pse zemra jote mund të jetë në marrëveshje me qiellin, që i ligjëron qiellit të drejtën për ta pushtuar tokën, asgjë nuk ndodh derisa ti, një burrë ose grua në mbretërinë tokësore që ka juridiksion mbi tokën, nuk e çliron atë në mbretërinë tokësore. Përse? Sepse ti ke juridiksion këtu; qielli nuk e ka pa ty!

Në të vërtetë ju them se gjitha gjërat që do të keni lidhur mbi tokë do të jenë lidhur edhe në qiell; dhe gjitha gjërat që keni zgjidhur mbi tokë do të jenë zgjidhur edhe në qiell.

- Mateu 18:18

Në thelb, vargu thotë atë për të cilën fola. Çdo gjë që do të lidhësh në tokë, qielli do ta mbështetë dhe çdo gjë që do ta lirosh në tokë, qielli do ta mbështetë. Qielli nuk mund ta bëjë pa ty. Qielli po të pret ty dhe nuk mund të lëvizë pa një burrë ose një grua që ka besim ose marrëveshje me qiellin, që e çliron atë autoritet në mbretërinë tokësore.

Gjithë ndryshimi vjen kur e kupton se si ta çlirosh autoritetin dhe fuqinë e qiellit mbi mbretërinë tokësore. Ai e bëri në jetën time, si dhe në emailin vijues që mora.

“Përsëndetje! Unë dhe bashkëshorti im dëshirojmë t’ju tregojmë historinë tonë të mrekullueshme të ‘gjetisë së besimit’! Në vitin 2011, ne jetonim në ‘shtëpinë tonë të ëndrrave’, por me vështirësi e mbyllnim muajin dhe ndonjëherë përdornim kartat e kreditit për të paguar ushqimet dhe ngrohjen për shtëpinë tonë. Mbijetonim, nuk jetonim në bollëk. Unë isha drejtuesi i adhurimit në kishën tonë, por besimi ynë nuk ishte i lidhur me financat tona. Pashë programin tuaj *Rregullimi i Çështjes së Parave* në Daystar, që ma tërhoqi vëmendjen dhe e porosita librin *Rregullimi i Çështjes së Parave* bashkë me CD-të e “*Revolucioni Financiar*”. I dëgjonim gjithë kohës këto CD dhe ia lexuam librin njëri-tjetrit.

Nuk e dinim që na mungonte besimi! E dinim se për ta mbajtur shtëpinë e ëndrrave kishim nevojë për përgjigje për mënyrën se si funksionin paratë në Mbretëri. Ne mbollëm një farë 200 dollarë për “Faith Life Ministries” (që zëre se ishin 2000 mijë dollarë. Në atë kohë ishin shumë para për ne!) dhe bëmë marrëveshje me Perëndinë për të na treguar një punë që mund ta bëja në shtëpi.

Perëndia na dha një ide biznesi për rritjen e këlyshëve Goldendoodle në shtëpinë tonë. Ne blemë dy këlyshë Goldendoodle, Belën dhe Grejsin; i rritëm për të mbarështuar këlyshë dhe bëmë partneritet me Perëndinë. E dinim se vetë nuk mund të bënim këlyshë!! Ne i çiftuam 2 këlyshët tanë dhe në vitin 2014 patëm 13 këlyshë për t'i shitur në treg me çmimin 1200 dollarë secilin. Këtë vit, viti 2015, na kanë lindur 63 këlyshë, TË GJITHË të shëndetshëm. Nga shitja e këlyshëve ishim çliruar nga të gjitha borxhet tona, përveç atij të shtëpisë. Tanimë kishim edhe një fond emergjence plotësisht të financuar.

Për habinë tonë, mamaja ime na pyeti nëse i donim dy këlyshët e saj Goldendoodle për çiftim sepse ajo po dilte në pension! Perëndia na bekoj me 2 këlyshë të tjerë falas! Dhe në korrik, bashkëshorti im u ngrit në detyrën e administratorit në shkollën e mesme lokale!!! Brenda një viti të ardhurat tona u dyfishuan deri në 6 shifra!! GJUETIA E BESIMIT FUNKSIONON!! Ne i shfrytëzuam ligjet e Mbretërisë së Perëndisë. Tanimë, ne mbjellim për të gjitha llojet e punës së Mbretërisë dhe e ndjekim kishën tuaj në internet çdo të diel në mëngjes para se të drejtojmë adhurimin në kishën tonë lokale! Faleminderit që na mësuat se si funksionon Mbretëria!”

- Karla

I njëjti çift më dërgoi këtë javë një email lidhur me ecurinë e tyre.

“Gëzuar Pashkën! Ai u ringjall! Donim t’ju jepnim një përditësim për pastorin tonë në internet, Gerin! Njoftojeni atë se e festuam lindjen e Jezusit në Jerusalem këtë vit (e paguam me para në dorë). U bekuam gjithashtu me pagëzimin e djalit tonë adoleshent, Karterit, në lumin Jordan dhe adhuroam me kishën “Hillsong Australia” në Detin e Galileës në mbrëmje! Uaau! Jemi shumë mirënjohës që e rregulluam çështjen e parave!

Deri tani kemi pasur 121 këlyshë. Na u desh ta ngrinim çmimin e një këlyshi në 2300 dollarë për shkak se lista e pritjes ishte shumë e gjatë! Lavdi Perëndisë.”

- Karla

Ky është një shembull i përsosur i asaj që do të bëjë Mbretëria në jetën tënde. Pasi e mora këtë email, këtë javë i bëra Karlës një telefon dhe ajo u emocionua SHUMË!!! Ajo më tha se këtë vit do ta shlyejnë edhe shtëpinë e tyre. Nëse e shikon emailin e parë që dërgoi, në atë kohë ajo thotë sa vijon (cituat nga emaili më sipër):

“Me vështirësi e mbyllim muajin dhe ndonjëherë përdornim kartat e kreditit për të paguar ushqimet dhe ngrohjen për shtëpinë tonë. Mbijetonim, nuk jetonim në bollëk.”

Tani, vetëm disa vite më vonë, ata do ta shlyejnë shtëpinë? Mbretëria!

KAPITULLI 3

PËRGJIGJJA JOTE ËSHTË MBRETËRIA

Tani që ke një kuptueshmëri bazë se si Mbretëria funksionon sipas ligjeve dhe parimeve që nuk ndryshojnë kurrë, dua të fillosh të përqendrohesh te ligjet që kanë një ndikim të vërtetë në financat e tua dhe përfundimisht në prehjen tënde.

Por para se të kalojmë aty, dua të përkufizoj përse e kam titulluar këtë libër *Fuqia e prehjes* dhe çfarë nënkuptoj me fjalën *prehje* në kontekstin e financave dhe të Mbretërisë. Për çudi, nuk e kam shpikur unë këtë koncept të prehjes që lidhet me financat: Perëndia e ka shpikur.

Kështu përfunduan qielli dhe toka si dhe tërë ushtria e tyre. Ndërkaq ditën e shtatë Perëndia mbaroi veprën që kishte kryer dhe ditën e shtatë u çlodh nga gjithë vepra që kishte kryer. Dhe Perëndia bekoi ditën e shtatë dhe e shenjtëroi, sepse atë ditë Perëndia u çlodh nga gjithë vepra që kishte krijuar dhe kryer.

- Zanafilla 2:1-3

Së pari, më lejo të qartësoj këtë gjë: Perëndia nuk pushoi ditën e shtatë për shkak se ishte i lodhur. Perëndia nuk lodhet. Ai u çlodh sepse, siç thotë teksti, gjithçka kishte përfunduar dhe Ai e kishte kryer punën. Ai e krijoi njeriun në fund të ditës së gjashtë të krijimit për të jetuar në ditën e shtatë. Dita e shtatë nuk kishte mendime frike, mendësi mbijetese, sëmundje dhe mund apo djersë për të siguruar jetesën. Përkundrazi, mendimet e Adamit do të ishin vetëm te Perëndia, gruaja

e tij, detyra dhe qëllimi i tij. Gjithçka që i duhej për të kryer detyrën e tij dhe jetën e tij ishte e përgatitur dhe në dispozicion; plani i Perëndisë kishte përfunduar. Njerëzit sot ëndërrojnë të kenë atë që pati Adami, një ekzistencë të çliruar nga shqetësimi, me aftësinë për t'u përqendruar në pasionet dhe marrëdhëniet e tyre pa u shqetësuar fare për të siguruar për jetën. Fatkeqësisht, kur Adami u rebelua, ai e humbi providencën e Perëndisë dhe, që nga ajo kohë, njeriu është detyruar t'i kërkojë (me mund e djersë) gjërat e jetës.

Sepse janë paganët ata që kërkojnë të gjitha këto gjëra; Ati juaj qiellor, pra, e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto gjëra. Por para së gjithash kërkon mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t'ju shtohen.

- Mateu 6:32-33

Pesha e gjetjes së providencës ishte një barrë e rëndë dhe e shtrembëron perceptimin e njeriut për jetën. Joshja e pasurisë, lirimi nga munda dhe kërkesat sflitëse të mbijetesës janë ato çka ëndërrojnë njerëzit.

**TË GJITHA PËRGJIGJET QË TË
DUHEN PËR T'U BEGATUAR
DHE PËR T'IU PËRMBAJTUR
DETYRËS, DUKE MUNDUR TË
ZBULOSH QËLLIMIN TËND,
GJENDEN TE MBRETËRIA.**

Të qenit milioner ka kuptim vetëm nëse ekziston aftësia për ta lehtësuar stresin dhe peshën e sigurimit për jetën, duke na lejuar të përqendrohemi te qëllimi dhe detyra. Lotaria është jashtëzakonisht e përhapur

për shkak se ofron providencë të pashoqëruar me punë dhe arratisje nga sistemi financiar i mallkimit të tokës. Skema për pasurimin e shpejtë gjen plot në çdo formë dhe vazhdimisht i bombardojnë emaillet dhe publikimet në Facebook. Pra, në kontekstin e financave tona, ne duhet t'i përgjigjemi një pyetjeje: A ka ndonjë mënyrë për t'u kthyer në ditën e shtatë ku gjithçka është e plotë, e pacenuar dhe në dispozicion? Përgjigjja është një PO e madhe! Mënyra si ndodh kjo dhe të kuptuarit

e ligjeve të Mbretërisë që do ta prodhojnë atë lloj rezultati janë qëllimi i këtij libri. E di se nisur nga përvoja jote jetësore ose edhe me kishën e të krishterët mund të argumentosh se ajo që po them nuk mund të jetë e vërtetë, pasi shumë të krishterë kanë përçafuar teologjinë “varfëria është e shenjtë”. Por të siguroj se të gjitha përgjigjet që të duhen për t’u begatuar dhe përmbushur detyrën, duke mundur ta zbulosh qëllimin tënd, gjenden te Mbretëria.

Lum ju, të varfër, sepse juaja është mbretëria e Perëndisë.
- Lluca 6:20

Përgjigja për varfërinë është Mbretëria! Ky është shkrimi i parë i shenjtë ku më drejtoi Perëndia kur filloi të më mësonte ligjin financiar të Mbretërisë. Sigurisht, për ta përvetësuar këtë koncept duhet të dish se çfarë nënkupton koncepti mbretëri, që e kam përmendur tashmë. Dhe mendoj se duhet të kesh një kuptueshmëri të qartë të asaj çfarë ndodhi në të vërtetë në Kopsht kur Adami mëkatoi. Prandaj, më lejo të gjej një çast për një përsëritje të shpejtë.

Në fillim Adami dhe Eva nuk shqetësoheshin për asnjë gjë; asnjë sëmundje, asnjë problem providence nuk i konsumonte mendimet e tyre çdo ditë. Çdo ditë, e vetmja gjë që duhet të mendonin ishte detyra e tyre, që ishte ta donin Perëndinë, ta donin njëri-tjetrin dhe të kujdeseshin për tokën dhe Kopshtin që u dha Perëndia. Frika mungonte plotësisht në jetën e tyre. Por kur Adami kreu tradhti, kuptohet që gjithçka ndryshoi. Sikurse thashë, Satani u bë perëndia i kësaj bote, njeriu u nda nga Perëndia dhe Perëndisë iu ndërpre juridiksioni i ligjshëm mbi njeriun. Adami u përball i tronditur me një realitet të ri të mënyrës si funksionon jeta. Sërish, ja cilat janë fjalët që Perëndia ia solli Adamit pasi ai mëkatoi.

Toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frutin e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh”.

- Zanafilla 3:17

Mundi, djersa, frika, shqetësimi dhe mendësia e mbijetesës janë ato që tanimë i konsumojnë mendimet e Adamit dhe Evës. Qëllimi i tyre, që ishte plani që Perëndia kishte për ta, tashmë ka humbur në garën dhe në betejën për të mbijetuar. Detyra e mrekullueshme e Adamit, qëllimi i tij është venitur tashmë nga shqetësimet e jetës dhe nevoja për providencë. Ai e ka të paqartë identitetin e tij. Qëllimi i vetëm që mund të shohë tani është të mbijetojë, që kërkon mund të vazhdueshëm dhe djersitje. Që nga ajo ditë e deri më sot nuk kanë ndryshuar shumë gjëra.

Sot, si pastor, shoh se pyetja më madhore që më bëjnë njerëzit është: “Çfarë duhet të bëj me jetën time?” Arsyeja përse e bëjnë pyetjen është sepse, në mbretërinë tokësore, që nga koha e Adamit, kërkimi i providencës është qëllimi me anë të të cilit matet gjithçka. Zakonisht vendimet merren në bazë të parave dhe jo qëllimit. Paraja dhe nevoja për to mund t’i detyrojë njerëzit të pranojnë punë që i urrejnë. Në realitet, shumica e njerëzve nuk e kanë idenë se kush janë në të vërtetë. Fiksoje këtë gjë: “Pa e njohur Perëndinë, nuk do ta njohësh kurrë projektin e Tij për jetën tënde. Ai është Krijuesi yt.”

Njerëzit janë shumë të uritur për të zbuluar se kush janë. Në botë duket sikur janë thjesht një numër, por për Perëndinë ata janë shumë të veçantë dhe krijim unik me aftësi dhe potencial që nuk i ka askush tjetër. Por për shkak se nuk e njohin Perëndinë dhe, për rrjedhojë nuk e njohin as veten, ata e kërkojnë vlerën e tyre në të gjitha vendet e gabuara. Ata lejojnë që kultura t’ua diktojë vlerën e tyre duke e pranuar atë që thotë ajo. Por imazhi që portretizon media dhe pasqyra e kulturës janë së bashku hije që ndryshojnë. Kur mendon se ke arritur të ecësh në përputhje me atë që quhet e pranueshme, do të zbulosh se ka ndryshuar dhe je shumë mbrapa.

Më kujtohet kur isha në Paris dhe po ecja nëpër rrugë me Drendën. Sigurisht, Parisi është i njohur për modën; dhe moda e atij viti ishte e gjitha me ngjyrë gri dhe të zezë. Çdo vitrinë dyqani ishte e mbushur vetëm me veshje gri dhe të zeza. Teksa hodha një vështrim më tutje në rrugë, në të dy drejtimet, arrita të shihja qindra njerëz që ecnin. U trondita kur nuk pashë asnjë grimcë ngjyre. Çdo person i mundshëm, pa përjashtim, ishte i veshur me gri dhe të zeza. Kishte me qindra e

qindra njerëz që dukeshin të gjithë njëloj. Kur ishte hera e fundit që dikush të ka thënë se ngjyra e tyre e parapëlqyer ishte grija? Por atë ditë turmat ishin të sigurta se ngjyra e tyre e preferuar ishte e zeza ose grija.

Për shkak se presioni për të gjetur providencë është kaq i fortë dhe e shtrembëron identitetin tonë për çdo gjë që mendojmë se do të na ndihmojë ta gjejmë dhe të jemi të pranuar, unë dhe Drenda shpikëm një thënie që kemi vite që e predikojmë: “Nëse nuk e rregullon çështjen e parave, nuk do ta zbulosh kurrë fatin tënd!” Të qenit skllav i mbijetesës të jep shumë pak kohë për të hetuar ose krijuar shumë mundësi. E vërteta është, sikurse e kam thënë, shumicën e kohës njerëzit marrin vendime bazuar në qëllimin e tyre për të gjetur ose grumbulluar providencë. Ata e braktisin pasionin për një çek page dhe vizionin e tyre për providencën. Fakti është se jemi shtypur kaq shumë nga mendësia jonë e mbijetesës me mund e djersë, sa që kemi reshtur së ëndërruari. Frika i mban peng ëndrrat tona dhe mungesa e providencës i mban ëndrrat tona të burgosura të së pamundurës.

Më kujtohet kur ëndrra ime ishte të kisha naftë të mjaftueshme për të arritur në shtëpi, e kurrsesi diçka me rëndësi jetëndryshuese. Në ato ditë, radari im nuk tregonte vizione të mëdha. Gjithë imagjinata ime e mundshme konsistonte në pagimin e qirasë mujore. Më duhet ta pranoj se është e vështirë të shohësh përtej mbijetesës kur je i stresuar për ushqimin ose përballesh me shqetësime financiare tepër urgjente.

Kur Adami e dhuroi Mbretërinë, jetën e tij e pushtoi një botë krejt e re e vdekjes, frikës, mbijetesës dhe panikut. Jam i sigurt se të gjithë ne e dimë se çfarë do të thotë të ndiesh frikë. Më kujtohen histori të panumërta në jetën time të panikut, turpit dhe frikës ndërsa vuajta ato nëntë vite të gjata të kaosit financiar, duke u përballur përfundimisht me kriza paniku, si dhe të jetesës me antidepresantë. Të jetuarit në sistemin të mallkimit të tokës për mbijetesë na ka mësuar të gjithëve të kemi një këndvështrim negativ për jetën. Disa përballesh me të më mirë se të tjerët, por pa Krishtin, kjo mendësi negative na thotë vazhdimisht se nuk jemi të mirë sa duhet.

A ke dëgjuar ndonjë të thotë: “Mos shpreso kot”? Kur isha fëmijë, sa herë që emocionohesha për diçka që babait tim i dukej marrëzi, ai më thoshte: “Do rritesh një ditë.” Për këtë arsye zakonisht nuk e lejoja

veten të ëndërroja për diçka përveçse për atë që im atë e përcaktonte si të nevojshme. Besoj se im atë ishte lënduar nga rritja në fëmijëri në një shtëpi të alkoolizuarish dhe kjo ishte ajo që duhet të bënte ndërkohë që rritej.

Të jem i sinqertë, ne të gjithë kemi që nga lindja që jemi profesionistë të shqetësimit. Frika është një gjuhë e zakonshme në mbretërinë tokësore. Po të ndalosh dhe ta mendosh, fjala *jo* është gdhendur aq shumë në ne që nga koha që lindëm. “Jo, nuk mund ta marrësh atë.” “Jo, vëre prapë në vend.” “Jo, nuk mund të shkosh atje.” “Jo, nuk mund ta blesh atë.” Një ditë reshtëm së thëni “po” për gjithçka përveçse arratisjes së herëpashershme në një aktivitet siç është gostia me ushqimin tonë të parapëlqyer, që na e mpin mendjen ndaj rrethanave të tanishme.

Një studim vlerëson se fëmija i zakonshëm e dëgjon fjalën *jo* ose *mos* mbi 148 000 herë gjatë rritjes, krahasuar me vetëm disa mijëra mesazhe *po*.⁴

Kohët e fundit zhvillova një konferencë vjetore për providencën dhe në platformë vendosa një Ferrari të vitit 2017, një makinë sigurisht për t’u admiruar. Pronari i makinës frekuenton kishën time dhe e pagoi me para në dorë atë, që do të thotë rreth 400 000 dollarë. Ndërsa pjesëmarrësit futeshin brenda, ata e admiruan dhe ia ngulën sytë makinës, duke i hedhur të gjithë një sy, me dëshirën për ta parë nga afër. Por megjithëse e admiruan makinën, ideja që doja të përcillja duke e vendosur atë mbi platformë ishte që të mos frymëzohen për një jetesë me synime materiale, por përkundrazi, për t’u dhënë një mësim. Njerëzit u mblodhën të gjithë rreth makinës, duke thënë pa përjashtim se do të donin ta ngisnin atë.

E dija se trajnimi “jo” që kishin bërë në sistemin e mallkimit të tokës me mund e djersë po thërriste në të pandërgjegjshmen: “JO, nuk do të zotërosh kurrë një makinë të tillë! Jo, nuk do të kesh kurrë para për ta blerë; as mos të të shkojë nëpër mend.” Për shkak të trajnimit “JO” që kanë marrë, që të gjithë ne e kemi marrë, shumica prej të pranishmëve as nuk e kanë konsideruar ndonjëherë të zotërojnë një Ferrari për shkak se mendësia “jo” as mund ta imagjinojë, e as mund ta marrë atë. Megjithatë, nëse do të vazhdoja t’i ndryshoja makinat tona

çdo orë, nga më e shtrenjta te më e lira, në fund fare, do të ngjisja në platformë një makinë për të cilën do të mendonin dhe thoshin: “Më pëlqen ajo makinë; duhet ta blej një të tillë.”

Cili ishte ndryshimi? Gjithë puna ishte se si e shihnin veten, potencialin e tyre dhe koston e makinës. Po, mund të ketë pasur të pranishëm që i kanë thënë vetes: “Një ditë do ta kem atë makinë” ose mund të ketë pasur të pranishëm që kishin para dhe e shihnin makinën me një sy tjetër. Por jam i bindur se për shumicën, zotërimi i një makine të tillë nuk përfshihej fare në mendimet e tyre. Në fakt, milioneri që e kishte paguar makinën me para në dorë ka rreth gjashtë Ferrari. Për mendësinë e tij është thjesht një makinë e mrekullueshme. Kur e pa makinën, ai e përfytyroi sikur e zotëronte dhe filloi procesin e porositjes nga Italia dhe më pas të dërgimit në shtëpinë e tij në SHBA. Ai nuk e pati të vështirë të vepronte në bazë të vizionit të tij për shkak se e kishte providencën. Ja se cili është një çelës i rëndësishëm i prehjes – providenca është vizion paraprak.

Çelësi kryesor:

Providenca është vizion paraprak

Pa providencë nuk ka vizion; ka vetëm mbijetesë. Sistemi i mallkimit të tokës me varfëri na i ka rrëmbyer ëndrrat dhe të ardhmen tonë. E di se Ferrari ishte një ilustrim ekstrem, por e qartësonte idenë. Njerëzit e pranishëm as nuk ia lejonin vetes ta ëndërronin sikur e zotëronin një makinë si ajo për shkak se e shihnin si të paarritshme. Sikur t’ia lejonin vetes qoftë edhe për një çast që të ëndërronin sikur e zotëronin, trajnimi i tyre në sistemin e mallkimit të tokës do t’ju thërriste me ulërimë: “Çfarë harxhimi parash!” Por po sikur të kishe 25 miliardë dollarë në llogarinë tënde bankare (thjesht për të kuptuar idenë)? Makina do të të dukej aq e lirë, saqë do të blije një vetëm për ta përdorur fundjavave. Gjithçka është çështje këndvështrimi dhe, meqë Fjala e Perëndisë thotë se çdo premtim i Perëndisë është “Po” dhe “Amen” (kështu qoftë), këndvështrimi yt duhet të ndryshojë për të menduar siç mendon Perëndia.

Sepse të gjitha premtimet e Perëndisë janë në atë "po" dhe në atë "amen", për lavdi të Perëndisë nëpërmjet nesh.

- 2 Korintasve 1:20

Sipas fjalorit, përkufizimi i këndvështrimit është: një qëndrim i veçantë ose mënyrë si konsiderohet diçka; një pikë pamjeje, qëndrim, kuadër reference ose interpretim. Në thelb, këndvështrimi është vërtet thjesht mënyra se si ti e mendon diçka.

Ja një koncept të cilin dua ta mendosh. Adami ishte një princ përpara se t'i dorëzohej Satanit. Prandaj, nëse do ta shihje pas rënies, do të shihje një njeri të varfër, me një familje të shkatërruar (Kaini, i biri, vrau të vëllain, Abelin) dhe nuk do të mendoje se ishte dikushi. Por ajo që nuk pe ishte besnikëria në venat e tij. Megjithëse nuk e pe në atë cilësi, ai në fakt ishte krijuar për të sunduar dhe mbretëruar në këtë jetë. E njëjta e vërtetë është e vlefshme edhe për ty sot. Ti nuk mund ta shohësh veten thjesht në bazë të vendit ku jeton, çfarë zotëron dhe rrethanave tua të tanishme dhe ta gjykosht potencialin tënd. Duhet të shohësh potencialin tënd të krijuar.

Më kujtohet kur po kaloja disa rrethana të vështira dhe po përballesha me probleme madhore që dukeshin tepër të mëdha për mua. Përballesha me disa vendime që kërkonin shumë më tepër para

nga sa kisha në dorë. Ndieja sikur e dija se çfarë po më thoshte Perëndia të bëja, por isha ende pak i trembur t'i futesha asaj gjëje. Zoti më dha një ëndërr në atë kohë.

KËNDVËSHTRIMI YT DUHET TË NDRYSHOJË PËR TË MENDUAR SIÇ MENDON PERËNDIA.

Po kalëroja në majë të një kodre. Në dorë mbaja një shpatë. Poshtë meje në rrëzë të kodrës kishte qindra, në mos

mijëra ushtarë armiq mbi kuaj me shpatat të drejtuara kundër meje. Isha krejt i vetëm në atë faqe kodre dhe sigurisht që i papërfillshëm në numër. Një zë në ëndërr më tha këto fjalë: "Mos e nënvlerëso veten, Geri!" Pas kësaj, e ngrita shpatën dhe fillova të nxitoja me kalin tatëpjetë kodrës drejt armikut, i cili tashmë, duke e parë ndryshimin tim, ishin sulur përpara duke ngjitur kodrën drejt meje me shpatat e mprehura.

Ndërsa po kalëroja kundër tyre, thërrita me zë të lartë: “THOR!”

Kur u zgjova e kuptova se kishte qenë Zoti që më kishte folur dhe nxitur, por nuk e dija kuptimin e fjalës *Thor*. Kam një burrë në kishë i cili ka qenë pastor për 30 vjet dhe ka studiuar shumë gjuhë. E pyeta nëse ia dinte kuptimin dhe më tha se do ta kontrollonte. Më telefoni të nesërmen dhe më tha se Thor do të thotë bir i bubullimës. E falënderova dhe u mahnita me atë që po më thoshte Zoti. Për armikun unë gjëmoja si bubullimë! Nëse nuk i them djallit se sa i dobët jam, kur flas, atij i duket sikur dëgjon një bubullimë (fuqi).

Po predikoj në të parën Konferencë të Providencës në vitin 2010 dhe po e tregoj këtë histori. Teksa e shtjellova historinë, e përmbylla me atë që më tha Perëndia në ëndërr: “Geri, kur armiku të sheh duke iu afruar, ti gjëmon si bubullimë.” Në çastin që thashë: “Gjëmon si bubullimë”, një kërcitje e madhe bubullime e mbushi ajrin. Nuk binte shi, nuk kishte pasur as bubullima të mëparshme dhe gjithë atë natë u dëgjua vetëm një kërcitje bubullime. Njerëzit e pranishëm atë mbrëmje u tronditën. Por askush nuk ishte më i gëzuar se unë, sepse e dija që Zoti e kishte vënë “AMEN-in” e Tij mbi fjalët e mia dhe ishte i vlefshëm për të gjithë bijtë e Tij. Meqë ra fjala, kamerat e televizionit po xhironin atë mbrëmje dhe nëse dëshiron ta shohësh atë ngjarje, mund të shkosh te lidhja: <https://youtu.be/rtx1XYJGIaG>.

Dhe ja se cili është koncepti që duhet të kuptosh.

Skllëverit nuk kanë ëndrra të mëdha!

Për çfarë ëndërrojnë skllëverit? Të ndalojnë, ja se për çfarë. Ata ëndërrojnë për orën 5:00 ndërsa vazhdojnë t’i shohin orët e tyre përgjatë gjysmës së dytë të ditës, me dëshirën për të ndaluar dhe lënë punën. Ata ëndërrojnë për pushimin, ëndërrojnë të dalin në pension, ëndërrojnë të kenë para që të mund të ndalojnë. Skllëverit ëndërrojnë të ndalojnë, jo të krijojnë më tepër punë! Një mendësi apo këndvështrim skllavërie nuk shpik ose krijon punë; kërkon një mënyrë për të shpëtuar nga puna. Një skllav është tashmë i mbingarkuar dhe nuk e sheh potencialin që kalon para syve të tij çdo ditë.

Për të qenë koka dhe jo bishti, mendësia jote duhet të ndryshojë

nga ajo e një skllavi në atë të një pronari dhe krijuesi. Ti duhet të fillosh të ëndërrosh përsëri. Ti duhet të shohësh përtej asaj që mendon se je, sepse, megjithëse mund të dukesh i dobët në sytë e tu, për djallin ti gjëmon si bubullimë. Ti ke gjak mbretëror në venat e tua dhe duhet të mendosh dhe veprësh si i tillë.

Kam një mik që është multimilioner. Ai zotëron shumë shtëpi të bukura, të gjitha buzë oqeanit ose liqeneve. Një ditë që i kisha shkuar për vizitë, ishim duke ecur në mol, midis varkave. Ndërsa kalonim pranë secilës, ai më thoshte emrin e pronarit. Do të të jap një shembull të kësaj bisede, por emrat do t'i sajoj, pasi nuk i mbaj mend. Dhe biseda e mikut tim ishte e tillë: “Kjo varkë është e Billi Smithit, i cili është pronari i “Ohio Medical Services”. Kjo varka tjetër është e Xhon Roxhersit, i cili është pronar i “Rogers and Rogers”, një zyrë ligjore. Kjo varka tjetër i përket Ralf Tiduellit, i cili është pronar i një dyqani këpucësh të mira në High Street.”

Ndërsa e kaluam radhën e varkave që mund të ishin rreth 20 të tilla, e kuptova se secila prej tyre zotërohej nga dikush që kishte një biznes. Asnjë varkë nuk zotërohej nga një njeri i zakonshëm që punon nëntë me pesë si i punësuar në një kioskë akullloreje lokale. Atëherë, unë nuk jam kundër punës në një kioskë akullloreje lokale dhe nuk jam kundër të qenit i punësuar, në shumicën e rasteve gjithsesi. Thjesht po të jap një shembull të llojit të njerëzve që kanë pasuri.

Të lutem kushtoji vëmendje asaj që po të them. Nuk bëhet fjalë për paratë që kanë; bëhet fjalë për mendësinë që kanë. Mos i keqkupto gjërat. Shumica e njerëzve do të thoshin: “Do të doja të kisha aq shumë para.” Ajo që duhet të thonë është: “Do të doja të mendoja siç mendojnë ata!” Ata kanë një këndvështrim tjetër për veten dhe jetën.

Shumica e familjeve nuk arrijnë kurrë të kenë të ardhura që do të konsideroheshin të mira. Një studim aktual tregon se 51% e punëtorëve amerikanë fitojnë më pak se 30 000 dollarë në vit.5 Më shumë se gjysma e kombit tonë fiton më pak se 30 000 dollarë në vit?! Nëse je në të njëzetat dhe sapo ke filluar apo ke një farë pozite për shkak se e dëshiron atë dhe paratë nuk janë në krye të listës tënde, atëherë në rregull, por e di se kjo nuk është e vërtetë për më shumë se gjysmën e kombit tonë. E di se u nevojiten më shumë para. Më beso,

kam qenë në mijëra e mijëra shtëpi gjatë 36 viteve të mia në industrinë e shërbimeve financiare dhe e kam parë këtë nga afër.

Po përse nuk kanë më shumë të ardhura? Para se të fillosh të bërtasësh se sa e padrejtë është jeta ose se si je një viktimë, apo ndonjë marrëzi tjetër, do të të them se është për dy arsye. Së pari, ata janë të bllokuar nën sistemin e mallkimit të tokës në varfëri dhe nuk e njohin Mbretërinë e Perëndisë dhe parimet e Tij të providencës. Së dyti, ata kanë mendësi negative të tepruar, edhe kjo për shkak të trajnimit të mallkimit të tokës që kanë marrë dhe për shkak se nuk shohin një rrugëdalje, megjithëse rrugëdalja mund të jetë para syve të tyre. Në thelb, skllëvërit kanë një mendësi skllavërie. Ata nuk e shohin mundësinë kur janë duke kërkuar për prehje. Le ta pranojmë; njerëzit ligështohen nëse nuk kanë përgjigje të vërteta.

Më lejo të të jap një shembull që e përdor në seminarin e mia. Le ta zëmë se të them se mund t'i zgjidhja të gjitha problemet e tua me paratë me një fjali të thjeshtë. Bëji gati lapsin dhe letrën sepse të garantoj se kjo do të jetë përgjigjja jote. Gati? Mirë, ja se cila është: fito të ardhura neto prej 5 milionë dollarësh këtë vit. Kur e them këtë nga platforma, të gjithë fillojnë të qeshin. Po përse qeshin? Sepse nuk e imagjinojnë veten të fitojnë aq shumë para, as nuk mendojnë se është e mundur të fitosh të ardhura prej 5 milionë dollarësh në vit.

Më pas them se ata nuk do ta zotërojnë kurrë atë që nuk mund ta shohin. Pastaj e përsëris ushtrimin, por kësaj here e ul vazhdimisht numrin: 200 000 dollarë, 100 000 dollarë, 70 000 dollarë ose 40 000 dollarë në vit. Në fund u them: “Do të arrij në një numër ku do të thoni: “Mirë, e thjeshtë, këtë mund ta bëj.”

Më pas u them atyre një histori tjetër. Le ta zëmë se unë jam një biznesmen i pasur në biznesin e eksporteve. Dua të dërgoj topa në Kinë dhe më duhet ndihmë me paketimin për t'i dërguar. U them atyre se do t'u paguaj 500 dollarë për secilin top që paketojnë. Duke supozuar se mund të paketojnë 200 topa në ditë, ata do të mund të fitonin 100 000 dollarë në ditë. Dua t'u ofroj gjithashtu një kontratë

⁵ Michael Snyder, “Goodbye Middle Class: 51 Percent of all American Workers Make Less Than 30,000 Dollars A Year,” “End of the American Dream,” *Washington's Blog*, October 21, 2015, <http://www.washingtonsblog.com/2015/10/goodbye-middle-class-51-percent-of-all-american-workers-make-less-than-30000-dollars-a-year.html>.

një vjeçare për paketimin e topave me të njëjtën shpejtësi. Atëherë, nëse u them se përgjigjja e tyre do të ishte të bënin 5 milionë dollarë neto të ardhura në 12 muaj, cili do të jetë reagimi i tyre? “E thjeshtë, pa problem, me atë shpejtësi mund t’i fitosh lehtësisht 5 milionë dollarë.”

Cili ishte ndryshimi? Një plan, vetëm kaq. Plani e bën gjithë ndryshimin. Perëndia që të ka krijuar e di planin dhe gjithçka që të duhet është ta dëgjosh atë. E kështu është me Mbretërinë e Perëndisë. Kur Perëndia ma dha atë ëndrrën për ta nisur atë biznes dhe më pas më tregoi se si ta bëja atë, të ardhurat e mia nuk kishin ndryshuar ende, por po bërtisja nga brenda: “Kjo është e lehtë! Problemet e mia me paratë mbaruan; e gjeta planin!”

Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju, thotë Zoti, mendime paqeje dhe jo të së keqes, për t’ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë.

- Jeremia 29:11

Perëndia ka plane për të të begatuar! Kur ta zbulosh se Perëndia e ka një plan për begatinë tënde, beteja është gjysmë e mbaruar! Dëgjo, rregullimi i çështjes së parave nuk është aq i ndërlikuar. Providenca është vizion paraprak! Në fakt, është shumë e thjeshtë. Përgjigjja kur nuk ke ushqime është të blesh ushqime. Përgjigjja ndaj nevojës për një shtëpi më të madhe është një shtëpi më e madhe. Përgjigjja për një makinë të mirë është të zotërosh një makinë më të mirë.

E di se duket sikur kjo që them është e ekzagjeruar, por unë kam ngarë një makinë rrangallë për vite të tëra. Mund të më dalloje duke ardhur që një milje larg për shkak se lija pas një shtëllungë tymi kudo ku kaloja. E di se sa stresuese mund të jenë problemet e makinave kur të duhet të shkosh diku. E di edhe se si ndihesh kur futesh në një distributor dhe paguan me para në dorë për një makinë të re.

**SI NJË QYTETAR I
MBRETËRISË, TI KE TË
DREJTA LIGJORE DHE TANIMË
ÇDO PARIM DHE LIGJ ËSHTË
NË DISPOZICIONIN TËND.**

E di çfarë? Nuk ka më stres, nuk ka më shqetësime. Përse?

Sepse nevoja m'u plotësua dhe unë kam paqe. Mund të përqendrohem në atë që duhet të bëj në vend që të merrem me problemet e makinave.

Fakti është se shumica e njerëzve duhet të përballen me probleme të vërteta parash deri në pikën saqë stresohen në pjesën më të madhe të jetës së tyre. Ata mund të punojnë shumë orë duke u përpjekur të shtyjnë jetën, saqë nuk kanë jetë. Mik, ky nuk është vullneti i Perëndisë për jetën tënde.

Sikurse e thashë më parë, njerëzit i braktisin ëndrrat dhe pasionet e tyre për çekun e pagës në punë që i urrejnë. Zakonisht skllëvërit nuk janë njerëz të lumtur! Fatkeqësisht, kjo është gjendja e njerëzve, të palumtur me gjendjen e jetës së tyre, të neveritur dhe të dëshpëruar. Por në realitet, ata i ndan vetëm një zhvendosje këndvështrimi nga liria ose, sikurse e thashë, të pasurit e një plani.

Më lejo të të jap një shembull personal. Shumë prej jush e dinë se mua më pëlqen të dal për gjueti dhe për peshk, të ngas biçikletën dhe të bëj ngjitje në mal, veprimtari në natyrë. Unë jam rritur në Ohajo, në një komunitet të vogël fermerësh në atë që njihet si Plain Township (Qyteza në ultësirë). Është quajtur Plain Township sepse, siç mund ta imagjinosh, ishte ultësirë. Sigurisht, kjo ishte gjë e mirë për fermerët, por nuk ishte peizazhi më tërheqës. U abonova në çdo revistë gjahu dhe peshkimi që mundesha, *Outdoor Life*, *Sports Afield*, *Field & Stream* dhe të tjera. I lexoja historitë e mëdha të peshkimit dhe gjuetisë në malet e egra dhe të bukura në perëndim dhe në malet e pasura me gjelbërim të Luginës së Apalashëve vetëm një orë larg në lindje. Megjithatë, nuk i kisha vizituar kurrë ato zona. Hera e parë që kam parë një mal ishte pasi kam mbushur 40 vjeç.

Përse? Kisha paratë për të udhëtuar, e kisha makinën time, autostrada Interstate I-70 kalon përmes qytetit tim dhe duke shkuar në perëndim kalon përmes Maleve Shkëmbore. Por e vërteta ishte se nuk kisha menduar kurrë të shkoja atje, as ia kisha lejuar vetes ta mendoja "Do të shkoj atje një ditë." I admiroja ato vende përmes imazheve të shkëlqyeshme të një reviste, por nuk mendoja kurrë të shkoja. Ato mund të kishin qenë edhe në hënë po të qe për mua; thjesht nuk ishte një mundësi në mendjen time. Kur mbusha 40 vjeç dhe më në fund udhëtova drejt perëndimit, nuk më besohej se çfarë kisha humbur

gjithë jetës sime. Tani duhet të bëj të paktën një udhëtim në mal një herë në vit. Mik, jashtë ka më tepër nga sa mund të shohësh tani. Ti je më shumë nga sa shikon tani! Ka një këndvështrim të ndryshëm për jetën që duhet ta shohësh dhe përjetosh.

Kur fillon ta kuptosh dhe mësosh se si funksionon Mbretëria e Perëndisë dhe atë që thotë Mbretëria e Perëndisë se e ke tashmë, këndvështrimi yt do të ndryshojë!

Ju, pra, nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjestarë të familjes së Perëndisë.

- Efesianëve 2:19

Si një bashkëqytetar i Mbretërisë, ti ke të drejta ligjore dhe çdo ligj dhe parim është tanimë në dispozicionin tënd. Ky ishte problemi im dhe i Drendës. Megjithëse të krishterë dhe që e donim Perëndinë, ne ishim bashkëqytetarë të Mbretërisë së Perëndisë pa asnjë njohuri për ligjet dhe parimet e Mbretërisë. Për shkak të këndvështrimeve të kufizuara që na dha sistemi i mallkimit të tokës, ne nuk kishim ëndrra. Por njohuria është fuqi.

Për shembull, në gjykatë, një kontratë e firmosur qiraje provon se ti ke të drejtën ligjore për të jetuar në shtëpinë tënde. Njohuria që ekziston një dokument i firmosur dhe akses i drejtësi për të garantuar të drejtën e ligjshme për të jetuar në atë shtëpi të siguron paqe dhe ngushëllim. Në një njëjtën mënyrë, njohuria e asaj që thotë Perëndia dhe asaj që Mbretëria ka për ty, të jep sigurinë për ta rrokur gjithçka që është ligjërish e jotja. Për shembull, cila është begatia e fermerit? A janë paratë? Jo. A është fara që ai mbjell? Jo. Është njohuria që zotëron ai për ligjet e mbjelljes dhe korrjes. Pavarësisht sa i varfër mund të jetë, ai e di se si të bëhet i pasur. Ai thjesht shfrytëzon ligjet e mbretërisë tokësorë të vendosura nga Perëndia. Procesi i mbjelljes së farës dhe korrjes mund të japë prodhim për fermerin herë pas here.

Ai i kupton ligjet e korrjes dhe ka siguri të plotë në to. Ai mbjell në tokë farëra me vlerë mijëra dollarë, e megjithatë nuk ka frikë. Nuk

do ta glesh bujkun të ulur pranë traktorit të tij pasi i ka mbjellë farat duke qarë për të gjitha paratë që ka hedhur në tokë. Jo, ai nuk qan për koston e farave. Ai do të gjejë siguri në ligjet që rregullojnë mbretërinë tokësore. A mund të thotë ai se si rritet një farë? Dyshoj, por ai mund të thotë se po kërkon më tepër tokë për ta punuar. E njëjta gjë është e vërtetë për ty dhe për mua. Nëse nuk i njohim ligjet e Mbretërisë dhe kemi siguri në to, ne nuk mund ta shijojmë jetën që Perëndia e ka planifikuar për ne.

Një nga historitë më ngazëlluese që dëshmuar në ato ditë të hershme ndodhi kur mora një telefonatë nga një njeri që do ta quaj “Don”, i cili po përballej me disa probleme financiare të rënda. Ai kishte dëgjuar se unë i ndihmoja njerëzit me financat e tyre.

Kur u takova për herë të parë me Donin, ai erdhi në zyrën time shumë i shkurajuar dhe në borxhe. Dukej sikur asgjë nuk shkonte mirë në jetën e tij në atë kohë. Kur u ula dhe fola me të, zbulova se ai ishte tre deri në katër muaj mbrapa me qiranë dhe pothuajse çdo faturë tjetër për t’u paguar. Kishte probleme martesore: gruas së tij i kishte ardhur në majë të hundës situata financiare dhe kishte filluar ta humbte respektin për Donin pasi ai nuk ishte në gjendje të siguronte për të dhe për pesë fëmijët e tyre. Fakti ishte se Doni e kishte humbur respektin për veten dhe kishte shumë pyetje.

Puna që bënte në atë kohë lidhej me shitjen e sigurimit shëndetësor në mbarë shtetin e Ohajos, por mungesa e suksesit po e çonte shumë shpejt drejt një udhe financiare shkatërrimtare.

Pavarësisht të gjitha gjërave që Donit nuk i shkonin mirë, unë pashë potencial tek ai. Ai ishte i gatshëm të mësonte dhe i gatshëm të punonte. Ky kombinim i fuqishëm më intrigoj aq sa për ta punësuar atë dhe për të investuar jetën time në mirëqenien e të ardhmes së tij. Në fund, ishte një investim që na shpërbleu të dyve me interesa të mëdha.

Kompania ime e re sapo kishte fituar një udhëtim për në Havai nga një prej shitësve tanë dhe unë ndjeva se kjo do të ishte një mundësi e madhe për t’i treguar Donit rreth Mbretërisë së Perëndisë. Megjithëse Doni ishte i krishterë, ai nuk kishte të njëjtën njohuri si unë. Dhe megjithëse isha përpjekur disa herë t’ia tregoja parimet e Perëndisë në këtë fushë, dukej se nuk e besonte atë që i thosha.

Vazhdova të kërkoja një mënyrë për të tërhequr vëmendjen e Donit që do ta ndihmonte atë të kuptonte se edhe ai mund të kishte sukses nëse mësonte se si funksiononte Mbretëria e Perëndisë. Megjithatë, Doni ishte kaq shumë i shkurajuar, saqë e kishte shumë të vështirë të besonte në vetvete dhe të besonte se mund të ndodhte vërtet një ndryshim. E dija se ky udhëtim në Havai ishte mundësia ime.

Disa javë përpara se unë dhe Doni do të niseshim, folëm për atë që do të shihnim dhe bënim atje. Një interes i veçantë e mbërtheu vëmendjen e Donit si asgjë tjetër. Ai donte të kapte një marlin blu në ujërat e bukura të Oqeanit Paqësor. “Havai është kryeqyteti i marlinit blu në botë”, më tha Doni i emocionuar. “Gjithmonë kam dashur të kap një marlin blu; e kam pasur ëndërr.” Për herë të parë pas shumë javësh unë pashë një shkëlqim në sytë e Donit. Ja që diçka e emocionoi vërtet dhe e dija se ngazëllimi i tij do t’ia hapte derën një mësimi të fuqishëm.

“Don”, i thashë, “a e di se është e mundur ta dish, jo të shpresosh, por të *dish* se do të kapësh një marlin blu në Havai duke u lidhur me Mbretërinë e Perëndisë?” I pështjelluar por i intriguar, Doni deshi të dinte më shumë dhe unë vazhdova me shpjegimin tim rreth Mbretërisë. I citova nga Marku 11:24, që thotë: “*Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkon duke u lutur, besoni se do t’i merrni dhe ju do t’i merrni.*” Për Donin kjo ishte pothuajse shumë e mirë për t’u besuar. Shpenzova pak kohë për ta ndihmuar atë ta kuptonte Mbretërinë dhe se si ta çlironte besimin e tij. Dhe kështu, përpara se të niseshim në udhëtimin tonë, ai dhe bashkëshortja e tij u lutën me marrëveshje dhe besuan se e kishin marrë një marlin blu. Ata mbollën gjithashtu një farë financiare në Mbretërinë e Perëndisë për ta korrur më vonë. Kjo ishte diçka që Fryma e Shenjtë më kishte mësuar ta bëja kur e çlirova besimin tim për diçka që më duhej.

Ndërkohë, Doni bëri gjithçka që dinte të bënte për të përmbushur pjesën e tij në korrje. Ai bëri kërkime për varkat e disponueshme dhe çmimet dhe në fund fare rezervoit me një kapiten me të cilin ndihej i kënaqur. Gjithçka u vendos dhe të gjithë ishim shumë të emocionuar për daljen në ujërat blu të Havait.

Erdhi dita e lundrimit dhe hipëm në varkë. I thamë me ngazëllim

kapitenit se sot ishte dita që do të kapnim një marlin blu. Ndërsa priste që ne të kishim një ditë peshkimi të suksesshme për lloje të tjera peshku, ai na siguroi se mundësitë nuk ishin në favorin tonë për të kapur një marlin blu atë ditë. Me dy varka që niseshin në udhëtime të rezervuara çdo ditë, gjatë katër muajve të fundit ekuipazhi i tij kishte sjellë vetëm një marlin blu. Kjo për shkak se nuk ishte ende stina e marlinit meqë marlini është një peshk migrator. Duke mos pranuar të shkurojoheshim, ne i thamë me respekt se do të kapnim një dhe vazhduam t'i bënim gati pajisjet tona.

Pasi kishim kontrolluar për gjashtë orë, grepi nuk kishte zënë as edhe një herë të vetme dhe kisha filluar të shqetësohesha pak se mungesa e aksionit mund ta dobësonte besimin e Donit. Prej shqetësimit tim i bëra një pyetje. “Don”, i bërtita nga vendi im mbi urën sipër tij, “më lejo të të bëj një pyetje. Ku e more marlinin blu? Kur të dalë ose kur u lutëm?” I sigurt, Doni m'u përgjigj me bindje: “Geri, kjo nuk është e thjeshtë. Unë e mora atë kur u luta.” U emocionova dhe ndjeva siguri kur e dëgjova përgjigjen e tij. Atëherë e kuptova se Doni i kishte marrë me seriozitet udhëzimet e mia dhe ishte i vendosur ta kapte marlinin.

Pak minuta më vonë, çikriku filloi të lëvizte ndërsa përkulej drejt detit dhe marinarët bërtitën: “Zuri!”

“Mos u entuziazmoni”, na këshilloi kapiteni. “Është vërtet një peshk i madh, por nuk është marlin blu. Marlinët dalin drejt e në sipërfaqe dhe bëjnë kërcime të jashtëzakonshme në ajër dhe ky peshk po qëndron në thellësi.” Kaluan minuta ndërsa Doni vazhdoi të luftonte me peshkun që nuk kishte dalë aq afër sa duhej me sipërfaqen, sa për ta parë. Sado që Doni ishte i lodhur, peshku ishte edhe më i lodhur dhe shumë shpejt hoqi dorë nga lufta. Doni dhe unë nuk u habitëm ndërsa ai e afrooi marlinin blu të madh e të bukur, por të gjithë të tjerët në varkë u shtangën.

Fotoja e Donit dhe e peshkut të tij qëndron në zyrën time sot e kësaj dite si një dëshmi për të tjerët dhe një kujtues i vazhdueshëm për mua për realitetin e Mbretërisë. Në dukje ishte vetëm një peshk. Por për Donin marlini nënkuptonte shumë më tepër. Nëse Mbretëria funksionoi për marlinin, me siguri do të funksiononte për gjithçka tjetër që i duhej në jetë. Për Donin ishte vetëm fillimi i të kuptuarit të

ndikimit që Mbretëria e Perëndisë do të kishte në jetën e tij.

E adhuroj këtë histori dhe më pëlqen t'i shoh njerëzit të kenë përvoja reale me Mbretërinë e Perëndisë. Kjo është ajo që dëshiroj edhe për ty!

KAPITULLI 4

GJETA NJË ÇELËS KRYESOR TË BRETËRISË!

Të gjithë ne kemi çelësa të lloje të ndryshme për shtëpinë, makinën dhe ndonjë gjë tjetër që duam ta ruajmë. Çelësi na jep aksesin në atë që është e mbrojtur ose autoritetin për ta përdorur sendin, për shembull makinën. Duke jetuar si i krishterë për nëntë vite të gjatë në kaos financiar dhe dëshpërim, e dija se diçka mungonte, diçka nuk shkonte. Nuk ishte nevoja që dikush të ma thoshte këtë. Ajo që duhet të dija ishte se çfarë nuk shkonte dhe se si ta rregulloja atë.

Kur Zoti më foli kur i thirra për ndihmë, i shtrirë mbi shtratin tim në një shtëpi ferme të shkatërruar, ai më tha se problemi im ishte se nuk e kisha mësuar kurrë se si funksiononte Mbretëria e Tij. Në atë fjali të vetme unë e dëgjova çelësin, ose duhet të them burimin e çelësit ose çelësave të nevojshëm: Mbretëria. Perëndia po më thoshte se përgjigja ime gjendej në Mbretërinë e Tij. Nuk kisha shpenzuar kurrë kohë për të mësuar se si funksiononte Mbretëria e Tij, por po ta bëja, do ta gjeja përgjigjen time. Kur Perëndia më foli atë ditë lidhur me mungesën e njohurive të mia për Mbretërinë, në të vërtetë nuk e kisha idenë se çfarë nënkuptonte me Mbretëri. Por e dëgjova me zë të lartë dhe të qartë se po të mësoja se si funksiononte Mbretëria e Tij, do t'i gjeja përgjigjet që po kërkoja. Prandaj për mua, një çelës kryesor gjendej në atë thënie të përgjithshme: “Ti nuk ke shpenzuar kurrë kohë për të mësuar se si funksionon Mbretëria ime!” Sigurisht, ajo thënie në vetvete thoshte

shumë dhe ishte me siguri çelësi i parë për jetën time të transformuar.

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes. Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mënçurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

- Isaia 9:6-7

Njohuria se Mbretëria e Perëndisë është në fakt një mbretëri që funksionon në bazë të qeverisjes dhe ligjeve i hapi sytë e mi për një kuptueshmëri të Mbretërisë që nuk e kisha njohur kurrë më parë. Njohuria se Mbretëria e Perëndisë u themelua dhe mbahet me drejtësi (administrimi i ligjit) dhe drejtësinë e Perëndisë (ligjet e Tij) më treguan se gjithçka që ndodh në Mbretëri është rezultat i një ligji ose parimi të asaj Mbretërie. Unë mund të mos jem njeriu më mendjempërhtë në botë, por isha i zgjuar sa duhet për ta kuptuar se nëse Mbretëria funksiononte në bazë të ligjeve, atëherë unë mund t'i mësoja ato ligje dhe t'i zbatoja në jetën time. Ndërsa Perëndia filloi të na zbulonte dhe mësonte mua dhe Drendës ligjet e Tij, unë fillova ta kuptoja se çdo histori në Bibël mbartte çelësat që më duheshin për të ditur se si funksiononte Mbretëria. Fillova ta lexoja çdo histori në Bibël me një sy tjetër: "Përse ndodhi kjo? Përse nuk ndodhi ajo?" E lexoja çdo histori me qëndrimin "Çfarë parimesh zbulohen në këtë histori? Si ndodhi ajo gjë?"

Fillova ta quaja veten një shkencëtar shpirtëror dhe emocionohesha ndërsa Fryma e Shenjtë më zbulonte ligje njëri pas tjetrit. U emocionova edhe më shumë që ligjet që zbulova mund të funksionin në jetën time ashtu siç funksionuan në Bibël. Njerëzit më pyesin: "Geri, çfarë nënkupton me ligjet e Mbretërisë?" Zakonisht u kujtoj të gjitha ligjet që i përdorin këtu në mbretërinë tokësore – graviteti, ligjet e fizikës dhe të gjitha ligjet që rregullojnë natyrën.

Një bujk i përdor këto ligje sa herë që dëshiron; nuk është nevoja që ai të lutet që ato të funksionojnë. Ato funksionojnë çdo herë që ai

zgjedh t'i përdorë ato. Në të njëjtën mënyrë, Mbretëria e Perëndisë funksionon me ligje që mund të mësohen. Meqë janë ligje, ato nuk ndryshojnë kurrë dhe mund të mësohen dhe zbatohen në jetën brenda Mbretërisë.

Meqë ra fjala, pasi vjen te Krishti, ti bëhesh një bashkëqytetar i Mbretërisë së Tij dhe e gjithë Mbretëria është e jotja. Këto ligje të Mbretërisë mund të mësohen dhe përdoren edhe nga ti.

“Mirë”, më thonë njerëzit, “E kuptoj këtë pjesë, por më jep një shembull të një ligji të Mbretërisë.” Ka shumë e shumë ligje. Në fakt, unë kam shkruar tashmë për disa, siç është ligji i juridiksionit, ligji i

besimit dhe ligji i marrëveshjes, megjithëse në kapitujt e mëparshëm nuk i emërtova si të tillë. E përsëris, ka shumë ligje dhe të gjitha këto ligje mund të zërthehen në funksion dhe zbatim, që janë pjesët në të cilat duam të përqendrohemi patjetër. Më lejo të të tregoj një histori që të mund ta ilustrojë atë që po them.

Unë kam një avion, një Piper Mirage, që e përdor për të fluturuar në takime, për t'u takuar me klientë dhe për të udhëtuar për punë. Kisha planifikuar një udhëtim në Kolorado për të marrë pjesë në një konferencë dhe e kisha planifikuar me kujdes kontrollin vjetor të mirëmbajtjes të kërkuar nga ligji që të përkonte me kohën afër udhëtimit. Nëse nuk e dije, çdo aeroplan që fluturon në SHBA duhet të kalojë një kontroll vjetor të mirëmbajtjes një herë në vit. Piloti im duhet ta merrte Mirage dhe të na çonte në takimin tonë. Por ditën përpara se do ta merrte, ofiçina e telefonoi dhe i thanë se e kishin thyer aksidentalisht xhamin e përparmë të ndihmëspilotit. Ata do ta ndërronin pa pagesë, por procesi e zgjaste edhe tri ditë më shumë qëndrimin e aeroplanit në tokë. Kjo nënkuptonte që unë dhe Drenda duhet të fluturonim me një avion

NDËRSA PERËNDIA FILLOI TË NA ZBULONTE DHE MËSONTE MUA DHE DRENDËS LIGJET E TIJ, UNË FILLOVA TA KUPTOJA SE ÇDO HISTORI NË BIBËL MBARTTE ÇELËSAT QË MË DUHESHIN PËR TË DITUR SE SI FUNKSIONONTE MBRETËRIA.

pasagjerësh për në Kolorado. Jo se dua të ankojem, por ne preferojmë gjithmonë aeroplanin tonë kudo ku shkojmë nëse është e mundur. U zhgënjyem pak, por mundëm të arrinim në konferencë. Plani ishte që piloti ynë do të na merrte për fluturimin e kthimit për në Ohajo.

Dy ditë pasi kishte filluar konferenca, zona u godit nga një stuhi rrebeshi e papritur. Breshëri ishte aq i madh sa që u dëmtua e gjithë zona. Në disa zona në fakt, copat e mëdha të akullit i depërtuan çatitë. Me qindra makina u dëmtuan, sa që nuk mund të riparoheshin. Ndërtesat dhe çatitë u dëmtuan. Ndërsa piloti erdhi të na merrte, ai parkoi në të njëjtin servis ku do ta kishim lënë aeroplanin nëse do të kishim ardhur me të që në fillim të konferencës. Sytë e mi u ndeshën me një pamje të pabesueshme. Çdo avion që ishte parkuar pikërisht aty ku aeroplani im do të ishte parkuar po të kishte qenë atje, ishte dëmtuar. Me hirin e Perëndisë, aeroplani im nuk ishte atje dhe, për rrjedhojë, nuk u dëmtua. Një histori vërtet e mahnitshme, por si ndodhi kjo? Dua të them, a ishte thjesht një rastësi apo mungesa e aeroplanit në atë vend ishte rezultat i një ligji shpirtëror prej të cilit unë përfitova në një farë mënyre?

Epo, jam i bindur se ishte rezultat i një ligji shpirtëror që unë e përdora, të cilin do ta ndaj me ty pas pak. Kuptueshmëria e një ligji të lejon t'i publikosh rezultatet sa herë që është e nevojshme. Në këtë rast, unë praktikova një ligj që Perëndia ma mësoi në fillim kur nisi të më trajnonte për ligjet dhe veprimet e Mbretërisë së Tij.

Më lejo të ta tregoj ligjin që më tregoi Perëndia; më pas do të të tregoj se si e zbatova atë. Ki parasysh, çdo histori në Bibël të tregon diçka rreth Mbretërisë dhe se si funksionon ajo. Unë e quaj veten një shkencëtar shpirtëror. Ndërsa e lexoj Biblën, jam gjithnjë në kërkim të ligjeve që kanë shkaktuar diçka ose ligjeve që nuk e kanë lejuar diçka të ndodhë. Ne e gjejmë historinë që lidhet me mësimin që dua të të tregoj te Marku 6.

Duke qenë se u bë vonë, dishepujt e tij iu afruan dhe i thanë: "Ky vend është i shkretëtë, dhe tashmë është vonë. Lejoi këta njerëz që të shkojnë në fushat dhe në fshatrat rreth e qark që të blejnë bukë, se s'kanë gjë për të ngrënë".

Por ai, duke iu përgjigjur, u tha atyre: “U jepni ju të hanë!” Ata i thanë: “A duhet të shkojmë ne të blejmë për dyqind denarë bukë dhe t’u japim të hanë?”.

“Sa bukë keni? Shkoni e shikoni”.

Ata, mbasi shkuan, thanë: “Pesë bukë e dy peshq”.

Atëherë ai i urdhëroi ata që t’i rregullojnë të gjithë, ulur në grupe, mbi barin e njomë. Kështu ata u ulën në grupe nga njëqind e nga pesëdhjetë. Pastaj ai mori pesë bukët dhe dy peshqit, i ngriti sytë nga qielli, i beko; i theu bukët dhe ua dha dishepujve të vet, që t’ua shpërndanin atyre; ua ndau gjithashtu dy peshqit të gjithëve. Të gjithë hëngrën sa u ngopën. Dhe mblodhën dymbëdhjetë shporta me copa buke dhe me mbetje peshku. Ata që hëngrën nga ato bukë ishin pesë mijë burra.

- Marku 6:35-44

Kjo është një histori e mrekullueshme dhe ilustrim i funksionimit të Mbretërisë së Perëndisë. Pesë bukë dhe dy peshq që ushqejnë 20 000 njerëz! Por ti thua: “Geri, Bibla thotë se atje ishin vetëm 5000 burra.” Po, ashtu thotë, por të siguroj se kishte edhe gra dhe fëmijë po ashtu. Prandaj hamendësoj se mbase ishin rreth 20 000 njerëz të pranishëm.

Kur dishepujt shkuan te Jezusi për problemin e ushqimit, Ai dëshiroi t’u mësonte atyre diçka për Mbretërinë e Perëndisë, prandaj u thotë: “Ushqejini ata.” Kjo i tronditi ata. Ku do ta gjenin kaq shumë ushqim? Ata përgjigjen sipas njohurisë për burimin e vetëm të providencës që njohin: puna! Ata i thonë: “Për këtë duhet rroga e tetë muajve (dyqind denarë) e një personi!” Nga këndvështrimi i tyre i orës së punës me mund e djersë të shpërblyer me dollarë në sistemin të mallkimit të tokës, do të ishte e pamundur t’i ushqejte ata.

Por në Mbretëri, ligjet e ndryshme të funksionimit i bëjnë të mundura të gjitha gjërat. Jezusi dëshiron t’i ndihmojë ata të shohin përtej sistemit të mallkimit të tokës dhe të mësojnë një mundësi të re nga Mbretëria e Perëndisë. Jezusi u kërkoi më pas të shihnin se çfarë kishin në dispozicion për ta ushqyer turmën. Ata shkojnë dhe shohin dhe i përgjigjen se kanë gjetur pesë bukë dhe dy peshq, por e dinë se aq nuk do të mjaftonin për t’i ndihmuar. Jezusi ua kërkon më pas bukët

dhe peshqit. Duke i mbajtur në duart e Tij, Ai lutet për to dhe i bekon. Më pas ua jep dishepujve të Tij për t'ia shpërndarë turmës. Sigurisht, ti e di se si shkoi pjesa tjetër e historisë; të 20 000 njerëzit e pranishëm hëngrën derisa u ngopën, e megjithatë mbetën edhe 12 shporta.

Pyetjet e mia janë: “Përse Jezusi kërkoi që t’ia sillnin bukët dhe peshqit përpara se t’u thoshte t’i shpërndanin? Përse nuk ua kërkoi Jezusi dishepujve që t’i shpërndanin menjëherë sapo t’i gjenin? A duhet të merrnin bekimin e Jezusit në fillim?” Përgjigjja e saktë është se Jezusi duhet t’i bekonte bukët dhe peshqit në fillim. Sepse buka dhe peshqit ishin në mbretërinë e tokës nën autoritetin dhe juridiksionin e njeriut kur dishepujt e Tij i gjetën në fillim. Në atë gjendje, Jezusi nuk kishte juridiksion mbi ta. Por kur ia çuan bukën dhe peshqit me vullnet të lirë, Ai pati mundësinë t’i bekonte ato. Fjala *bekoj* këtu do të thotë të shenjtërosh ose të veçosh. Pra, ja se cili është ligji i zbuluar i Mbretërisë.

Kur Jezusi e bekoj bukën dhe peshqit, peshku dhe buka ndërruan mbretëritë.

Në thelb, juridiksioni mbi bukën dhe peshqit ndryshoi. Perëndia kishte tanimë të drejtën ligjore ta shumonte bukën dhe peshqit për njerëzit.

Nëse Jezusi nuk do ta kishte marrë bukën dhe peshqit dhe t’i kishte bekuar, ata nuk do të ishin shumë.

Ne e përdorim po të njëjtin ligj kur e bekojmë ushqimin tonë, megjithëse mendoj se shumica e njerëzve nuk e kuptojnë se çfarë janë duke bërë kur lutem për ushqimin e tyre. E thënë thjesht, kur lutemi për ushqimin tonë, ai ndërron mbretëritë, duke e lejuar kështu Perëndinë të na mbrojë nga ndonjë gjë lënduese që mund të hamë. Duhet të shtoj edhe një gjë tjetër këtu. Nëse me vullnetin tonë të lirë vazhdojmë të jetojmë me ushqime jo të shëndetshme dhe të hamë gjithçka që e dimë se është e keqe për ne, do të korrim atë që do të mbjellim. Por nëse do të kishim ngrënë diçka të rrezikshme, diçka që nuk e dinim se do të

na lëndonte, Fjala e Perëndisë do të na kishte mbrojtur siç e mbrojti aeroplanin tim. Nuk e kam fjalën për llojin e lutjes rituale që i dëgjon shumicën e njerëzve ta bëjnë për ushqimin e tyre. Por për lutjen me besim, duke e falënderuar Perëndinë që e largon sëmundjen nga mesi ynë dhe na lejon ne, qytetarët e Mbretërisë së Tij të madhe, t'i shijojmë premtimet e Tij.

Edhe nëse do të pijnë diçka që shkakton vdekjen, nuk do t'u bëjë asnjë të keqe.

- Marku 16:18

Në botën e sotme ne kemi nevojë që siguria në mbrojtjen e Perëndisë të na japë prehje. Ka shumë gjëra që mund të na e rrëmbejnë paqen nga çdo anë, duke përfshirë ushqimin që hamë. Më beso, të jesh i sigurt se Satani komploton të ta vjedhë shëndetin dhe aftësinë tënde për të qenë efektiv kundër tij në mbretërinë tokësore nëpërmjet ushqimit!

Te Filipianëve 4:6-7 shohim një shembull tjetër të të sjellit të problemeve tona, çështjeve, paqes së mendjes, në fakt gjithçkaje në jetën tonë nën juridiksionin e Mbretërisë.

Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni kërkesat tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falënderim. Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarësie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus.

- Filipianëve 4:6-7

Kur lutemi për diçka, problemi ose çështja vendoset nën juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë. Nëse nuk lutemi për të, duart e Perëndisë janë të lidhura. Kështu Bibla thotë lutuni pa pushim (1 Thesalonikasve 5:17) dhe nuk keni sepse nuk ia kërkonit Perëndisë (Jakobi 4:2).

Kur e bleva aeroplanin tim dhe kur blej ndonjë gjë, lutem për të, duke i vendosur duart e mia mbi të dhe duke e sjellë nën juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë për të përmbushur qëllimin e tij ndërsa i shërben Mbretërisë së Perëndisë dhe detyrës sime. Për këtë arsye, aeroplani im

është i paprekshëm nga Satani dhe servilët e tij. Aeroplanin tim nuk do ta dëmtojë asgjë!

Rreth një muaj më parë, po fluturoja në aeroplanin Mirage nga Hjustoni në Ohajo pas një konference. Ishte vonë kur po kalonim përmes fshatit në errësi. Vetëtimja e ndriçoi qiellin në largësi nga e djathta dhe e majta jonë, ndërsa edhe një front stuhie po kalonte përmes fshatit. Fronti i stuhisë na detyroi që të bënim ndryshime të kursit për t'u larguar nga stuhia dhe për këtë arsye harxhuam më shumë karburant nga sa kishim planifikuar. Prandaj, për t'u siguruar se do të arrinim shëndoshë e mirë në shtëpi dhe për të respektuar rregullat e FAA lidhur me rezervat e karburantit në bord, vendosëm që të ndalonim në Luizvill, Kentaki për t'u furnizuar me pak karburant. U ulëm me 114 litra në bord, por kishim edhe një orë rrugë dhe nuk donim që të na mbaronte. U futëm në hangar dhe u kërkua atyre ta mbushnin secilin serbator me 76 litra. Kështu do të na bëheshin deri në 265 litra, mëse mjaftueshëm për të përshkuar distancën e mbetur deri në Ohajo, pasi Mirage djeg rreth 83 litra në orë.

Ndërsa prisnim në hangar, vajza në recepsion na tha se mund të shkonim e ta mbushnim me 151 litra. Kur po e thoshte atë, erdhi tekniku me disa shkresa për transaksionin. Vajza ia mori nga duart, ua nguli sytë dhe më pas tha: "Këtu ka diçka që nuk shkon. Numrat nuk përkojnë." Tekniku tha se e kishte mbushur me karburant dhe mund t'i rregullonte numrat më vonë. Ajo tha: "Mirë", por tha se derisa të korrigjoheshin numrat, nuk mund të më jepte një faturë, por do t'i duhej të na e dërgonte me email. Ne i thamë "Mirë" dhe shkuam deri tek aeroplani me teknikun. Piloti im i kërkoi teknikut të verifikonte që e kishte mbushur vërtet me 76 litra në secilën anë dhe ai i tha: "Po, e mbusha secilën anë me 76 litra."

Kështu u nisëm për në Ohajo dhe pas rreth 40 minutash fluturim, papritmas serbatori i majtë u boshatis. U tronditëm; si mund të ndodhte kjo gjë? Një minutë më vonë serbatori i djathtë u boshatis. Ishte mesnata e një nate të errët dhe ne ishim në 15 000 këmbë lartësi pa karburant. Çfarë ndodhi? Ne sapo e kishim mbushur me karburant. Njerëzit më thonë: "A nuk ka aeroplani yt një matës karburanti?" Sigurisht, por matësit e karburantit të aeroplanit tonë lëvizin ngadalë

ndërkohë që mbushen me karburant. Nëse ke ngarë ndonjëherë një Suburban të tipit më të vjetër, me siguri do ta kuptosh se për çfarë e kam fjalën. Matësit e tyre të karburantit reagojnë ngadalë kur u shtohet karburant.

Prandaj, në këtë rast, piloti im e pyeti teknikun drejtpërdrejt nëse e kishte mbushur avionin dhe për sasinë që i kishte hedhur. Ne vetë e kishim parë me cisternën e karburantit pranë avionit duke e mbushur me karburant. Piloti im bëri detyrën e tij, kur e pa cisternën e karburantit që po e furnizonte avionin dhe e kontrolloi dy herë me gojë se në avion ishin futur një total prej 151 litrash. Pasi e verifikojmë karburantin, ne vendosim një matës dixhital të karburantit që gjurmon djegien reale të karburantit deri në të dhjetën e litrit. Ne kujtuam se kishim bërë gjithçka që na takonte për të qenë të sigurt.

Njoftuam për emergjencën dhe u desh të uleshim pa motor në aeroportin “Greater Cincinnati”, që në fakt nuk ishte problem meqë ishim drejtpërdrejt mbi të kur serbatorët u boshatisën. Por ishte pak emocionuese me siguri. Sikurse zbuluam më vonë, ky ishte avioni i parë që tekniku kishte mbushur ndonjëherë. Ai kishte vendosur 8 litra në secilin serbator, jo 76. Ai nuk dinte ta lexonte matësin. Vërtet? Dhe kjo është gjithçka që ajo kompani kombëtare bën, furnizon avionë – e pabesueshme!

Qëllimi i armikut për të na lënduar nuk u kthye në problem, por mund të kishte qenë një problem i madh nëse do të kishim mbetur pa karburant diku tjetër në lartësinë 15 000 këmbë. Por sërish, armiku nuk mund të më lëndojë mua ose avionin. Për të përballuar një tentativë tjetër nga kundërshtari ynë, i kemi ndryshuar disa nga procedurat tona të furnizimit që nga ajo kohë. Tani e dimë të mos largohemi nga avioni ndërkohë që tekniku e mbush, që ta monitorojmë derisa furnizimi të përfundojë. Incidenti mund të ishte kthyer në katastrofë nëse do të

**MBRETËRIA KA LIGJE
QË DUHET T’I MËSOSH
PËR TË QENË EFEKTIV,
I SIGURT DHE TË KESH
PROVIDENCËN KËTU NË
MBRETËRINË TOKËSORE.**

kishim manovruar ulët dhe ngadalë ose në mot të keq; por sigurisht, nuk ndodhi kështu meqë unë kam një besëlidhje mbrojtjeje.

Të dy këta incidente me avionin tim të lidhura me sigurinë e tij si edhe timen ishin rezultat i besëlidhjes sime, të drejtave të mia ligjore në Mbretëri. Sigurisht, mund të të tregoj historinë se si e mora fillimisht atë avion, por nuk do ta bëj tani. Mendoj se e kuptove idenë: Perëndia është madhështor!

Mbretëria ka ligje që duhet t'i mësosh për të qenë i efektshëm, i sigurt dhe për të pasur providencë këtu në mbretërinë tokësore. Satani na urren, por, lavdi Perëndisë, nuk mund të na ndalojë. Edhe mbrojtja është prehje, pa shqetësim dhe pa frikë! Është e drejta jote e ligjshme.

Meqë ra fjala, nëse je duke e pyetur veten, ligji që sapo përshkrova dhe përdora është ai që e quaj ligji i juridiksionit.

Një shkrim tjetër i shenjtë që më dha Perëndia në fillim lidhur me Mbretërinë e Tij ishte Lluka 6:20.

Lum ju, të varfër, sepse juaja është mbretëria e Perëndisë.

- Lluka 6:20

Unë dhe Drenda filluam ta studionim atë që nënkupton Perëndia me “mbretëria e Perëndisë” në këtë shkrim të shenjtë kur Zoti na e tregoi për herë të parë. Sërish, Ai na tregoi se është një mbret i një mbretërie që rregullohet dhe funksionon me ligje. Për shembull, le t'i hedhim një sy kufirit tonë jugor. Çdo vit, me mijëra njerëz mundohen të hyjnë fshehurazi në Shtetet e Bashkuara. Përse? A mos vallë ngaqë nuk kanë një panoramë të bukur aty ku jetojnë? Jo, sigurisht që jo. Ata po përpiqen të hyjnë në Shtetet e Bashkuara për shkak të qeverisë së këtushme. Qeveria jonë ka ligje që i mbrojnë të drejtat e njerëzve dhe mundësojnë shumë liri që nuk janë në dispozicion në kombe të tjera: e drejta e pronës, e drejta për të pasur biznesin tënd, e drejta për të adhuruar siç dëshiron dhe liria e fjalës. Të gjitha nuk janë në dispozicion në shumë vende të tjera.

Tashmë kemi folur mjaft për Mbretërinë e Perëndisë, themelin e të gjithë çelësave, parimeve dhe ligjeve na ka dhënë Perëndia neve si qytetarë. Njohuria jote ose mungesa e njohurive për këto ligje mund

të jetë ndryshimi ndërmjet jetës ose vdekjes, fitores ose humbjes. Pasi vuajta për ato nëntë vite frike financiare dërrmuese dhe duke qenë i lirë tanimë, nuk mund të ta theksoj mjaftueshëm se sa e rëndësishme është të dish se çfarë do të thotë të jesh një qytetar i Mbretërisë së Perëndisë dhe sa e rëndësishme është t'i dish të gjitha ligjet dhe parimet nga të cilat përbëhet Mbretëria.

Toka ka ekzistuar për mijëra vite, megjithatë shumë nga gjërat që shijojmë sot nuk kuptoheshin. Për shembull, dua të imagjinosh se si ka qenë Vigjilia e Krishtlindjes në vitin 1906 në Ocean Bluff Brant Rock, Masaçusets. Atë ditë ndodhi diçka që e ndryshoi botën. Reginald Fessenden luajti *O natë e shenjtë* për anijet në det përmes një vale radio dhe lexoi nga Lluqa kapitulli dy. Ky ishte transmetimi i parë radiofonik në botë. Tani ne marrim një celular dhe mund të flasim me këdo në planet pa u menduar për veprimin.

Po janari i vitit 1879? Tomas Edisoni shpiku me sukses llambën dhe tani çdo komb mbi tokë i përdor ligjet e elektricitetit dhe ligjet që rregullojnë fizikën për të parë natën.

Po 17 dhjetori i vitit 1903? Vëllezërit Wright fluturuan me sukses në aeroplanin e parë dhe tani ne mund të hipim në avionë modernë dhe të fluturojmë në anën tjetër të botës brenda pak orëve. A380, avioni më i madh për pasagjerë, me peshë 600 tonë mund të mbajë mbi 800 veta për më shumë se 9 orë pa u furnizuar me rreth 600 milje për orë deri në anën tjetër të tokës. Nëse njerëzit do të kishin parë diçka si kjo në vitet 1800, ata do të ishin tronditur para një pamjeje të tillë. Por tani, është e zakonshme për ne që të lëvizim një çelës dhe ta ndezim llambën.

Ajo që dua të them është se të gjitha këto ligje ishin këtu më përpara, kanë qenë gjithmonë, në mbretërinë tokësore, që nga koha kur u krijua njeriu. Ato ishin në dispozicion të njeriut për t'u përdorur; ai thjesht nuk i shihte ato. Ai i shihte zogjtë që fluturonin, ai e shihte vetëtimën, por prapë nuk i kuptonte.

E njëjta gjë është e vërtetë lidhur me shkrimin e shenjtë. Feja ka përcaktuar kufij lidhur me atë që nënkupton Fjala e Perëndisë. Për vite të tëra, unë dhe ti kemi dëgjuar se të gjitha ato gjëra kanë kaluar, Perëndia nuk bën më mrekulli. Dhuntitë e Frymës ishin vetëm për apostujt, ose gjembi i Palit ishte një sëmundje. Në realitet, Fjala është

shumë e thjeshtë. Ajo nënkupton me saktësi atë që thotë. Por themeli në Mbretëri është çelësi i parë kryesor që duhet të kesh për të shkyçur të gjitha dyert e tjera.

Ja edhe një tjetër çelës kryesor:

Ligjet nuk ndryshojnë!

Lësho një gur dhe do të bjerë. Sa herë do të bjerë? Çdo herë. Ligji i gravitetit garanton se do të marrësh të njëjtën përgjigje çdo herë. E njëjta gjë është e vërtetë për Mbretërinë e Perëndisë.

KAPITULLI 5

TË FLUTUROSH ËSHTË MË MIRË SESA TË ECËSH

Të fluturosh është më mirë sesa të ecësh! Ndërsa po e shkruaja këtë kapitull, po fluturoja për në shtëpi nga shtëpia jonë e verës në Kanada me aeroplanin tim, duke udhëtuar me 402 km në orë në lartësinë 23 000 këmbë mbi tokë. Për shumë vite kemi udhëtuar me makinë për në Kanada nga shtëpia jonë ne Ohajo. Ishte një rrugë e gjatë dhe e lodhshme, 31-orëshe për të mbërritur atje. Më duhej të udhëtoja gjithë natës me makinë për të arritur atje ditën e nesërme. Po, ka pasur disa raste kur e kemi ndarë udhëtimin në dy ditë, por kur ke pushime 2-javore dhe katër nga këto ditë i ke shpenzuar duke i dhënë makinës, humbet shumë nga koha jote atje. Oh sa i lodhur isha kur arrija dhe më pas më duhej të përballesha me të njëjtin udhëtim prej 31-orësh të kthimit në Ohajo.

Gjithmonë i kam dashur avionët dhe e kam pasur licencën time të pilotimit që kur isha 19 vjeç, por nuk e kisha menduar asnjëherë që të isha pronar i një avioni. Dua të them, a i ke parë ndonjëherë çmimet e avionëve? Por sa më shumë mësoja në lidhje me Mbretërinë, aq më shumë kuptoja se unë isha ai që nuk e lejoja atë avion me “Jo-në” time dhe mendësinë e varfërisë. Tani kam dy avionë, një me të cilin fluturoj për qejf, avioni im i parë, dhe atë që e përdor për të udhëtuar. Siç e përmenda në kapitullin e mëparshëm, “Trajnimi me Jo” nuk na lejon ëndrra apo mundësi. Ne i bllokojmë ato para se të fillojnë.

Nuk kisha menduar ndonjëherë që të isha pronar i ndonjë avioni. Thjesht nuk e shihja se si kjo gjë mund të ishte e mundur. Për shumë vite, i merrja me qira avionët me të cilët fluturoja. Por ndërkohe që studioja ligjet e Mbretërisë, dhe pashë histori mbas historie në jetën time ku shfaqej Mbretëria, vendosa që do t'i besoja Perëndisë për avionin tim. Ne atë kohë nuk kisha mundësi financiare, por nxora një çek dhe në rreshtin e arsyes për të, shkrova “për avionin tim”. Rendita të njëjtin lloj avioni si ai që do të merrja. Unë dhe gruaja ime e mbollëm atë çek në Mbretëri, sipas Markut 11:24, duke besuar se do ta merrja mbas lutjes. Kjo ishte ajo ç’ka Zoti më kishte treguar të bëja që nga fillimi në lidhje me Mbretërinë. E kisha parë këtë procedurë shumë herë në jetën time.

Disa javë më vonë, po kryeja një kontroll rutinë dhe rastësisht doktori më tha: “Mos vallë njeh dikë që mund të jetë i interesuar për të blerë ndonjë aeroplan?” U habita, sepse askush nuk ma kishte bërë këtë pyetje më parë. “Çfarë lloj avioni është?” - e pyeta unë. Ai filloi duke më shpjeguar çfarë avioni ishte dhe më tha që ndodhej në aeroportin lokal, nëse unë do të doja t'i hidhja një sy. Për çudi, ishte pikërisht avioni për të cilin unë kisha bërë një mbjellje! Kalova nga aeroporti dhe e pashë dhe ishte në gjendje shumë të mirë. E kuptova se ky ishte avioni im. Por kishte një problem: nuk kisha para për ta blerë avionin. I thashë doktorit se isha shumë i interesuar për avionin dhe që do të kontaktoja përsëri me të.

Kaluan disa javë dhe unë mora një telefonatë nga vëllai im, i cili punonte në restorantin e babait tim, ngjitur me një godinë që unë e kisha në pronësi. E kisha marrë në pronësi godinën disa muaj më parë, nga fundi i vjeshtës. Po planifikoja që ta ktheja godinën në një kompleks zyrash për kompaninë time të shërbimeve financiare. Godina nuk e përmbushte kodin për ndërtesat tregtare, për qëllimin që e doja unë, kështu që e dija se do t'më duhej ta rindërtoja. Kontaktova me një ndërtues i cili skicoi planet dhe nënshkruam një kontratë. Megjithatë, vendosëm që të prisnim deri në pranverë para se ta fillonim projektin për shkak të motit të paqëndrueshëm. Rehabilitimi do të përfshinte rindërtimin e të tërë godinës.

Pronari i mëparshëm më kishte thënë që sistemi i ujit ka qenë i

prerë gjatë dimrit, kështu që nuk e kontrollova. Telefonata nga vëllai im kishte ndodhur në fund të shkurtit, pasi një kohë e ngrohtë kishte filluar ta shkrinte borën e dimrit. Ai më tha se godina ishte shkatërruar për shkak se uji prej saj dilte deri në rrugë. Unë dhe ai e dinim çfarë do të thoshte kjo - uji nuk ishte prerë siç na kishte thënë pronari i mëparshëm. Dhe sigurisht, kur e kontrollova dëmin, tubat e tualetit të katit të sipërm, bashkë me të tualetit poshtë dhe tubat e kuzhinës, kishin shpërthyer të gjitha dhe godina ishte mbushur me ujë. Të gjithë muret kartonxhes, tavanet dhe muret kishin rënë nga mbajtëset e tyre.

Në fillim, kjo mund të duket si një katastrofë e vërtetë, por planet e mia të rehabilitimit kërkonin që të hiqej i gjithë kartonxhesi nga muret dhe të ndërtoheshin dhoma të reja. Shtresat e jashtme duhet të ndërroheshin gjithashtu. Kështu që, në të vërtetë, uji nuk e dëmtoi aspak godinën. Të gjitha dëmet që u shkaktuan ishin shfaqur në zona që do të rindërtoheshin gjithsesi. Megjithatë, kur e bleva godinën, i bleva sigurimet. Të gjitha dëmet u mbuluan dhe kompania e sigurimeve më shkroi një çek – dhe e gjete – ai çek e pagoi aeroplanin tim. Ai avion, një Piper Warrior, është i lehtë për t'u pilotuar dhe unë fluturoj me të shpesh për kënaqësinë time. Sa herë që fluturoj, mendoj se sa bukur është të jesh duke fluturuar në avionin tënd të cilin e ke paguar. Akoma e kam atë avion, dhe vazhdon të punojë dhe pas 20 vjetësh.

Edhe pse në këtë histori ngjarjet kanë rrjedhur në mënyre magjike, nuk dua që të të lë me një përshtypje të gabuar në lidhje me mënyrën se si funksionojnë gjërat. Gjërat nuk shfaqen gjithmonë papritmas si në këtë histori. Zoti mund të të drejtojë drejt një mundësie për të fituar paratë për të paguar për avionin tënd, ose mund të gesh një ujdi shumë të mirë për të. Mendësia që duhet të kesh kur mbjell në Mbretëri është që Zoti do të të tregojë të korrat dhe një plan për t'i pasur ato. Gjëja e dytë që duhet të bësh është të qëndrosh brenda besimit dhe aftësive që ke zhvilluar. Kam pasur njerëz të cilët mendonin se, meqë Zoti do t'u tregonte atyre si ta shlyenin makinën e tyre, ata mund të provonin të mbillin për të marrë një trilion dollarë. Ti nuk ke besim për një trilion dollarë! Nise aty ku je dhe fillo t'i zbatosh ligjet e Mbretërisë dhe ta ndërtosh besimin tënd në ligjet e Mbretërisë dhe aftësinë tënde për ta arritur atë çfarë Zoti të tregon ty.

Por ja diçka që dua që ta kuptosh. Unë kam qenë një pilot për rreth 20 vjet para se ta blija atë avion. A mendon se ligjet e Mbretërisë funksiononin 20 vite më përpara? Patjetër që po. Kuptueshmëria ime, ose më mirë mungesa e kuptueshmërisë, nuk më lejonte që ta shikoja veten time si pronar të një avioni.

Njeriu ka parë për mijëra vjet se si kanë fluturuar zogjtë, ligji i ngritjes ka funksionuar në mes të ditës që të gjithë të mund ta shihnin, por asnjëri nga ne nuk e pa. Çfarë nuk po sheh? Mendoje pak.

Njëri nga shkrimet e shenjta që Perëndia ma mësoi që në fillim për sa i përket prehjes në providencën e Mbretërisë ishte Fjalët e Urta 10:22.

Bekimi i Zotit pasuron dhe ai nuk shton asnjë vuajtje.

- Fjalët e urta 10:22

Ky shkrim i shenjtë i referohet shkrimeve të shenjta dhe parimeve të Zanafillës 3:17, që ndava me ty më përpara.

Toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frutin e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh”.

- Zanafilla 3:17

Kur Adami e humbi Mbretërinë, ai humbi providencën e Mbretërisë dhe mbeti vetëm me përpjekjet e tij për të mbijetuar. Por siç e kemi kuptuar tashmë, për shkak të mundit dhe djersës ne nuk mund të vrapojmë shumë shpejt për të arritur lirinë që dëshirojmë me aq zjarr. Por tani ka një lajm të mirë!!!! Jezusi erdhi për t'ua predikuar lajmin e mirë të varfërve!

Fryma e Zotit, Zoti është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t'u dhënë një lajm të mirë të përrulurve.

- Isaia 61:1

Jezusi u dërgua për t'ua predikuar lajmin e mirë të varfërve. Por çfarë lajmi mund të ishte i mirë për të varfrit? E thjeshtë, ata nuk duhet të jenë skllëvër të mungesës dhe varfërisë në sistemin e e mallkimit të tokës lidhur me providencën. Më beso, mbasi jeton - ose më saktë mbijeton - për nëntë vjet me asgjë tjetër përveç borxheve dhe stresit, ky shkrim i shenjtë ishte një lajm i mirë, megjithatë ishte pështjellues. A e kishte me të vërtetë atë që thoshte? A nuk do të ishte mrekulli sikur të ishte e vërtetë që bekimi i Perëndisë sillte në një farë mënyre pasuri në jetën tonë? Doja ta dija me patjetër nëse ishte vërtetë dhe se si mund ta zbatoja atë. Megjithatë, një gjë që e kuptoja ishte se mallkimi i mundit dhe djersës siguronte vetëm në nivelin e mbijetesës - dhe mbijetesa nuk ishte e mjaftueshme. Asnjë nuk donte të ishte më i lirë se unë nga ky mallkim, por përsëri nuk ia kisha idenë se si mund ta realizoja këtë gjë në jetën time. Mendoj se kjo është mënyra se si jetojnë shumë të Krishterë - duke lexuar premtimet e Perëndisë, por duke mos ditur si t'i përvetësojnë dhe më pas t'i shfaqin ato në jetën e tyre.

Ndërsa fillova të studioja dhe ndërkohë që Perëndia më drejtonte në të kuptuarin e parimeve të Mbretërisë, lexova se si Abrahami ishte shumë i pasur. Ndalo! Po në lidhje me sistemin e mallkimit të tokës; si e kapërceu atë?

Abrami ishte shumë i pasur me bagëti, argjend dhe ar.

- Zanafilla 13:2

Ai u bë i pasur - jo, Bibla thotë shumë i pasur - por si? "Epo", ti mund të thuash, "ndoshta se ai ishte Abrahami." Nuk ishte kjo dhe këtu duhet të rrokësh të kuptuarit e ligjit të Mbretërisë. Për ligjet nuk ka rëndësi se kush je. Ato nuk bëjnë dallime mes individëve. Nëse dikush, kushdo qoftë, do të hidhej nga "Empire State Building" pa një parashutë, sado trupmadh apo trupvogël të ketë qenë ai person, të gjithë e dinë rezultatit. Ligji i gravitetit do të funksiononte në çdo rast. Atëherë, si përparoi Abrahami pavarësisht mallkimit të tokës? A ka ndonjë të dhënë në këtë histori që ne mund ta gjejmë? Një pjesë e përgjigjes mund të gjendet tek Zanafilla 12. Aty, Perëndia i dha

Abramit, që më vonë do të bëhej Abraham, një premtim në lidhje me jetën e tij dhe të pasardhësve të tij.

Por Zoti i tha Abramit: «Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd, dhe shko në vendin që do të të tregoj. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës».

- Zanafilla 12:1-3

Premtimi ishte me kushtin që Abrahami t'i besonte Perëndisë dhe t'i bindej Atij dhe duhej besim i madh që t'i linte të njohurit pa e ditur se ku po shkonte.

Me anë të besimit Abrahami, kur u thirr, u bind të shkojë në atë vend që do të merrte për trashëgim; dhe u nis pa ditur se ku po shkonte.

- Hebrejve 11:8

Kështu ne zbulojmë se Perëndia gjeti akses legjitim në mbretërinë e tokës nëpërmjet një njeriu që e besoi atë edhe kur nuk kishte kuptim. Besimi i Abrahamit bëri që Perëndia ta bekonte atë personalisht. Por më vonë, për shkak të besimit të Abrahamit, Perëndia do të bënte edhe një besëlidhje me të në lidhje me trashëgimtarët e tij. Mos u çudit. Ki parasys, kjo ishte mënyra se si Satani fitoi akses në mbretërinë e tokës në fillim. Adami, i cili kishte juridiksionin ligjor mbi tokën, siç është shënuar te Hebrejve 2:7-8, zgjodhi të besonte Satanin në vend të Perëndisë.

Besimi i Abrahamit, që hapi një derë ligjore për ndikimin e qiellit në jetën e tij, i dha mundësi atij të begatohej shumë. Kjo mirëqenie u trashëgua edhe te pasardhësit e Abrahamit. Ndërsa e studioja këtë edhe më shumë, lexova në lidhje ne Jozefin, stërnipin e Abrahamit. Gjeta një ilustrim të përsosur dhe kuptueshmëri për Mbretërinë dhe mënyrën se si funksionon ajo dhe, veçanërisht, çfarë nënkupton në të vërtetë Fjalët e Urta 10:22.

Për t'i kuptuar rrethanat, vëllezërit e Jozefit e urrenin atë dhe e shitën për skllav te disa tregtarë sklleverish që udhëtonin shpesh në atë zonë. Ata e çuan Jozefin në Egjipt, ku më pas e shitën te Potifari, një kapiten i ushtrisë egjiptiane. Por në pjesën e mëposhtme gjeta një copë të rëndësishme të mozaikut në lidhje me aftësinë e Abrahamit për të begatuar në mënyrën që u begatua.

Ndërkaq Jozefi u çua në Egjipt; dhe Potifari, oficeri i Faraonit dhe kapiten i rojeve, një egjiptas, e bleu nga Ismaelitët që e kishin sjellë atje. Zoti që me Jozefin, dhe ky pasurohej dhe banonte në shtëpinë e zotërisë së tij, egjiptasit. Dhe zotëria e tij e pa që Zoti që me të dhe që Zoti e sillte mbarë në duart e tij gjithçka bënte.

Kështu Jozefi fitoi hir në sytë e atij dhe hyri në shërbimin personal të Potifarit, që e emëroi kryeadministrator të shtëpisë së tij dhe i la në dorë gjithçka zotëronte. Nga çasti që e bëri kryeadministrator të shtëpisë së tij dhe për gjithçka që zotëronte, Zoti e bekoi shtëpinë e egjiptasit për shkak të Jozefit; dhe BEKIMI I ZOTIT PËRFSHIU GJITHÇKA AI KISHTE NË SHTËPI DHE NË FUSHË. Kështu Potifari la gjithçka kishte në dorë të Jozefit dhe nuk shqetësohej më për asgjë, përveç ushqimit të vet.

- Zanafilla 39:1-6

Teksti e thotë qartë se ishte bekimi i Zotit ai që bëri që Jozefi të begatohej. Por cili ishte apo është bekimi i Zotit? Vura re që ishte bekimi i Zotit, jo “një” bekim nga Zoti. Të gjithë ne mund të themi në lidhje me diçka të madhe “se ishte një bekim”. Por ky tekst nuk i referohet një gjëje të mirë që ndodh në përgjithësi. Ai flet në lidhje me “Bekimin”.

Kuptova që ky bekim i Perëndisë ishte në fakt një besëlidhje midis Perëndisë, Abrahamit dhe trashëgimtarëve të tij. Posaçërisht, bekimi nënkuptonte premtimet që i ishin dhënë Abrahamit në atë besëlidhje. Një marrëveshje ligjore përmban detyrat dhe detyrimet e të dyja palëve pjesëmarrëse, por edhe përfitimet e secilës. Në këtë rast, premtimi që iu dha Abrahamit ishte ana fitimprurëse e marrëveshjes. Për t'i gëzuar këto përfitime, detyrimi ishte që të ndiqte dekretin dhe ligjet e Zotit. Pashë

gjithashtu me qartësi se çdo gjë që Jozefi e futi nën juridiksionin e tij ligjor, gjithashtu i nënshtrohej ose gëzonte të njëjtat premtime ose përfitime.

Fjalët e Urta 10:12 po fillonte të kishte kuptim. Premtimet e Perëndisë që iu dhanë Abrahamit si një pakt ligjor e çrrënjosën sistemin e mallkimit të tokës në varfëri. Bekimi që iu dha Abrahamit ligjëroi bekimin e Perëndisë për Abrahamin dhe pasardhësit e tij me begatinë dhe ndikimin që Perëndia kishte dashur dikur që njeriu ta kishte. Le të lexojmë nga Fjalët e Urta 10:22 bashkë me kuptimin tonë të shkruar brenda kllapave.

Një çelës kryesor:

Bekimi i Zotit [premtimet që iu dhanë Abrahamit] sjell pasuri dhe Ai nuk i shton asnjë vuajtje.

Shprehja “*ai nuk shton asnjë vuajtje*” i referohet sistemit të mallkimit të tokës nga Zanafilla 3:17 - përmes mundit dhe djersës. Fjala hebraike e përkthyer “*vuajtje*” do të thotë gjithashtu punë e vështirë! E sheh? Njeriu mund t'i shpëtojë kufizimeve të mallkimit të tokës të mundit dhe djersës përmes premtimeve që iu dhanë Abrahamit. Po, e di se çfarë po mendon – “Ato premtime iu dhanë vetëm Abrahamit dhe pasardhësve së tij.” Po, por më duhet të të tregoj një tjetër shkrim të shenjtë, Galatasve 3:13-14.

Krishti na shpengoi nga mallkimi i ligjit, sepse u bë mallkim për ne (duke qenë se është shkruar: “I mallkuar është kushdo që varet në dru”), që bekimi i Abrahamit t’u vijë johebrenjve me anë të Jezu Krishtit, që ne të marrim premtimin e Frymës me anë të besimit.

- Galatasve 3:13-14

Tani, nëpërmjet besimit, ne si besimtarë në Jezu Krishtin, kemi pjesë në bekimin që iu dha Abrahamit. Por cili ishte bekimi që iu dha Abrahamit? Ne mund të gjejmë një listë të premtimeve të renditura te Ligji i Përtërirë 28.

Tani, në rast se ti i bindesh me zell zërit të Zotit, Perëndisë tënd, duke pasur kujdes të zbatosh tërë urdhërimet e tij që sot unë po të urdhëroj, do të ndodhë që Zoti, Perëndia yt, do të të lartësojë mbi të gjitha kombet e dheut; të gjitha këto bekime do të bien mbi ty dhe do të të zënë, në rast se dëgjon zërin e Zotit, Perëndisë tënd:

Do të jesh i bekuar në qytete dhe në fshatra. I bekuar do të jetë edhe fryti i barkut tënd, fryti i tokës dhe i bagëtisë sate, pjelljet e lopëve të tua dhe fryti i deleve të tua.

Të bekuara do të jenë shporta dhe magjja jote.

Do të jesh i bekuar kur hyn dhe i bekuar kur del.

Zoti do të veprojë në mënyrë që armiq të e tu, që ngrihen kundër teje, të munden para teje; do të dalin kundër teje nëpër një rrugë, por do të ikin para teje nëpër shtatë rrugë.

Dhe Zoti do ta urdhërojë bekimin të ndodhet mbi ty në hambaret e tua dhe mbi të gjitha ato gjëra ku ti do të vësh dorë; dhe do të të bekojë në vendin që Zoti, Perëndia yt, të jep.

Zoti do të të vendosë në mënyrë që të jesh për të një popull i shenjtë, ashtu si të është betuar, në qoftë se do të respektosh urdhërimet e Zotit, Perëndisë tënd, dhe do të ecësh në rrugët e tij; kështu tërë popujt e dheut do të shohin që ti je i thirrur me emrin e Zotit, dhe do të kenë frikë prej teje. Zoti, Perëndia yt, do të të mbushë me të mira, me frytin e barkut tënd, me frytin e bagëtisë sate dhe me frytin e tokës sate në vendin që Zoti u betua t'u japë etërve të tu.

Zoti do të hapë për ty qiellin, thesarin e tij të mirë, për t'i dhënë tokës sate shiun në kohën e dukur dhe për të bekuar veprën e duarve të tua; ti do t'u japësh hua shumë kombeve, por nuk do të marrësh asgjë hua. Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti, dhe do të jesh gjithnjë lart dhe kurrë poshtë, në rast se u bindesh urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tënd, që sot të urdhëron t'i respektosh dhe t'i zbatosh në praktikë. Kështu nuk do të shmangesh as djathtas, as majtas nga asnjë prej fjalëve që sot ju urdhëroj, për të shkuar pas perëndive të tjera dhe për t'u shërbyer atyre.

- Ligji i Përtërirë 28:1-14

Të gjithë ato premtime, edhe pse në Dhiatën e Vjetër, janë tashmë të tuat që ti t'i shijosh. Ndryshimi i vetëm është që në Dhiatën e Vjetër njerëzit mund t'i merrnin ato nëpërmjet veprimeve të tyre, por ne mund t'i marrim nëpërmjet besimit tonë në Jezu Krishtin sipas besëlidhjes së re. Unë dhe ti, si johebrenj, jemi shartuar; dhe tashmë, nëpërmjet Jezu Krishtit, ne ndajmë të njëjtin Bekim me Abrahamin. Por ne kemi më shumë se bekimin fizik të Abrahamit, ne kemi edhe bekimin shpirtëror të lindjes së re. Tani kemi bekimin fizik, tokësor të Abrahamit, por kemi edhe bekimin e përjetshëm të qiellit dhe Frymës së Shenjtë që banon në të vërtetë në ne si bij dhe bija të Perëndisë. Mos harro, vetëm bijtë dhe bijat marrin trashëgimi; skllevërit nuk munden. Pa lindjen e re, edhe pse Abrahami e donte Perëndinë, Fryma e Shenjtë nuk banoi në të dhe ai nuk mundi të hynte në parajsë. Natyrisht, ai fitoi parajsën pasi Jezusi pagoi borxhin e mëkatit.

Tani e kuptoj se çfarë nënkuptonte në të vërtetë Fjalët e Urta 10:22 kur thotë se Perëndia sjell pasuri dhe nuk shton vuajtje. “*Vuajtje*” në gjuhën hebraike do të thotë punë e vështirë, të cilën tani e kuptova se i referohet sistemit të mallkimit të tokës të mundit e djersës. E kuptova se kjo besëlidhje, ky bekim i premtimit të ndihmës së Perëndisë dhe përfitimeve të Tij, e ngriti Abrahamin mbi mallkimin e tokës dhe e bëri atë të përparojë. Kuptova se përfitimet e atij bekimi siç përcaktohen te Ligji i Përtërirë 28, më treguan qartë se do të përparoja. Efekti i atyre premtimeve ishte që unë isha i paracaktuar për të qenë koka dhe jo bishti, huadhënësi dhe jo huamarrësi. Kjo është e drejta ligjore e çdo fëmije të Perëndisë. Si Jozefi, unë kam bekimin e Perëndisë dhe duhet të përparoj. Unë kam edhe trashëgiminë e të gjithë Mbretërisë së Perëndisë. Si një bir, e gjithë kjo është ligjërish e imja.

Ndërsa e pashë edhe një herë historinë e Jozefit te Zanafilla 39, e pashë qartë se ajo çfarë i kishte bërë përshtypje Potifarit ishte sukcesi i Jozefit dhe ishte gjithashtu sukcesi i dukshëm ai që do të tërhiqte vëmendjen e kombeve të botës dhe t'i lejonte ata të shihnin një ndryshim te njerëzit e Perëndisë.

Kështu tërë popujt e dheut do të shohin që ti je i thirrur me emrin e Zotit, dhe do të kenë frikë prej teje. Zoti, Perëndia yt, do të

të mbushë me të mira, me frytin e barkut tënd, me frytin e bagëtisë sate dhe me frytin e tokës sate në vendin që Zoti u betua t'u japë etërve të tu.

- Ligji i Përtërirë 28:10-11

Te Zanafilla 39:6 gjendej një e dhënë tjetër madhore që e vura re dhe doja që ta shikoje. Meqë po flasim për Potifarin, thuhet: “*Kështu Potifari la gjithçka kishte në dorë të Jozefit dhe nuk shqetësohej më për asgjë, përveç ushqimit të vet*”. E pashë! Këtu ishte një shembull i prehjes për të cilën po flasim. Potifari nuk kishte se pse të shqetësohej për asgjë tjetër përveç ushqimit që do të hante. Kjo nënkupton që sukcesi që Jozefi solli në këtë shtëpi, Bekimi i Zotit, sollën rezultate që e lejuan Potifarin të përqendrohej në detyrën e tij dhe jo tek mbijetesat!

Drenda dhe unë kemi një shprehje që e kemi përdorur prej vitesh: “Pa rregulluar çështjen e parave, nuk do ta zbulosh asnjëherë fatin tënd” dhe nuk ke për ta zbuluar kurrë se kush je në të vërtetë. Nuk ke për ta gjetur kurrë pozicionin tënd, pasionin tënd, nuk do të gjes kurrë vërtet kënaqësi. Do t’i bazosh të gjitha vendimet e tua rreth mbijetesës, gjetjes ose grumbullimit të parave, ose do të shtiresh si dikush që nuk je thjesht për të siguruar një rrogë. Këtu ne shohim efektin e Bekimit të Zotit te Potifari, i cili nuk dinte asgjë lidhur me Mbretërinë e Perëndisë. Duke lënë gjërat e tij nën kujdesin e Jozefit, prona e tij, shqetësimet e tij u transferuan nën besëlidhjen që mbartte Jozefi. Mund ta shikosh qartë çastin kur ka ndodhur kalimi tek vargu 5 i kapitullit 39.

Nga çasti që e bëri kryeadministrator të shtëpisë së tij dhe për gjithçka që zotëronte, Zoti e bekoj shtëpinë e egjiptasit për shkak të Jozefit; dhe bekimi i Zotit përfshiu gjithçka ai kishte në shtëpi dhe në fushë.

- Zanafilla 39:5

Këtu shohim përsëri këtë transferim të diçkaje në mbretërinë e tokës, që është e nënshtruar ndaj sistemit të mallkimit të tokës, që hyn nën juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë, si dhe ndryshimet drastike që ndodhin. Le ta pranojmë: nëse Perëndia po të ndihmon

me mençurinë e Tij, duke të të drejtuar ty drejt vendimeve të duhura, si dhe duke të të paralajmëruar në lidhje me grackat e mundshme, kushdo mund të përparojë! A e sheh? Bekimi i Zotit është i yti!

Ndërsa e studioja këtë kur Zoti po më mësonte rreth Mbretërisë, u pështjellova se si Jozefi pati aq shumë sukses për shkak të këtij bekimi, megjithëse shumica e të krishterëve që unë njoh kanë vështirësi me pagesat e faturave të tyre. Të jesh tërësisht i lirë financiarisht është diçka që shumë veta nuk e mendojnë as si mundësi. Megjithatë, ne kemi një besëlidhje më të mirë të bazuar në premtime më të mira se ato të Dhiatës së Vjetër. Edhe pse e kuptova shumë qartë Bekimin e Zotit, përsëri nuk e dija me saktësi se si ky bekim me jepte përgjigjet që më duheshin - por po mësoja dhe shijoja më shumë liri ndërsa fillova të eksperimentoja dhe të zbatoja atë që Perëndia po më mësonte.

Më pas e ktheva vëmendjen time te Dhiata e Re dhe e pashë Jezusin dhe shërbesën e Tij për të mësuar më shumë se si Mbretëria e Perëndisë po i ndryshonte situatat dhe rrethanat atje.

Dhe ndodhi që Jezusi, kur po ndodhej në bregun e liqenit të Gjenezaretit e ndërsa turma po shtyhej rreth tij për të dëgjuar fjalën e Perëndisë, pa dy barka të lidhura në breg të liqenit, nga të cilat kishin dalë peshkatarët dhe po lanin rrjetat. Atëherë hyri në një nga ato barka, në atë që ishte e Simonit, dhe iu lut që të largohej pak nga bregu. U ul dhe mësonte turmat nga barka.

Dhe kur mbaroi së foluri i tha Simonit: “Shko në të thella, dhe hidhni rrjetat tuaja për të zënë peshk”. Dhe Simon, duke u përgjigjur, i tha: “Mësues, u munduam gjithë natën dhe nuk zëmë asgjë; por, për fjalën tënde, do ta hedh rrjetën.

Dhe, si bënë kështu, zunë një sasi aq të madhe peshku, sa po shqyhej rrjeta.

Atëherë u bënë shenjë shokëve të tyre që ishin në barkën tjetër, që të vinin e t'i ndihmonin. Dhe ata erdhën dhe i mbushën të dy barkat aq sa gati po fundoseshin.

Simon Pjetri, kur pa këtë, i ra ndër këmbë Jezusit dhe i tha: “Zot, largohu prej meje, sepse jam njeri mëkatar”. Në të vërtetë Pjetri dhe të gjithë ata që ishin me të, habiteshin për shkak të sasisë

së peshkut që kishin zënë. E njëjta gjë u ngjau edhe Jakobit dhe Gjonit, bijve të Zebedeut, që ishin shokë të Simonit.

Atëherë Jezusi i tha Simonit: “Mos ki frikë; tash e tutje ti do të jesh peshkatar njerëzish të gjallë”. Pastaj ata, si i nxorën në breg barkat, lanë çdo gjë dhe ndiqnin.

- Lluca 5:1-11

Kjo është historia se si Mbretëria e Perëndisë e ndryshoi sistemin e mallkimit të tokës në jetën e tre peshkatarëve një mëngjes. Nëse e lexon tekstin, zbulon se Pjetri, Jakobi dhe Gjoni kishin peshkuar gjatë gjithë natës pa kapur asgjë. Ashtu siç është tipike për sistemin e mallkimit të tokës të mundit e djersës, ata dolën pa gjë atë natë, pa mundur të shpërbleheshin për punën e tyre. Por kur Jezusi lidhet me Mbretërinë e Perëndisë dhe funksionin e saj, të njëjtët peshkatarë kapin aq shumë peshq, saqë varkat e tyre pothuajse fundosën!

Ndalo!!!! Le të mendojmë pak për atë që sapo lexuam. Asgjë, asnjë peshk, kthehet në një peshkim që gati fundos dy varka? Megjithatë, njerëzit e lexojnë këtë histori dhe e kanë lexuar për mijëra vjet dhe nuk e shikojnë apo mendojnë që kjo gjë mund t'u ndodhë edhe atyre. Pse? Përgjigjja e zakonshme do të ishte se Jezusi ishte aty dhe e bëri Ai. E mban mend historinë që të tregova te Marku 6, ku Jezusi nuk mundi të shëronte njerëz sepse ata nuk kishin besim dhe kështu Mbretëria nuk kishte juridiksion? Dikush duhej t'ia jepte juridiksionin qiellit përpara se qielli të mund të vepronte në këtë situatë.

Dhe Simoni, duke u përgjigjur, i tha: Mësues, u munduam gjithë natën dhe nuk zumë asgjë; por, për fjalën tënde, do ta hedh rrjetën.

Pjetri bëri një marrëveshje me qiellin dhe qielli pati akses ligjor në këtë histori. Përsëri, ne shohim që mbretëria tokësore transformohet nga Mbretëria e Perëndisë. Çmenduri apo jo, ashtu siç njerëzit i kanë parë zogjtë për mijëra vjet por pa e kuptuar se fluturimi ishte i mundur për ta dhe duke mos e provuar kurrë atë. Kështu janë të Krishterët sot,

nuk e kuptojnë se nuk duhet t'i durojnë rrjetat bosh, por kanë akses në fuqinë e qiellit për t'i ndihmuar ata të përparojnë në jetë. Ajo që dua që të shohësh këtu është se të njëjtët djem që dolën pa gjë janë po ata që kishin dy varka aq të mbushura saqë po fundoseshin!

Miku im, ndryshimi është Mbretëria, jo njerëzit. Ti mund të mendosh se nuk ke të ardhme, që del pa gjë, që asgjë nuk funksionon. Por në realitet, e vetmja gjë që të duhet për ta kthyer jetën tënde në një histori sukseesi është Mbretëria. Po, ti ke pjesën tënde për të bërë. Atyre u duhej të dilnin për peshkim - ata duhet të kujdeseshin për rrjetat e tyre dhe të përgatiteshin për peshkimin - por të gjithë mund të peshkojnë nëse Perëndia ua tregon vendin e duhur.

Dëgjo, sistemi i mallkimit të tokës, i vrapimit dhe i djsitjes, nuk mund të japë rezultat. Ti nuk mund të vraposh aq shpejt dhe aq gjatë sa duhet për t'i arritur ëndrrat e tua. Perëndia nuk ka pasur kurrë qëllimin që ti të shtrëngosh dhëmbët dhe të përpiqesh me forcat e tua për t'i bërë gjërat.

Duke përdorur ligjet dhe premtimet e Mbretërisë se Perëndisë, ne mund të fluturojmë në vend që të ecim. Më lejo ta them ndryshe. Edhe pse ligji i gravitetit është ende në veprim, ne mund të fluturojmë duke përdorur një ligj tjetër, ligjin e ngritjes, dhe të shijojmë një mënyrë krejtësisht të re të jetesës.

Ki parasysh, kur vjen te Krishti, ti bëhesh një pjesëtar i Mbretërisë së Perëndisë. Si një qytetar, ty të takojnë të drejta ligjore; dhe si bir apo bijë, ty të takon të kesh të drejtën në trashëgimi. Të drejtat dhe përfitimet e tua ligjore të kanë vendosur mbi sistemin e mallkimit të tokës me varfëri, sëmundje e dështim.

Imagjino se si mund t'u jetë dukur ky varg izraelitëve të cilët kanë qenë skllavër gjithë jetën e tyre. Në fakt, për aq sa mund të mbanin mend, e vetmja gjë që dinin ishte skllavëria. Këto janë fjalët që Moisiu ia tha kombit të Izraelit ndërsa ata ishin nisur për të hyrë në tokën e premtuar.

Kur pastaj Zoti, Perëndia yt, do të të fusë në vendin për të cilin iu betua etërve të tu, Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, të të japë qytete të mëdha dhe të bukura që TI NUK I KE

NDËRTUAR, dhe shtëpi plot me të mira që ti nuk i ke mbushur, puse të çelur që ti nuk i ke gërmuar, vreshta dhe ullishte që ti nuk i ke mbjellë; kur të kesh ngrënë dhe të jesh ngopur, ki kujdes të mos harrosh Zotin që të nxori nga vendi i Egjiptit [mbretëria tjetër], nga shtëpia e SKLLAVËRISË [mbretëria e skllavërisë].

- Ligji i Përtërirë 6:10-12

Si ish-sklevër, e vetmja mënyrë që ata dinin për të bërë diçka ishte me djersë dhe me mund. Por këtu Zoti po u thoshte se puna e tyre nuk do t'ua siguronte atë që u duhej. Ai nuk po u thoshte se nuk do të punonin më për asgjë, por se nuk ishin më të lidhur me një sistem që kërkonte punë sa për të mbijetuar. Perëndia thotë se ata do të përparonin në tokën ku Ai po i drejtonte.

Më lejo ta mbyll këtë kapitull dhe me një histori të fundit që do të ilustrojë më tej atë që po them. Mua dhe Drendës nuk na pëlqejnë shumë makinat. Disa njerëz i pëlqejnë dhe mund të t'i renditin të gjitha makinat që kanë qejf. Për disa arsye, neve nuk na kanë pëlqyer asnjëherë makinat. Tani, mos më keqkupto. Neve na pëlqejnë gjërat e bukura, por nuk e kemi ndjerë nevojën e ndonjë makine të veçantë. Zakonisht blejmë një makinë dhe e ngasim për 10 vite ose më shumë. Sigurisht, ne kujdesemi për makinat tona që ato mos të duken si të vjetra, por për sa kohë ato punojnë dhe duken mirë, ne jemi të lumtur.

Por para disa vitesh, kisha jonë mori me qira disa makina Escalade për një konferencë që po mbanim. Ne i morëm me qira që të mund t'i shëtisnim të ftuarit tanë dhe donim makina të mira për ta bërë këtë. Por kjo nuk ishte hera e parë që e bënim një gjë të tillë. E kemi bërë gjithmonë. Por ishte hera e parë që i shëtisnim ndërkohë që i kishim brenda ambientit për veprimtarinë. Nuk jam i sigurt pse po e ngasim

**GJITHÇKA QË TË DUHET ËSHTË
QË MBRETËRIA TA KTHEJË
JETËN TËNDE NË NJË HISTORI
SUKSESI. PO, TI DUHET TË BËSH
PJESËN TËNDE.**

njërën gjatë kësaj veprimtarie, por po ktheheshim në shtëpi me të gjatë natës. Dhe e di çfarë? Na pëlqeu shumë. Mua dhe Drendës na pëlqeu se si ecte dhe se si dukej.

Në atë kohë ne ngisnim një Honda Pilot të vjetër, por Escalade ishte një gradë më lart Pilot-it me siguri. Ishte modeli me ngjyrë perle platini të bardhë dhe ishte versioni më i shkurtër. Nëse di ndonjë gjë për këto makina të tipit Escalade, e di që ato ofrohen në dy madhësi, e gjata dhe e shkurtra. Ne pëlqenim modelin e shkurtër, sepse dukej sikur manovrohej më lehtë. Ndërsa po i jepja Escalade-s me Drendën, ajo më tha: “E di çfarë, më pëlqen kjo; mendoj se duhet të blejmë një si këto.” Isha dakord. “Duhet të blejmë pikërisht një si kjo, modeli i shkurtër në ngjyrë të bardhë perlë.” Të dy ramë dakord.

Edhe pse ne nuk i treguam askujt për këtë bisedë, afërsisht një muaj më vonë, ndërsa po dilja jashtë të merrja gazetën time, më ra telefoni. E dallova nga zëri që ishte dikush nga kisha ime. Ai më tha: “Alo” dhe pastaj më tha se donte të më blinte një Escalade. U shtanga për një minutë por ai tha: “Mrekulli!” Më pas më pyeti se çfarë ngjyre do ta doja dhe unë i thashë se do të doja shumë të bardhën perlë. Ai më tha: “Do të të telefonoj përsëri pasi ta marr një për ty”. Megjithatë, ai as nuk më pyeti nëse doja modelin e gjatë apo të shkurtër. Kaloi një muaj dhe mendova se mos kishte harruar për makinën, por natyrisht, më mori në telefon dhe na tha që e kishte gati Escalade-n që ne të shkonim ta merrnim.

Kur po e takonim, pamë një version perlë të bardhë, të shkurtër të Escalade-s që ishte parkuar aty. Ishte e përsosur në çdo gjë, pa asnjë të gërvishtur, me të vërtetë e përsosur. I thamë atij që e adhuronim. Ai na kërkoi të falur, duke thënë se i vinte keq për vonesën por që, edhe pse ishte munduar të gjente modelin e gjatë, kishte mundur të gjente vetëm modelin e shkurtër. Ne qeshëm dhe i thamë: “E shkurtra ishte ajo që donim.” I dhamë makinës për në shtëpi dhe menduam se ishim njerëzit më të pasur në planet që i jepnim asaj makine. Por e di çfarë? Ato makina Escalade kanë vite që qarkullojnë. Thjesht nuk e kisha menduar kurrë të blija një të tillë! Për ta kuptuar plotësisht këtë histori, duhet të dish se kam dhuruar tetë makina në të shkuarën, pra kisha mbjellë farë në lidhje me makinat. Thjesht nuk e kisha shprehur kurrë që e doja një.

P.S. - E di çfarë po mendon, që këto gjëra i ndodhin vetëm predikuesve. Epo, unë kam 36 vjet në fushën e financës dhe kam folur me shumë predikues. Të jem i sinqertë, shumica prej tyre i shpenzojnë të gjitha paratë për nevojat bazë. Jo, këto gjëra nuk na kanë ndodhur dhe nuk na ndodhin neve për shkak se predikojmë në lidhje me Mbretërinë, por sepse jetojmë në Mbretëri dhe zbatojmë ligjet e saj në jetën tonë. Në fakt, sa për sqarim, unë i kam larë borxhet para se ta hapja kishën time. Nuk e hapa kishën sepse kisha nevojë për një punë që të paguaja borxhet e mia. E hapa kishën time për t'u thënë njerëzve atë që unë dhe Drenda kishim zbuluar - lajmin e mirë të Mbretërisë!

KAPITULLI 6

JETA KA GJËRA MË TË RËNDËSISHME SESA PAGIMI I FATURAVE!

Dukej sikur pati një oazë e shkurtër gjallërie në stuhinë e jetës me të cilën po përballesha. Një pasdite kishim ftuar rreth 50 njerëz në shtëpinë e vjetër në fermë për të shijuar një zjarr të madh, salsiçe të pjekura dhe shoqërinë. Kjo ka ndodhur gjatë viteve të stresit të skajshëm pa para, vetëm me mundimin për të mbijetuar edhe një javë tjetër. Mezi e prisja atë ngjarje meqë isha i lodhur emocionalisht dhe kisha nevojë për diçka pozitive ku të përqendrohesha për pak kohë. Mbrëmja pati shumë sukses: ushqimi ishte i shkëlqyer, shumë nga miqtë tanë erdhën me fëmijët e tyre dhe ne të gjithë po kalonim një kohë të mirë. Shtëpia ishte e mbushur plot kur në derë u dëgjua një e trokitur. Mendova se mund të ishte një person me vonesë në takimin tonë, por kur e hapa derën, më përshëndeti një punonjës i kompanisë elektrike. Ai tha me mirësjellje se kishte ardhur për të më prerë dritat për faturën e papaguar. U tmerrova. Shtëpia ime ishte e mbushur me

mysafirë dhe mua më duhej korrenti, përveç se do të turpërohesha.

I kërkova shpejt punonjësit të largohej nga dera e të shkonim një minutë në oborrin e pasmë. E pyeta se çfarë do të duhej për të mos i hequr dritat dhe ai më dha një shumë. “Tepër e lartë”, mendova unë. “A mund ta ulësh pak?” Ai u mendua për një çast dhe pastaj më dha një shifër më të ulët. “A mund ta mbash çekun deri të martën përpara se ta depozitosh?”, e pyeta. Ai tha: “Pa problem”, dhe unë e mbusha çekun. Atë të premtë nuk kishte para në llogarinë time dhe nuk e dija se si mund të mbushej përpara të martës, por të paktën energjia elektrike nuk u ndërpre gjatë gjithë fundjavës. Nuk e mbaj mend se çfarë bëra të martën, por me siguri gjeta diçka për ta lënë peng.

Kjo ishte një ditë e jetës sonë e jetuar në mosfunksionim financiar. Tani përfytyro të jetosh kështu për nëntë vjet! Të jetuarit nën një stres të tillë ta bllokoi çdo vizion dhe largoi tutje çdo grimcë gëzimi që mund të sjellë dita. Çdo mendim është i përqendruar te mbijetesë, ku të gjeshe para për të paguar faturën e radhës. A harxhova shumë javën që kaloi? A duhet ta marr me vete makinën llogaritëse kur dal të psonis për t’u siguruar që të mos e tejkaloj shumën? Gjithë kohës duke menduar se si ta bëj diçka në mënyrën më ekonomike të mundshme. Mik, kjo nuk është jetesë! Hidhi një sy asaj që thotë Mateu 6:25.

Prandaj po ju them: mos u shqetësoni për jetën tuaj, për atë që do të hani ose do të pini, as për trupin tuaj, për atë që do të vishni. A nuk është vallë jeta më me vlerë se ushqimi dhe trupi më me vlerë se veshja?

- Mateu 6:25

Jezusi po thotë se gjërat e jetës nuk janë jeta! Gjithçka këtu në jetë është për të mbështetur jetën, qëllimin tonë. Por meqë Adami e humbi providencën e Perëndisë, jeta u përmbys dhe tani gjithçka që e mbështet jetën është më e rëndësishme se vetë jeta. Njerëzit nuk e kanë idenë se çfarë është jeta e vërtetë dhe me siguri nuk e dinë se kush janë në të vërtetë. Pyet këdo se kush është dhe do të të thotë se me çfarë merret. “Unë jam doktor, unë jam agjent pronash të paluajtshme”, etj. Jo, kjo nuk është ajo që ti je; është puna që ti bën. Njeriu i ka humbur

ëndrrat e tij. Ajo që dua të them është se tani njeriu ëndërron se si të fitojë më shumë para por e ka humbur ëndrrën e qëllimin. Me fjalë të tjera, ajo që i siguron më shumë para bëhet ëndrra e tij. Megjithatë, për shkak se çdo person është i krijuar në mënyrë unike me talente dhe aftësi të ndryshme, secili e gjen veten në një punë ose profesion që nuk është pasioni i tij. Jeta kthehet në javë të tejzgjatura në pritje të lirisë së fundjavës, ose jetë të stërlodhura në pritje të pensionit.

Më lejo të të bëj një pyetje. Po të mos kishe nevojë për para, të kishe më shumë para nga ç'mund të harxhosh në jetën tënde, çfarë do të bëje? Me siguri do të gjeje diçka ndryshe nga ajo që po bën tani. Sikurse e përmenda më parë, e di nga statistikat se të paktën 70% e amerikanëve, kur u pyetën nëse e pëlqejnë punën e tyre, thanë se nuk merren me atë që u pëlqen. Dua të kuptosh se kjo rendje pas pasurisë, ky presion për performancë dhe shqetësimi i vazhdueshëm për të nesërmen nuk kanë qenë kurrë plani fillestar i Perëndisë.

Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën. Dhe Perëndia i bekoi; dhe Perëndia u tha atyre: “Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni, e sundoni mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit dhe mbi çdo qenie që lëviz mbi tokë”.

Dhe Perëndia tha: “Ja unë po ju jap çdo bar që lëshon farë mbi sipërfaqen e mbarë tokës dhe çdo pemë të ketë fruta që përmbajnë farë; kjo do t’ju shërbejë si ushqim. Dhe çdo kafshë të tokës, çdo zogu të qiellit dhe çdo gjëje që lëviz mbi tokë dhe ka në vetvete një frymë jete, unë i jap çdo bar të gjelbër si ushqim”. Dhe kështu u bë.

Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumë mirë. Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj erdhi mëngjesi: dita e gjashtë.

- Zanafilla 1:27-31

Njeriu u krijua në ditën e gjashtë të krijimit – në fund të ditës së gjashtë, për saktësim. Ai u krijua në fund të ditës së gjashtë për shkak se u krijua për të qëndruar me Perëndinë në ditën e shtatë, ditën që ne

e njohim si dita e pushimit.

Kështu përfunduan qielli dhe toka si dhe tërë ushtria e tyre. Ndërkaq ditën e shtatë Perëndia mbaroi veprën që kishte kryer dhe ditën e shtatë u çlodh nga gjithë vepra që kishte kryer. Dhe Perëndia bekoji ditën e shtatë dhe e shenjtëroi, sepse atë ditë Perëndia u çlodh nga gjithë vepra që kishte krijuar dhe kryer.

- Zanafilla 2:1-3

Bibla thotë se Perëndia pushoi në ditën e shtatë. Ai nuk ishte i lodhur!

**PASURIA NA TËRHEQ ME
ARRATISJEN E MUNDSHME NË
NJË VEND PREHJEJE — NJË VEND
KU MUND TË PËRQENDROHEMI
NË ATË QË DUAM TË BËJMË ME
TË VËRTETË, TË JETOJMË JETË
PLOT ME QËLLIM NË VEND TË
MBIJETESËS.**

Ai mbaroi punë. Gjithçka përfundoi. Gjithçka që njeriut do t'i duhej ndonjëherë mbi tokë ishte gati aty kur të shfaqej ai. Paqe! Njeriut i ishte siguruar gjithçka që do t'i duhej ndonjëherë. Nuk kishte shqetësim për pagesën e faturave, asnjë shqetësim se mos sëmurej. Ai kishte një trup të përsosur dhe një bashkëshorte të përsosur. E vetmja gjë ku duhet të përqendroheshin ishte njëri-tjetri, Perëndia dhe detyra e

tyre ose qëllimi i tyre. Adami menaxhonte tokën: ai sundonte mbi të plotësisht me anë të autoritetit dhe fuqisë së Mbretërisë së Perëndisë. Por ne tashmë e dimë se si përfundoi kjo histori.

Adami dhe Eva kryen tradhti kundër Mbretërisë së Perëndisë dhe e humbën pozicionin e tyre, e humbën providencën e tyre dhe qëllimin e tyre. Qëllimi i tyre u bë ai i mbijetesës. Tani mendimet dhe përpjekja e tyre për të mbijetuar konsumoheshin nga shqetësimi dhe frika. Sikurse thotë Zanafilla 3:17, duhej mund e djersë.

Adami e humbi ditën e shtatë!

Nuk kishte prehje, nuk kishte paqe. Një paplotësi e errët e pllakosi jetën e tij dhe Adamit iu desh të vraponte për t'u larguar nga zbrazëtia. Njeriu ka jetuar në këtë gjendje zbrazëtie që nga ajo kohë. Por kishte shpresë. Kur njeriu mëkatoi, Perëndia i dha atij një kujtim, një simbol po të duash ta quash, të asaj që Ai do t'ia rikthente një ditë krijimit të Tij. Quhej shabat. Fjala *shabat* do të thotë fjalë për fjalë pushim. Dita e shtatë e javës iu dha njeriut si ditë shabati. Kërkesa për shabatin, siç mund ta imagjinosh, ishte të mos punonin; nuk lejohej puna e lodhshme dhe me djersën e ballit. Ishte një ditë kur njeriu duhet të ndalonte, të gëzonte familjen e tij dhe të adhuronte Perëndinë. Gjithçka që nevojitej për shabatin duhet të sigurohej përpara se të fillonte shabati. Edhe dreka e shabatit duhet të përgatitej një natë më parë. Ishte një ditë pushimi me providencë të plotë dhe çdo nevojë e mundshme ishte siguruar deri në hollësi paraprakisht. Njeriu mund të ndalonte dhe të mendonte për diçka të ndryshme nga mbijetesja.

Shabati ishte vetëm kaq, një ditë. Por që nga ajo kohë njeriu ka ëndërruar për prehje. Kërkimi i njeriut për pasuri është një simptomë e dëshirës së tij për të qenë i lirë nga puna e lodhshme dhe me djersën e ballit që e ka mbajtur atë të burgosur gjithë jetën e tij. Pasuria na tërheq me arratisjen e mundshme në një vend prehjeje – një vend ku mund të përqendrohemi në atë që duam të bëjmë me të vërtetë, të jetojmë jetë plot me qëllim në vend të mbijetesës.

Sot, shabati, dita e shtatë, pavarësisht nëse e feston të shtunë apo të diel, nuk nderohet shumë në kulturën tonë. Po, shumica e njerëzve që shkojnë në kishë shkojnë të dielën në mëngjes. Megjithatë, duke e parë kulturën në tërësinë e saj, nuk do të mund ta dalloje atë nga ditët e tjera të punës. Kur isha fëmijë, gjithçka mbyllej të dielën. Nuk mund të dilje për psonisje të dielën; nuk mund të blije as karburant të dielën. Babai im duhet të sigurohej që të blinte naftë të shtunën mbrëma në mënyrë që të kishte atë që i duhej për të dielën. Nëse më njeh sado pak, duhet ta dish se më pëlqen të dal për gjueti, por si gjahtar, as këtë gjë nuk mund ta bëj ditën e diel. Ka qenë e jashtëligjshme të gjuaje ditën e diel. Njerëzit e kishin zakon që të dielave të vishnin rrobat më të mira dhe të shtronin dreka të mëdha familjare. Por sigurisht, e gjithë kjo ka

ndryshuar sot. Por tabloja e vërtetë e shabatit nuk ka ndryshuar.

Por sado mirë që bëheshin përgatitjet për ditën e shabatit, sado madhështore të ishte dreka familjare, e hëna do të vinte. Shprehja “Mërzitja e të hënës në mëngjes” ka qenë sinonimi i fjalës “mundim” për aq kohë sa e mbaj mend unë. “Duhet të shkoj në punë” dhe “të kthehem prapë në llogore” ishin shprehje që përdorëshin për ta përshkruar të hënën në mëngjes. Dhe nëse ndalon dhe e mendon pak, ngjante pothuajse me skllavërinë. Por falë Zotit është e premtë! Edhe sot, fundjava dhe shabati ofrojnë një vend prehjeje të shkurtër për shumicën e njerëzve. Por është jetëshkurtër dhe ajo që na pret është bllokimi i trafikut të mëngjesit të së hënës.

Por po sikur të kishë një mënyrë për ta jetuar jetën në një shabat të vazhdueshëm. Sa e mrekullueshme do të ishte nëse do të ekzistonte me të vërtetë një mënyrë për ta jetuar jetën pa frikë, plot me providencë, plot qëllim dhe të jetonim në një vend prehjeje! Unë dhe Drenda jetuam një jetë me mundim, frikë, sëmundje dhe pasiguri për nëntë vite të gjata, derisa zbuluam se prehja e shabatit ishte në fakt një mundësi për jetën tonë. E kam seriozisht!

Mbetet, pra, një pushim i së shtunës për popullin e Perëndisë. Sepse kush ka hyrë në prehjen e tij, ka bërë pushim edhe ai nga veprat e veta, ashtu si Perëndia nga të tijat. Le të përpiqemi, pra, të hyjmë në atë prehje, që askush të mos bjerë në atë shembull të mosbindjes.

- Hebrenjve 4:9-11

SA E MREKULLUESHME DO TË ISHTE NËSE DO TË EKZISTONTE ME TË VËRTETË NJË MËNYRË PËR TA JETUAR JETËN PA FRIKË, PLOT ME PROVIDENCË, PLOT QËLLIM DHE TË JETONIM NË NJË VEND PREHJEJE!

Mik, kjo është Dhiata e Re. Shabati i prehjes është në dispozicion të të gjithë njerëzve të Perëndisë sot. Ky shkrim i shenjtë nënkupton se ne mund të hyjmë në prehjen e Perëndisë dhe të çlodhemi nga puna jonë. Mos e harro

atë që sapo e studiuam: prehja e Perëndisë thotë se gjithçka është e plotë, e përfunduar dhe providenca është me të vërtetë në dispozicion. Ekziston çlirim nga mendësia e mbijetesës, liri nga të qenit i burgosur në varfëri dhe shpëtim nga sëmundja. Ka mundësi të reja! Shabati nuk ishte një informacion vetëm i Dhiatës së Vjetër; është edhe për ne gjithashtu.

Por para se të mendosh se po flas për të jetuarit sërish sipas të gjithë legalizmit dhe ritualeve të Dhiatës së Vjetër, gabohesh. Përkundrazi, dua ta shqyrtoj këtë prehje shabati për të cilën flet libri i Hebrenjve. Sepse, ashtu siç e zbuluam unë dhe Drenda, këtu gjendet një çelës shumë i rëndësishëm për funksionimin e Mbretërisë së Perëndisë dhe providencën që Perëndia synon për jetën tonë.

ELEMENT TRONDITËS: SHABATI NUK ËSHTË MË NJË DITË!

Shpresoj që kjo thënie të ta ketë tërhequr vëmendjen. Në trupin e Krishtit ka pasur shumë debat lidhur me mënyrën se si duhet festuar shabati: të dielën, të shtunën, ose duke filluar në perëndimin e të premtes mbrëma e deri në perëndimin e së shtunës mbrëma. Denominacione të shumta bazohen në interpretimin e tyre për shabatin. Përpara se ta fluturosh këtë libër në anën tjetër të dhomës me përçmim, duke menduar se jam një heretik, të lutem bëj edhe një çast durim me mua dhe le të shohim Kolosianëve 2:16-17.

Prandaj askush të mos ju gjykojë për ushqime ose pije, për festa o hënë të re, o të shtuna; këto gjëra janë hija e atyre që kanë për të ardhur; por trupi është i Krishtit.

- Kolosianëve 2:16-17

Kushtoji vëmendje të veçantë asaj që thotë Pali. Dita e shabatit ishte një hije e gjërave që do të vinin: gjithsesi, realiteti gjendet në Krishtin. Dita e shabatit ishte një hije, nuk ishte e vërteta. Nëse Krishti është e vërteta, atëherë dita e shabatit ishte një hije se kush është Ai dhe çfarë

bëri Ai. Më lejo ta them në këtë mënyrë: dita e shabatit nuk përmban fuqi për të hequr ose ndryshuar sistemin e mallkimit të tokës me mund dhe djersën e ballit që Adami e solli mbi mbretërinë tokësore. Nëse e nderon me rigorozitet atë, në vetvete dhe prej saj nuk ka ndonjë fuqi për të të liruar. Por është një hije, një tablo e asaj që do të gjesh në Krishtin.

Kur isha në klasën e parë, mësuesi im na vuri të gjithëve të bënim vizatime silueta të kokave tona në profil. Morën një aparat projektues dhe na vunë të uleshim përpara tij dhe ai e projektoi hijen e kokave tona në një copë letër të bardhë. Më pas e vizatuan konturin e hijes sonë dhe i krijuan siluetat tona, të cilat i premë dhe ua çuam në shtëpi mamave tona për Ditën e Nënës. Hija përmbante një fare ngjashmërie me mua, por nuk simbolizonte thelbin tim, karakterin ose personalitetin tim. Por jepte një farë informacioni rreth meje.

Shabati bëri të njëjtën gjë. Hija e tij thoshte të mos punonim, të mos kishim mund e djersë. Ishte thjesht një hije; megjithatë, jo e vërteta. Por ai drejtonte te Jezu Krishti, që, në fakt, na ka çliruar nga mallkimi i ligjit dhe sistemi i mallkimit të tokës dhe na ka rivendosur si bij dhe bija të Perëndisë dhe qytetarë të Mbretërisë së madhe të Perëndisë! E përsëris, ishte një tablo e asaj që Jezusi do të na rikthente një ditë. Është një punë e përfunduar ku gjithçka që na duhet për jetën na është rikthyer sërish. Megjithatë, siç thotë Hebrenjve, ne hyjmë në prehjen e tij nëpërmjet besimit. Ki parasys, kërkohet besim për të ligjësuar juridiksionin e qiellit këtu në mbretërinë tokësore. Krishti thirri në kryq: “U krye!”, ashtu si Perëndia tha që u krye në fund të ditës së gjashtë.

Shabati për shumicën e njerëzve sot është një ditë fetare. Njerëzit e shohin shabatit si dita e Perëndisë, një ditë kur ti i detyrohesh Perëndisë të shkosh në kishë, të bësh gjëra për Perëndinë dhe të bësh gjëra të tjera fetare. Jezusi u detyrua t'i korrigjonte dishepujt e Tij, që kishin të njëjtën mendësi.

E shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunën.

- Marku 2:27

Shabati u krijua për njeriun dhe jo njeriu për shabatin. A e di se shumë njerëz ndihen fajtorë nëse mungojnë në kishë? Përse ndiejnë faj që mungojnë në kishë kur, në fakt, ata janë kisha? Nuk po them se ne nuk duhet të mblidhemi fare së bashku për të adhuruar, por mendësia tregon se ata kanë një këndvështrim të gabuar të shabatit.

E di se mund të jesh ende i pështjelluar, prandaj më lejo të thellohem pak më shumë duke parë një koment që Jezusi e tha te Gjoni 11.

Kur arriti Jezusi, pra, gjeti që Llazari ishte që prej katër ditësh në varr. Por Betania ishte rreth pesëmbëdhjetë stade larg Jeruzalemit. Dhe shumë Judenj kishin ardhur te Marta dhe te Maria për t'i ngushëlluar për vëllanë e tyre. Marta, pra, si e mori vesh se po vinte Jezusi, i doli përpara; kurse Maria ishte ulur në shtëpi.

Marta i tha Jezusit: "Zot, po të ishe këtu, im vëlla nuk do të kishte vdekur; por edhe tani e di se të gjitha ato që ti i kërkon Perëndisë, Perëndia do të t'i japë". Jezusi i tha: "Yt vëlla do të ringjallet".

Marta i tha: "E di se do të ringjallet, në ringjallje, ditën e fundit". Jezusi i tha: "Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë. A e beson këtë?".

Ajo i tha: "Po, Zot, unë besoj se ti je Krishti, Biri i Perëndisë, që duhet të vinte në botë."

- Gjoni 11:17-27

Jezusi tha se Ai ishte ringjallja; nuk ishte një ditë e zakonshme. Dita e shabatit ishte një hije e saj që bëri Jezusi në kryq për ne. Jezusi është shabati i vërtetë dhe në Të ne gjejmë hyrjen në Mbretërinë e Perëndisë dhe në gjithçka që ka ajo. Kështu mund të gjejmë prehje!

Prandaj, le të kthehemi tani në shkrimin e Dhiatës së Re te Hebrenjve.

Mbetet, pra, një pushim i së shtunës për popullin e Perëndisë. Sepse kush ka hyrë në prehjen e tij, ka bërë pushim edhe ai nga veprat e veta, ashtu si Perëndia nga të tijat. Le të përpiqemi, pra, të hyjmë në atë prehje, që askush të mos bjerë në atë shembull të mosbindjes.

- Hebrejve 4:9-11

Hija e ditës së shabatit thotë se e ke të ndaluar të mundohesh dhe djersitesh për atë që të duhet në ditën e shabatit; ajo thjesht po na jepte një pamje të shpejtë të asaj që bëri Jezusi, pra që na çliroi nga sistemi i mallkimit të tokës që na detyronte të mundoheshim dhe djersiteshim për të mbijetuar. Me fjalë të tjera, ajo që portretizohet u bë realiteti i Krishtit. Në fakt, mesazhi i parë që predikoi Jezusi ndonjëherë synonte ditën e shabatit. Tek Isaia 61 ne gjejmë fjalët e predikimit të Tij të parë fare, që e predikoi te Lluca 4.

Fryma e Zotit, Zoti është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t'u dhënë një lajm të mirë të përlururve.

- Isaia 61:1

Duke thënë se kishte një mënyrë për të dalë nga varfëria, ai po thoshte se kishte një mënyrë për të dalë nga sistemi i mallkimit të tokës me mund e djersë. Ishte kjo skllavëri për të gjetur providencë që i mbajti njerëzit të burgosur dhe të paaftë për të gjetur prehjen e tij. Por dita e shabatit nuk ishte tabloja e vetme që Perëndia i dha popullit të Tij rreth asaj që do të rivendosej një ditë. Ishte edhe viti shabatik!

Në mbarim të çdo shtatë viteve do të bësh faljen e borxheve. Dhe kjo do të jetë forma e faljes: Çdo huadhënës do të falë atë që i ka dhënë hua të afërmit të tij; nuk do të kërkojë kthimin e saj nga i afërmi dhe nga vëllai i tij, sepse është shpallur falja e borxheve nga Zoti. Mund ta kërkoh borxhin nga i huaji; por do t'i falësh vëllait tënd atë që ai të ka marrë hua.

Nuk do të ketë asnjë nevojtar midis jush, sepse Zoti do të të bekojë me të madhe në vendin që Zoti, Perëndia yt, po të jep si trashëgimi, që ti ta zotërosh, por vetëm me kusht që ti t'i bindesh me zell zërit të Zotit, Perëndisë tënd, duke pasur kujdes të zbatosh në praktikë të gjitha këta urdhërimet, që sot të cakton. Sepse Zoti, Perëndia yt, do të të bekojë siç të ka premtuar; atëherë do t'u japësh hua shumë kombeve, por ti nuk do të kërkoh hua; do të sundosh mbi shumë kombe, por ato nuk do të sundojnë mbi ty.

- Ligji i Përtërirë 15:1-6

Vër re që ata duhet ta fshinin çdo borxh çdo shtatë vjet. Sërish, ne shohim Perëndinë të përdorë numrin shtatë për të treguar se gjithçka është e plotësuar. Nuk mungon asgjë; Ai ka siguruar gjithçka që i duhet njeriut. Megjithatë, nëse dikush do ta vinte në pikëpyetje urtësinë e Tij që u tha t'i falnin borxhet, Ai shtoi: **“Nuk do të ketë asnjë nevojtar midis jush, sepse Zoti do të të bekojë me të madhe në vendin që Zoti, Perëndia yt, po të jep si trashëgimi, që ti ta zotërosh.”** Ai vazhdoi duke thënë se ata do të bekoheshin aq shumë, saqë do të bëheshin huadhënës dhe jo huamarrës. Sërish këtu shohim se sistemi i mallkimit të tokës me mund e djersë u anulua dhe u bë i pavlefshëm me anë të një ligji të ri të jetës, që na nxori nga mallkimi i ligjit të mëkatit dhe vdekjes.

Ashtu si në ditën e shabatit, ata nuk duhet të mundoheshin dhe djersiteshin për një vit të tërë; prandaj, atyre nuk u lejohej që të mbillnin. Në këtë pikë dikush mund të thotë: “Hej, unë mund të mbijetoj një ditë me atë që ka frigoriferi, por të mbijetoj një vit të tërë pa punuar është pak më e vështirë.”

Dhe ja sërish hija na thotë që t'i falim borxhet tona. Ai u tha atyre se nuk do të duhej të merrnin borxh ngaqë do të kishin aq shumë, saqë do të bëheshin huadhënës dhe jo huamarrës. Borxhi është një sistem i bazuar në pamjaftueshmëri, por Perëndia do të sigurojë plotësisht për ta që borxhi të mos jetë më i nevojshëm. Hija thotë: “Nuk duhet të mbillni” duke iu referuar një mënyre të re të jetuari jashtë sistemit të mallkimit të tokës. Tani e gjithë kjo gjendet te Jezu Krishti.

Por prit, ka edhe më tepër – tabloja më e madhe që do t'u tregonte njerëzve të Perëndisë se çfarë do të vinte. Ai quhej viti jubilar.

KAPITULLI 7

KJO ËSHTË E PAMUNDUR!

Ajo që do të lexosh pas pak është e mrekullueshme! Jo, më lejo ta them në një mënyrë tjetër. Në fakt, ti do të mendosh se është plotësisht e pamundur. E kam fjalën për vitin jubilar, tabloja më e madhe e asaj që Jezusi dëshiron të bëjë në financat tua, e shkruar në Dhiatën e Vjetër, megjithëse shumë pak njerëz e dinë ose e kuptojnë se çfarë thuhet aty. Ne kemi folur tashmë për ditën e shabatit, vitin shabatik, se si që të dy janë hije të asaj që kemi në Krishtin, por tani mbërrijmë tek ngjarja e madhe: viti jubilar.

Emri në vetvete tingëllon si një festë, apo jo? Megjithatë, në fushën e financave, shumica e njerëzve – dhe kur them shumica e njerëzve, fatkeqësisht kjo do të thotë edhe shumica e të krishterëve – nuk kanë shumëçka të festojnë. Sikurse thashë, unë kam qenë aktiv në fushën financiare për 36 vjet tashmë. Gjatë kësaj kohe kam qenë pronar i shumë kompanive dhe kam punuar njëkohësisht me dhjetëra në mos qindra mijëra njerëz për financat e tyre personale. Prandaj e di se si është gjendja. Dhe e di se çfarë fshihet zakonisht pas një makine të re plot shkëlqim apo një shtëpie të madhe e të bukur. Zakonisht shumë borxhe dhe stres. Hej, nuk po them se është keq të kesh një makinë të bukur apo një shtëpi të madhe. Vetëm se kostoja e sotme e jetesës është shumë e lartë.

Dhe sistemi i mallkimit të tokës është një sistem mbijetese që përgjithësisht nuk do të arrijë t'i çlirojë njerëzit. Më beso, nga mijëra e

mijëra njerëz që kam takuar, shumica nuk ishin njerëz të këqij. Ata po bënë më të mirën që mundeshin me forcat e tyre dhe nuk e njihnin mbretërinë e Perëndisë dhe as atë që po jap në këtë libër. Sigurisht, ti e di se unë dhe Drenda jetuam vetë një stil jetese me stres financiar për nëntë vite të gjata e të vështira, derisa mësuam rreth prehjes së shabatit. Pasi jeton në atë mënyrë për aq gjatë, nuk e kupton se sa shumë mosfunksionim duron dhe madje të duket se është normal.

Para disa vitesh Perëndia foli me mua lidhur me mendësinë time të vogël dhe më njoftoi se duhet të shijoj jubileun, festën, por unë nuk e bëja. Po, nuk kisha borxhe; po, kisha parë të ndodhnin gjëra të mrekullueshme; dhe po, isha i lumtur dhe i kënaqur. Por kisha reshtur së ëndërruari dhe Perëndia e dinte dhe donte që të zgjerohesha përsëri që të vazhdoja të krijoja dhe të ëndërroja. Sikur isha bërë i ndenjtur, i lumtur por i ndenjtur.

Siç thashë, unë zotëroj një kompani shërbimesh financiare dhe çdo vit, një nga shitësit e mi më ftonë në një ngjarje për të festuar suksesin e vitit të mëparshëm. Pjesëmarrësit ishin rreth 250 nga bashkëpunëtorët dhe drejtuesit kryesorë. Ishte një udhëtim i paguar me të gjitha shpenzimet në disa vende shumë të bukura, por për disa më të mirët, pati një mirënjohje të veçantë dhe çeqe shpërblimesh. Për shkak se isha i zënë duke drejtuar një kishë të madhe, duke bërë programe në TV dhe drejtuar kompaninë time, gjithmonë ndjeja se thjesht nuk kisha kohë për të pasur prodhimin e nevojshëm për të arritur mirënjohjen e nivelit të lartë.

Por në një vit të veçantë, ndërsa u ula në mbledhje dhe pashë 10 bashkëpunëtorët kryesorë të merrnin mirënjohjen dhe çeqet e shpërblimit të tyre prej 100 000 dollarësh, u binda. Mendova: “Prit një minutë! Edhe unë duhet të ngjitem atje në atë skenë për të marrë mirënjohjen. Unë jam një fëmijë i Perëndisë dhe Fryma e Shenjtë është Këshilltari im. Unë duhet të jem atje lart duke e treguar dhe demonstruar mirësinë e Perëndisë!” Kështu që unë dhe Drenda e ndamë mendjen në atë çast dhe atë vend se do të ishim në atë skenë vitin e ardhshëm. Si? Nuk e kishim idenë.

Në 10 vitet e mëparshme, unë kisha fituar rreth 3 deri në 4 milionë dollarë në vit me këtë kompani, por prodhimi i nevojshëm për të arritur

në 10-shen kryesore ishte rreth 11 milionë dollarë. Nuk e kisha idenë se si do ta arrija atë nivel dhe as që isha i sigurt nëse ishte e mundur

me grafikun tim të punëve. Megjithatë, një gjë që kisha mësuar ishte se nuk mund ta bëja me forcën time. Kështu Drenda dhe unë u lutëm dhe përcaktuam qëllimin tonë, duke mbjellë një farë financiare, çliruar besimin tonë dhe duke e shpallur atë të realizuar.

Për ta përmbledhur historinë e gjatë, në janar të vitit të ardhshëm, ndërsa viti i ri sapo kishte filluar, Perëndia më tregoi në ëndërr se si ta arrija qëllimin tim. Ai më

tregoi saktësisht se çfarë duhej të bëja; dhe nëse e bëja atë që më kishte treguar, do ta arrija. A e di se ne e arritëm atë objektiv prej 11 milionë dollarësh atë vit me një shitje! Çfarë emocioni ishte të ngjitesha në atë skenë

në mbledhjen e radhës me 10-shen kryesore të kompanive dhe të merrja atë shpërblim 100 000 dollarë. A e di se sa mirë u ndiem? Ishte thjesht një festë e madhe. Jo vetëm që e kishim arritur qëllimin tonë me shpërblimin, por edhe të ardhurat tona ishin rritur qindra mijëra dollarë atë vit. Kjo është festë për mua!

Pra, kur të filloj të flas për ndonjë ngjarje të Dhiatës së Vjetër si ajo e vitit jubilar, mos tund kokën dhe mos mendo se kjo është diçka e mërzitshme sepse nuk është. Mos harro, jeta është më e mirë me një festë, kështu që le t'i hedhim një vështrim ngjarjes/festës më të madhe që festoi Izraeli dhe të mësosh se si të kesh tënden.

Viti i Jubileut

Gjithashtu do të llogaritësh për vete shtatë të shtuna vitesh: shtatë herë shtatë vjet; këto shtatë javë vitesh do të bëjnë për ty një periudhë prej dyzet e nëntë vjetësh. Ditën e dhjetë të muajit të shtatë do t'i biesh burisë; ditën e shlyerjes do të bëni që të bjerë buria në të gjithë vendin. Dhe do të shenjtëroni vitin e pesëdhjetë dhe do shpallni në vend lirinë për të gjithë banorët e tij. Do të jetë për ju

një jubile; secili prej jush do të kthehet në pronën e vet dhe secili prej jush do të kthehet në familjen e vet. Viti i pesëdhjetë do të jetë për ju një jubile; nuk do të mbillni dhe nuk do të korrni atë që rritet vetiu dhe nuk do të vilni vreshtat e pakrasitur. Sepse është jubileu; ai do të jetë i shenjtë për ju; do të hani prodhimet që ju japin arat. Në këtë vit të jubileut secili do të kthehet në pronën e vet.

- Levitiku 25:8-13

Ndërsa filloj të diskutoj për Vitin e Jubileut, më lejo të shtroj themelin që duhet ta kesh vënë re tashmë. Viti i Jubileut ndodhte çdo 50 vjet dhe kjo ndodhte menjëherë pas një viti shabatik,

viti i dyzet e nëntë. Unë mendoj se ti tashmë e sheh se po krijohet një problem i madh, apo jo? Gjatë vitit shabatik, izraelitëve nuk u lejohej të mbillnin. Për Vitin e Jubileut pas atij vlente e njëjta kërkesë për të mos mbjellë. Pra, në thelb, Izraeli nuk do të korrite për dy vjet me radhë dhe më pas duhej të prisnin gjatë vitit të tretë që të mbjellat të piqeshin dhe të korreshin para se ata të mund të furnizoheshin me ushqim. Ky mund të ishte një problem serioz për këdo që kënaqej duke ngrënë një vakt të mirë ose që siguronte jetesën nga shitja e drithit. Kur Moisiu i përcolli udhëzimet në lidhje me Viti e Jubileut, mund ta imagjinosh pështjellimin që duhet të ketë shkaktuar. Sigurisht, mendimi për të pasur tre vjet pushim ishte një ide e bukur, por dikush duhej të paguante për të. Pyetja e parë që i bënë Moisiut kur dëgjuan për të ishte: “Si është e mundur?”

Por në rast se thoni: «Çfarë do të hamë vitin e shtatë, po nuk mbollëm dhe nuk korrëm prodhimet tona?». Unë kam urdhëruar që bekimi im të vijë mbi ju vitin e gjashtë, dhe ai do t'ju japë një korrje që do të mjaftojë për tre vjet. Kështu vitin e tetë do të mbillni dhe do të hani nga korrja e vjetër deri në vitin e nëntë; do të hani nga korrja e vjetër deri sa të vijë e reja.

- Levitiku 25:20-22

Perëndia iu përgjigj atyre me një përgjigje të mrekullueshme që do të shpenzojmë shumë kohë duke e eksploruar në pjesën e mbetur

të këtij libri. Ai tha se do të dërgonte një bekim aq të madh në vitin e gjashtë, saqë do të siguronte mjaftueshëm sa për tre vjet deri në korrjen e re që do të vinte pas Vitit të Jubileut. Këtu ka një paralelizëm në lidhje me ditët e krijimit. Bibla thotë se Perëndia e kreu punën në ditën e gjashtë të krijimit dhe pushoi. Edhe pse pushoi, Ai nuk ishte i lodhur. Përkundrazi, Ai e kishte kryer punën. Gjithçka që i duhej njeriut ishte krijuar dhe në dispozicion të tij.

Perëndia po i tregonte tani Izraelit një tablo përtej të mjaftueshmes, e cila bën kontrast të fortë me sistemin e mallkimit të tokës me mund e djersë. Ai donte që ata ta shihnin Atë si siguruesin e tyre dhe të kuptonin se Ai siguron me bollëk. Përsëri, ndonëse kjo ishte për ta një tablo e providencës së Perëndisë në kohën e tyre, vetëm kur erdhi Jezusi, ne pamë se çfarë po na tregonte hija. Në të natyrshmen, nuk kishte asnjë mënyrë për të mbijetuar në ato tre vjet pa mbjellje. Po kështu, në të natyrshmen, duke jetuar nën sistemin e mallkimit të tokës, nuk do të kishte asnjë mënyrë për të pasur fitim financiar pa i kaluar ditët dhe netët duke u munduar e djersitur. Nuk mund të nxitoje për ta përfunduar. Provo të bësh tre vjet pushim nga puna aktuale ndërkohë që ke detyrime të papaguara dhe me siguri do të përgatisësh një recetë për falimentim. Por Perëndia po përpiket t'u tregojë atyre një tablo të një mënyre të re, ku Ai siguron për popullin e Tij, ashtu si Adamit iu sigurua gjithçka që Perëndia kishte përgatitur për të gjatë krijimit.

Viti Jubilar na tregon edhe dy gjëra të tjera që duhet t'i shohim. Sërish shohim tokën që pushon, asnjë mundim dhe djersitje gjatë këtij viti të pesëdhjetë. Do të vësh re gjithashtu se e gjithë toka do t'i kthehej pronarit të saj fillestar. Kur Izraeli kaloi lumin Jordan, çdo fisi dhe çdo familjeje iu dha toka me anë të së cilës do zotëronin dhe prodhonin ushqimin dhe të ardhurat që u nevojiteshin për të mbijetuar. Në thelb, toka ishte pasuria e tyre. Mbi të ata rritën të mbjella dhe bagëti. Kështu, kthimi i të gjithë tokave te pronari fillestar i tyre, ua kthente aftësinë për të pasur mirëqenie.

Përsëri, kjo është një hije e asaj që Jezusi bëri për ne. Hija thotë se mirëqenia duhej t'u kthehej qytetarëve të kombit të Izraelit. Realiteti na thotë të njëjtën gjë, se mirëqenia na është kthyer edhe neve, se trashëgimia e Mbretërisë së Perëndisë është përsëri e jona.

Viti i Jubileut na tregon edhe një gjë të tretë dhe kjo është që të gjithë skllëverit duhet të liroheshin dhe të ktheheshin në familjet e tyre. Kjo është gjë e madhe. Sërish, hija thotë se nuk je më skllav, por bir a bijë. Realiteti në Krishtin thotë që nuk je më skllav, por bir ose bijë në shtëpinë e Perëndisë me të drejta të plota për trashëgiminë dhe mirëqenien e shtëpisë.

Pra, mendo për atë që sapo mësove. Jezusi na ktheu atë që humbi Adami. Jezusi na çliroi nga skllavëria, duke na bërë bij dhe bijat e

PASI MËSON ATË QË SHABATI NA TREGON NË TË VËRTETË, NË FINANCAT E TUA DO TË NDODHIN NDRYSHIME TË MËDHA.

Perëndisë. Ai na çliroi nga sistemi i mallkimit tokësor i mundit e djersës, duke e lejuar Perëndinë ta bekojë punën e duarve tona në një mënyrë madhështore. Edhe pse Jezusi pagoi për të gjitha këto gjëra, ne duhet të dimë gjithsesi se si t'i përvetësojnë këto përfitime në jetën tonë të tanishme këtu në mbretërinë e tokës.

Kjo është ajo që u shpëton shumë e shumë të krishterëve. Duke mos e ditur se Mbretëria funksionon me ligje, duke mos i ditur të drejtat e tyre të ligjshme si bij dhe bija e qytetarë, ata besojnë se Zoti zgjedh në mënyrë arbitrare kë dëshiron të bekojë. Prandaj, ata i nuk studiojnë ligjet e Mbretërisë, të cilat mbajnë çelësat për të shijuar dhe zbatuar në të vërtetë atë që thotë Bibla se është e tyre. Dua të them, sapo të mësosh se çfarë po na tregon në të vërtetë shabati, ndryshime të mëdha mund të ndodhin në jetën tënde financiare.

Një zotëri në kishën time filloi të më dëgjonte teksa jepja mësim për besimin dhe si funksionon Mbretëria e Perëndisë. Familja e tij dhe fëmijët e tij i studiuuan këto ligje së bashku si familje. Me afrimin e vitit të ri, ata vendosën që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre legjitime dhe të besojnë se do të paguajnë për dy prona që i kishin marrë me qira atë vit. Nëse e mbaj mend mirë, mendoj se totali i nevojshëm për shlyerjen e të dy shtëpive ishte rreth 400 000 dollarë. Kështu ata u lutën dhe mbollën një sasi fare të konsiderueshme financiare për arritjen e këtij qëllimi për pagesën për të dyja shtëpitë brenda atij viti. Ky ishte një sforcim i madh për ta, por ky zotëri punonte në një fushë ku ekzistonte

mundësia për të gjetur mjaftueshëm klientë dhe/ose kontrata klientësh të mëdhenj që të mund të financohej një mundësi të tillë. E gjithë familja u lut së bashku dhe ranë dakord që kjo të ndodhte. Çdo javë, familja e rishikonte synimin e saj dhe i rishikonte shkrimet e shenjta që u jepnin atyre bazën ligjore për të pritur një korrje të tillë. Sigurisht, ky zotëri e dinte se duhej të bënte pjesën e tij.

Me kalimin e vitit, sigurisht disa kontrata të mëdha u bënë të mundura, por me të gjitha korporatat e mëdha, marrëveshjet shumë milionë dollarëshe nuk realizohen shpejt. Afër gjysmës së vitit, ky zotëri gjeti dhe kapi një shitje të madhe për kompaninë e tij, aq e madhe saqë përbënte rreth 40% të të gjithë prodhimit të kompanisë së tij për atë vit. Me atë çek përqindjesh, ai mundi të paguante për një nga pronat me qira. Afër fundit të vitit, një korporatë tjetër tregoi se do të nënshkruante vërtet kontrata për kontratën shumë milionëshe që edhe miku im po ua ofronte. Por data e arritjes së marrëveshjes vazhdoi të shtyhej. Dokumentet përgatiteshin, më pas zhvendosej data dhe dokumentet duhet të ribëheshin dhe më pas data zhvendosej përsëri. Ishte afër fundit të vjeshtës kur mikut tim iu tha se ekipi menaxhues me të cilin kishte punuar ishte ndryshuar dhe një ekip i ri do ta zëvendësonte.

Shoku im u habit; ai e dinte se çfarë do të thoshte kjo. Ekipi menaxhues i ardhshëm nuk ishte në dijeni të kontratës në pritje, e cila natyrisht, tani ishte e pavlefshme. Atij do t'i duhej ta niste procesin nga fillimi me ekipin e ri. Ndërsa u takua me ekipin e ri menaxhues, u duk se i mirëprisnin sugjerimet e kompanisë së tij. Pasi e rishikuan në fund të nëntorit, ata thanë se donin të vazhdonin me të. Por përsëri, dokumentet u vonuan dhe u rishkruan derisa dy ditë i ndanin nga viti i ri. Mikun tim e telefonuan për t'u takuar dhe nënshkruar dokumentet, si dhe për ta paguar me para në dorë nëse ai mund t'i takonte dhe të nënshkruante atë ditë. Miku im fitoi përqindje të mjaftueshme nga ajo marrëveshje sa për të arritur synimin e tij për të paguar për të dyja shtëpitë në vitin për të cilin ai dhe familja e tij e kishin vendosur besimin.

Ishte studimi i parimeve të Mbretërisë që madje e lejoi ose e nxiti atë të imagjinonte një qëllim kaq të lartë, pasi ai nuk kishte pasur kurrë

më parë një klient kaq të madh dhe as nuk kishte fituar aq shumë para në vitin e mëparshëm sa të mendonte se qëllimi i tij ishte i mundshëm. Ai më tha se bënë një festë të madhe për ta festuar atë fitore!

Një histori tjetër “habie” ka ndodhur me njërin prej fëmijëve të mi. Sigurisht, të gjithë fëmijët e mi e kanë parë Mbretërinë të funksionojë gjithë jetën e tyre. Të gjithë ata i kanë zbatuar parimet që po i diskutoj dhe e kanë parë Perëndinë të bëjë gjëra të mahnitshme. Megjithëse janë në të njëzetat, të gjithë i kanë makinat të paguara; dhe shumica e tyre i kanë të paguara shtëpitë e tyre ose pothuajse të paguara. Djali im më i madh, Timi, donte të blinte një shtëpi me para në dorë. Kështu ai mbolli farën e tij, duke i besuar Perëndisë për një marrëveshje të mirë për një shtëpi brenda fashës së tij të çmimeve. Gjithashtu, atij i jepet shumë për të ndërtuar, kështu që nuk kishte frikë të blinte një shtëpi që duhej riparuar.

Ai kishte shpenzuar kohë duke kërkuar shtëpi, por nuk e kishte gjetur të përsosurën. Por një ditë, ai po shëtiste me makinë dhe pikasi një shtëpi që ishte për shitje, që nuk e kishte parë më parë. Ishte e sekuestruar dhe duke e parë, e kuptoi se shtëpia kishte nevojë për punë, por ajo dukej e përsosur. Ai telefonoi agjentin e pasurive të paluajtshme dhe e kontrolloi çmimin e shtëpisë. Nuk mund t’u besonte veshëve – 37 000 dollarë. “Si është e mundur?” mendoi ai.

Agjentja hulumtoi rreth shtëpisë dhe i tregoi një histori të mahnitshme. Shtëpia ishte me të vërtetë e sekuestruar dhe rreth gjashtë muaj më parë kishte dalë për shitje me çmimin 110 000 dollarë. Ky ishte çmimi i sekuestrimit, por në fakt shtëpia ishte shitur për 160 000 dollarë disa vite më parë. Me sa duket, askush nuk kishte treguar interes për shtëpinë gjatë gjashtë muajve të fundit që kur ishte nxjerrë për shitje. Atëherë banka vazhdoi ta ulte çmimin, pa e ditur pse askush nuk kishte treguar interes. Por pasi Timi dhe agjentja i tij e pasurive të paluajtshme gërmuan pak më thellë, ata zbuluan pse nuk kishte interes për atë shtëpi. Ajo ishte nxjerrë për shitje në një qytet tjetër me një adresë të ndryshme; madje edhe numri i telefonit për të pyetur për të ishte gjithashtu i gabuar. Pra askush nuk e dinte se shtëpia ishte atje! Shtëpia, duke qenë në një rrugë dytësore brenda fshatit, në një rrugë pa krye, nuk rrihej nga makinat. Çmimi sa vinte e ulej deri në ditën

që Timi e vuri re atë. E mahnitshme. I thashë Timit se shtëpia ishte fshehur vetëm për të! Ai e rileu atë dhe bëri disa gjëra në shtëpi dhe e shiti për 160 000 dollarë.

Vajza ime, Ami, drejton adhurimin në kishën Faith Life Church. Ajo dhe Xhejsoni kishin nevojë për një shtëpi më të madhe pasi familja e tyre po rritej nga katër veta në pesë. Çmimet ishin të paarritshme në verën e vitit 2017 këtu në Ohajo dhe shtëpitë që nxirreshin për shitje zakonisht shiteshin brenda një jave. Shpresa e tyre për të gjetur një shtëpi që ishte mjaftueshëm e madhe në fashën e çmimeve nga 250 000 dollarë deri më pak se 300 000 dollarë, me 2 deri në 4 hektarë tokë dhe një listë dëshirash që në pronën e tyre të kishe ujë, nuk mund të gjendej. Fermat e zonës me 1 hektar tokë kushtonin më shumë se 200 000 dollarë atë verë. Pasi kërkuan rreth e rrotull shumë shtëpi, ata ndaluan së pari dhe u lutën. Duke mbjellë një farë për drejtim, ata i thanë Zotit: “Ne jemi shumë të zënë për të vazhduar që të kërkojmë kështu. Ti e di se ku është shtëpia jonë dhe të kërkojmë që të na e tregosh në momentin e duhur. Nuk do të kërkojmë më në internet, as nuk do të flasim me agjenten tonë të pasurive të paluajtshme për këtë shtëpi!

Por një natë ndodhi një gjë interesante. Vajza e tyre, që ishte katër vjeç në atë kohë, tha ndërsa u futën në shtëpi: “Mami, është koha të transferohemi.” “Çfarë do të thuash?”, pyeti

Ami. “Është koha që të transferohemi te shtëpia me shkallët e mëdha që ngjiten deri në dhomën time”, tha vajza e saj katër vjeçare. “Çfarë shtëpie? Mos ke parë gjë ëndërr?”, pyeti Ami. Vajza i tha se po, kishte parë. Epo, atë mbrëmje, pasi i vunë të dy fëmijët në shtrat, Ami nuk mund ta harronte bisedën dhe i tha Xhejsonit se mbase duhet të shikonin në internet.

Dhe në fakt, një shtëpi e sekuestruar sapo ishte nxjerrë për shitje, një shtëpi me dy kate me 10 hektarë tokë dhe buzë një liqeni. Megjithatë, çmimi ishte 26 000 dollarë mbi çmimin tavan prej 300 000 dollarësh për të cilën kishin mbjellë. Ata arsyetuan se mund të ofronin gjithsesi një çmim më të ulët, ndaj i telefonuan agjentës së pasurive të paluajtshme. Agjentja e tyre do të nisej për në Florida të nesërmen, por mund t'ua tregonte shtëpinë nëse mund të shkonin herët në mëngjes rreth orës 9:00. Xhejsoni dhe Ami thanë se do ta takonin atje.

Agjentja erdhi me vonesë te shtëpia, por shtëpia dukej e përsosur. Bashkë me sipërfaqen e saj, 10 hektarët e tokës dhe liqenin përpara, gjithçka dukej e përsosur. Më e mira ishte se e gjithë prona ishte e rrethuar nga pyje; të linte pa frymë. Teksa hynë në shtëpi, vajza e tyre i ngjiti shkallët e mëdha spirale drejt e në dhomën e saj duke kënduar me gëzim. Për t'i rënë shkurt kësaj historie të gjatë, Xhejsoni dhe Ami thanë se do të donin të bënin një ofertë. Ndërsa agjentja kontrolloi të dhënat e shtëpisë, ajo zbuloi se të gjitha ofertat duhej të dorëzoheshin para mesditës atë mëngjes. Kishin më pak se një orë! Nëse vajza e tyre katër vjeçare nuk do t'ua kishte treguar ëndrrën dhe nëse ata nuk do të kishin kontrolluar në internet atë natë, nuk do ta kishin gjetur.

Ata ofruan çmimin e kërkuar prej 326 000 dollarësh dhe fituan. Ishin shumë të emocionuar. Gjatë inspektimit, edhe pse çatia ishte në gjendje të mirë, inspektori tha se do të duhej të zëvendësohej pas rreth 5 vjetësh. Xhejsonit i lindi një ide. Ai vendosi t'i kërkonte bankës një çmim më të ulët për shkak të punimeve që do të nevojiteshin më vonë për çatinë. Agjentja e tyre u tha as të mos përpiqeshin, se shtëpia ofrohej “siç ishte” dhe se ajo nuk kishte parë asnjëherë një bankë ta ulte çmimin e një shtëpie të sekuestruar për shkak të dëmtimeve të saj. Por Xhejsoni dhe Ami e ndjenë në shpirt që të shkruanin një letër dhe të kërkonin një ulje nga banka. E gjete, banka ua dha shtëpinë për 296 000 dollarë, më pak se 300 000 dollarë që po i shpenzonin duke besuar te Perëndia. Perëndia ua solli shtëpinë ashtu siç ia kishin kërkuar ta bënte. Kur e pyetën vlerësuesin se sa mendonte se vlente shtëpia, ai tha “500 000 dollarë”. Miku im, kjo do të thotë dy racione!

Siç mund ta shohësh, të gjithë fëmijët e mi po shijojnë mënyrën e Mbretërisë për të jetuar. Në fakt, vajza ime më e vogël, Kirsteni, sapo pagoi me para në dorë për shtëpinë e saj të parë këtë vit në moshën 20 vjeç. Si? Ata të gjithë dinë si të veprojnë sipas mënyrës së Mbretërisë!

KAPITULLI 8

RACIONI I DYFISHTË

Tani dua të hetoj më imtësisht se si funksionon në të vërtetë pushimi i shabatit dhe se si është e mundur ta shfrytëzosh atë për jetën tënde. Dua të kthehem te historia jonë e Vitit jubilar dhe të shikojmë vargjet tona. Aty gjejmë përgjigjen e Perëndisë për njerëzit kur e pyetën se si do të jetonin pa korrje për tre vjet. Pyetje me vend!

Por në rast se thoni: “Çfarë do të hamë vitin e shtatë, po nuk mbollëm dhe nuk korrëm prodhimet tona?”. Unë kam urdhëruar që bekimi im të vijë mbi ju vitin e gjashtë, dhe ai do t’ju japë një korrje që do të mjaftojë për tre vjet. Kështu vitin e tetë do të mbillni dhe do të hani nga korrja e vjetër deri në vitin e nëntë; do të hani nga korrja e vjetër deri sa të vijë e reja.

- Levitiku 25:20-22

Në këtë tekst shohim se Viti jubilar, si edhe viti shabatik përpara tij, ishin të dy të mundshëm për shkak të korrjes së madhe në vitin e gjashtë, në këtë rast në vitin e dyzet e tetë (nga jubileu i fundit). Pa atë korrje të madhe, pushimi i shabatit nuk do të ishte i mundur. Le t’i hedhim një vështrim një fragmenti tjetër që besoj se do ta sqarojë edhe më tej këtë.

Kështu e mblihdnin çdo mëngjes; secili sipas nevojës së tij për ushqim; por kur dielli bëhej i nxehtë, mana e mbledhur shkrihej. Kështu ditën e gjashtë mbloodhën një racion të dyfishtë buke, dy omerë për secilin prej tyre. Dhe të gjithë krerët e asamblesë erdhën për t'ia referuar Moisiut. Atëherë ai u tha: “Kjo është ajo që ka thënë Zoti: Nesër është një ditë solemne pushimi, një e shtunë e shenjtë për Zotin; piqni sot atë që duhet të piqni dhe zieni atë që duhet të zieni; dhe çdo gjë që ju tepron, vëreni mënjanë dhe ruajeni deri nesër”.

Ata pra e ruajtën deri të nesërmen, ashtu si kishte urdhëruar Moisiu; dhe ushqimet e ruajtura nuk lëshuan erë të keqe dhe nuk prodhuan krimba. Moisiu tha: “Hajeni sot, se sot është e shtuna e shenjtë e Zotit; sot nuk do ta gjeni nëpër fushat. Mblihdni gjatë gjashtë ditëve; sepse ditën e shtatë nuk do ta gjeni më”.

Dhe ditën e shtatë ndodhi që disa njerëz nga populli dolën për ta mbledhur, por nuk e gjetën. Atëherë Zoti i tha Moisiut: “Deri kur do të kundërshtoni të zbatoni urdhërimet e mia dhe ligjet e mia? Mos harroni që Zoti ju ka dhënë të shtunën; për këtë arsye ditën e gjashtë ju jep bukë për dy ditë. Secili të qëndrojë në vendin e tij; asnjëri të mos dalë nga çadra e tij ditën e shtatë”. Kështu populli pushoi ditën e shtatë.

- Eksodi 16:21-30 (mana)

Natyrisht, ky fragment, flet për manën që binte nga qielli çdo ditë për të ushqyer popullin dhe përshkruan se nuk do të shfaqej në ditën e shtatë, shabat. Nuk duhet ta ruanin sot për nesër, pasi do të prishej shumë shpejt. Vetëm ditën e gjashtë mund ta mblihdnin dhe ta mbanin gjatë natës pa u prishur. Një informacion interesant në lidhje me arsyen pse mana do të prishej shumë shpejt çdo ditë gjendet te **Ligji i Përtërirë 8:16**.

Dhe që në shkretëtirë të ka ushqyer me manë të cilën etërit e tu nuk e njihnin, për të të përlulur dhe për të të vënë në provë dhe së fundi për të të bërë të mirë.

Perëndia po stërviste kombin që të drejtohej tek Ai çdo ditë për ushqimin, sigurisht, por edhe për gjithçka në jetën e tyre. Perëndia

e dinte se kërkesat e tyre do ta tejkalonin nevojën për ushqim; së shpejti do të përballëshin me qytete të rrethuar me mure dhe gjigantë. Mbështetja e tyre e palëkundur tek Ai në atë lloj situatë do të ishte ndryshimi midis jetës dhe vdekjes.

Le të kthehemi tek **Eksodi 16:29**. Këtu, mund të shohësh qartë se pushimi i shabatit bëhej i mundur vetëm nga racioni i dyfishtë që iu jepej në ditën e gjashtë.

Mos harroni që Zoti ju ka dhënë të shtunën; për këtë arsye ditën e gjashtë ju jep bukë për dy ditë. Secili të qëndrojë në vendin e tij; asnjëri të mos dalë nga çadra e tij ditën e shtatë.

A e shikon? Pushimi i shabatit u bë i mundur vetëm nga racioni i dyfishtë. Kjo është aq e rëndësishme sa do të të kërkoj ta mbash shënim.

PUSHIMI I SHABATIT ËSHTË I PAMUNDUR PA RACIONIN E DYFISHTË!

Më lejo ta vendos në një kontekst tjetër. Nëse nuk ke më shumë se mjaftueshëm, nuk do të bësh kurrë pushim nga vrapimi dhe djersitja e sistemit të mallkimit të tokës. Këtë u themi Drenda dhe unë njerëzve kudo që shkojmë: “Nëse nuk e rregulloni çështjen e parave, nuk do ta zbuloni kurrë fatin tuaj!” Pse? Sepse pa pasur më shumë se mjaftueshëm, nuk do të kesh mundësi dhe do të jesh skllav i mbijetesës gjithë jetën tënde. Kujtohu kur i lexuam përfitimet e Bekimit të Abrahamit nga Ligji i Përtërirë 28:11-13 në një kapitull të mëparshëm. Aty pamë qartë se fati yt nuk është të jetosh një jetë mbijetese! Por në rast se e ke harruar, le ta rishikojmë edhe një herë.

Zoti, Perëndia yt, do të të mbushë me të mira, me frytin e barkut tënd, me frytin e bagëtisë sate dhe me frytin e tokës sate në vendin që Zoti u betua t'u japë etërve të tu.

Zoti do të hapë për ty qiellin, thesarin e tij të mirë, për ti dhënë tokës sate shiun në kohën e duhur dhe për të bekuar veprën e duarve të tua; ti do t'u japësh hua shumë kombeve, por nuk do të marrësh

asgjë hua. Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti, dhe do të jesh gjithnjë lart dhe kurrë poshtë, në rast se u bindesh urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tënd, që sot të urdhëron t'i respektosh dhe t'i zbatosh në praktikë.

- Ligji i Përtërirë 28:11-13

Varfëria, mbijetesa dhe falimentimi nuk janë fati yt. Ti duhet të jesh huadhënësi dhe jo huamarrësi, koka dhe jo bishti! Ky bollëk është pamja e Mbretërisë. Ky është pushimi i shabatit, më shumë se mjaftueshëm, racioni i dyfishtë!

E di se çfarë po mendon: “Ah, sa mirë do të ishte, Geri, por jeta ime nuk duket aspak e tillë tani.” Nuk ka gjë, ne nuk po shikojmë pas, por po shikojmë atë që thotë Perëndia dhe po presim atë që thotë Mbretëria për ne. Pa tablonë e duhur, pa e duke ditur se si duhet të jetë jeta jonë, ne do të biem pas hileve dhe kurtheve dhe mendimit të çoroditur të sistemit të mallkimit të tokës. Besim do të thotë të jesh në përputhje me atë që thotë Perëndia, jo me rrethanat tona.

Përpara se të ndaj me ty se si Perëndia na e mësoi mua dhe Drendën racionin e dyfishtë, dua të të tregoj një histori që besoj se është historia më e madhe e racionit të dyfishtë në Dhiatën e Re.

BESIM DO TË THOTË TË JESH NË PËRPUTHJE ME ATË QË THOTË PERËNDIA, JO ME RRETHANAT TONA.

Historia që dua të të tregoj është ajo që e ke dëgjuar shumë herë më parë, por ndoshta jo në kontekstin e racionit të dyfishtë ose me kuptueshmërinë e Mbretërisë që ke tani. Këtë histori e gjejmë te Lluca 15: historia e djalit

plangprishës. Më ndiq edhe një herë. E di që e ke lexuar më parë, por le ta kalojmë së bashku me një vështrim të ri.

Tha akoma: “Një njeri kishte dy bij. Më i riu i tyre i tha babait: «Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon”. Dhe i ati ua ndau mes tyre pasurinë. Mbas pak ditësh biri më i ri mblodhi çdo gjë, shkoi në një vend të largët dhe atje e prishi gjithë pasurinë, duke bërë një jetë

të shtthurur. Por, si i shpenzoi të gjitha, në atë vend ra një zi e madhe buke, dhe ai filloi të jetë në hall. Atëherë shkoi e iu ngjit pas një banori të atij vendi, i cili e çoi në arat e tij që të ruajë derrat. Dhe ai dëshironte të mbushte barkun me lendet që hanin derrat, por askush nuk ia jepte.

Atëherë erdhi në vete dhe tha: «Sa punëtorëve mëditës të atit tim u tepron buka, kurse unë po vdes nga uria! Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë dhe do t'i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir; trajtomë si një nga mëditësit e tu». U çua, pra, dhe shkoi tek i ati.

Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe dhembshuri; u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi. Dhe i biri i tha: «O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt».

Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: «Sillni këtu rrobën më të bukur dhe visheni, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Nxirrni jashtë viçin e majmur dhe thereni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri». Dhe filluan të bënin një festë të madhe.

Djali i tij i madh ishte në ara; dhe kur u kthye dhe iu afrua shtëpisë, dëgjoi këngë e valle.

Atëherë thirri një shërbëtor dhe e pyeti ç'ishte e gjitha kjo. Dhe ai i tha: «U kthye yt vëlla dhe yt atë theri viçin e majmur, sepse iu kthye djali shëndoshë e mirë».

Kur i dëgjoj këto, ai u zemërua dhe nuk desh të hynte; atëherë i ati doli dhe iu lut të hynte.

Por ai iu përgjigj të atit dhe tha: «Ja, u bënë kaq vite që unë të shërbej dhe kurrë s'kam shkelur asnjë nga urdhrat e tu, e megjithatë kurrë s'më dhe një kec për të bërë një festë me miqtë e mi. Por, kur u kthye ky djali yt, që prishi pasurinë tënde me prostituta, ti there për të viçin e majmur».

Atëherë i ati i tha: «O bir, ti je gjithmonë me mua, dhe çdo gjë që kam është jotja.

Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse ky vëllai yt kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri».

- Lluca 15:11-32

Në këtë histori, shohim se djali më i vogël largohet nga shtëpia me pjesën e tij të pasurisë. Kjo është një hollësi e rëndësishme e historisë pasi i referohet pjesës së tij të trashëgimisë. Pra, kije parasysh se ky djalë më i vogël e ka marrë tashmë pjesën e tij të trashëgimisë; ai nuk mund të pretendojë më shumë pasuri.

Më i riu i tyre i tha babait: «Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon». Dhe i ati ua ndau mes tyre pasurinë.

Më pas, historia na tregon se ku shkoi ky djalë i vogël: në një vend të largët. Është e rëndësishme të kuptosh se djali më i ri u largua nga shtëpia e babait të tij, që nënkupton se ai la pas providencën e tij, mbrojtjen e tij dhe ligjet e kombit ku ndodhej shtëpia e babait të tij. Ai shkoi në një komb të largët, me ligje të tjera dhe një mënyrë të ndryshme jetese. Jam i sigurt se ky djalë i vogël në të vërtetë nuk e kishte idenë se çfarë po bënte. Ai gëzoi përfitimin e të qenit djalë ndërsa jetonte në shtëpinë e babait të tij. Gjithçka që kishte babai i tij ishte në dispozicion të tij gjatë kohës që jetonte atje. Por për njëfarë arsye, ai ndjeu se i mungonte diçka, se po i humbte një mundësi që gjendej diku tjetër.

Nëse nuk e ke kuptuar tashmë, në realitet, Jezusi po na tregon historinë e njerëzimit, historinë e Adamit. Adami është djali më i vogël në histori që e la shtëpinë e Atit të tij. Adami ishte ai që ndjeu se kishte një të ardhme më të mirë diku tjetër sesa të vazhdonte t'i shërbente Perëndisë, Atit të tij. E di se çfarë po mendon: “Epo, nëse Adami është djali më i vogël, kush është djali më i madh në histori, i cili qëndroi?” Unë do ta trajtoj këtë pyetje në këtë fund të këtij diskutimi, por tani për tani, ki parasysh vetëm se Adami është djali më i vogël që u largua.

Megjithëse kishin gjithçka, Adami dhe Eva u mashtruan dhe besuan se kishte më shumë diku tjetër sesa të qëndronin në shtëpinë e Atit të tyre. Kur Adami u rebelua kundër shtëpisë së babait të tij dhe zgjodhi të largohej, ai iu nënshtrua një qeverie të re, një mbretërie të re me ligje të reja funksionimi. Bibla e quan atë mbretëria e errësirës, e cila sundohet nga Satani. Jam i sigurt se Adami u trondit nga varfëria dhe dëshpërimi i kësaj mbretërie të re. Në fillim, gjithçka dukej e

mrekullueshme. Për sa kohë që pati para, ishte thjesht një festë shumë e madhe! Por kur e kuptoi se kishte bërë një gabim, ishte tepër vonë. Pastaj, pasi e çoi dëm trashëgiminë e tij, ai u ndje i humbur. Mendja e tij, e cila dikur ishte plot me vizione, më pas u përqendrua në detyrën e përditshme për të qëndruar gjallë. Nuk do të kishte më të nesërme. Do të kishte gjithmonë vetëm të sotme dhe e sotmja nuk ka premtime.

Mbas pak ditësh biri më i ri mblodhi çdo gjë, shkoi në një vend të largët dhe atje e prishi gjithë pasurinë, duke bërë një jetë të shtthurur.

Tanimë djali i vogël e gjen veten në një mbretëri që është plotësisht dhe absolutisht e falimentuar, një mbretëri që ekziston në një gjendje të përhershme urie të thellë. Djali përpiqet të kuptojë atë që po sheh - njerëzit po vdesin nga uria. Për shkak se vjen nga një shtëpi me shumë bollëk, mendja e tij e ka të vështirë ta kuptojë atë që sheh. Por dhimbjet e urisë në stomak i kujtojnë se ajo që sheh është e vërtetë. Për të mbijetuar, ai tani detyrohet të lypë në rrugë. Në këtë mbretëri të errësirës, toka prodhon vetëm gjemba dhe gjembaçë dhe që të mund të prodhojë, duhet mund dhe djersë. Duke qenë në nevojë të madhe, djali lutet që dikush ta ndihmojë. Por të gjithë janë në të njëjtën situatë. Askush nuk do t'i japë atij ndonjë gjë sepse të gjithë po përjetojnë të njëjtën zi buke të rëndë si ai.

Atëherë ndodh një moment vendimtar për djalin e ri, një ndryshim që ka ndikuar tek ti dhe unë dhe i gjithë njerëzimi. Për herë të parë në gjithë ekzistencën e tij, djali i vogël përgjërohet që të paguhet si shërbëtor, rrogëtar, duke bërë punë krahu. Ky është një shtrembërim i plotë i identitetit të tij të vërtetë. Ai nuk është më djali i një njeriu shumë prestigjioz, të nderuar dhe të pasur, ai është portier, ose kasap, ose agjent imobiliar, ose postier, dhe lista mund të vazhdojë pafund. Ai tani njihet për atë që bën dhe jo për atë që është! Ai e ka humbur identitetin e tij! Për ta theksuar edhe më tej humbjen e identitetit të tij, Jezusi thotë se ai u dëshpërua aq shumë, sa filloi një punë për të ushqyer derrat. Derrat konsideroheshin të papastër për hebrenjtë dhe Jezusi i thotë turmës se ky djalë i ri tani është aq shumë i dëshpëruar, saqë e ka harruar çdo qëllim që mund të kishte pasur jeta e tij. Ai tani

jeton një jetë me turp dhe çnderim. Statusi mbretëror që gëzonte dikur tani është një kujtim i largët.

Por, si i shpenzoi të gjitha, në atë vend ra një zi e madhe buke, dhe ai filloi të jetë në hall. Atëherë shkoi e iu ngjit pas një banori të atij vendi, i cili e çoi në arat e tij që të ruajë derrat. Dhe ai dëshironte të mbushte barkun me lëndet që hanin derrat, por askush nuk ia jepte.

Unë shpresoj se po e kupton paralelizmin mes historisë dhe njerëzimit sot. Kur dy burra takohen me njëri-tjetrin, çfarë thonë ata? “Me çfarë merresh?” ose “Ku punon?” ose “Çfarë pune bën?” Kur pyet dikë se kush është, ai zakonisht do të të tregojë se çfarë pune bën. Pse? Sepse në sistemin e mallkimit të tokës, ne të gjithë kemi humbur identitetet tona dhe po përpiqemi dëshpërimisht t'i gjejmë ato. Ne kopjojmë këdo që tërheq vëmendje dhe duket i rëndësishëm. E gjithë kjo është pasojë e vendimit të Adamit për të lënë shtëpinë e Atit të tij. Në mendësinë tonë të mbijetesës, ne e kemi harruar se kush jemi në të vërtetë. Por inkurajohu, ky djalë i ri në historinë tonë nuk qëndroi në stallën e derrave; dhe ndërsa e ndjekim historinë, shpresoj të zbulosh se as ti nuk duhet të qëndrosh atje.

Bibla thotë se një ditë ky djalë i ri vjen në vete dhe kujton shtëpinë e të atit ku edhe shërbëtorët kanë më shumë sesa mund të hanë. Mund ta imagjinoj se në gjendjen e tij të urisë ekstreme, ai i kishte kujtuar të gjitha vaktet e shijshme që kishte shijuar dikur. Xhaxhai im, Haroldi, ishte një pilot në një B-17 gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai vinte nga një komunitet fermerësh dhe nga një familje fermerësh. Çdo të diel, nëna e tij shërbente një vakt të bollshëm me pulë të skuqur, pure patatesh, bukë të bërë vetë, bishtaja dhe shumë perime të tjera të shijshme. Sigurisht, për ëmbëlsirë kishte gjithmonë pite të ëmbël ose kek. Unë e kam provuar se sa të mrekullueshme ishin ato ushqime pasi nëna e tij ishte gjyshja ime.

Avioni i xhaxhait tim u rrëzua në Gjermani gjatë luftës dhe ai kaloi shumë muaj në një kamp burgu gjerman. Ushqimi mungonte thuajse plotësisht. Një ditë, e pyeta xhaxhain tim se si kishte mbijetuar ato ditë dhe ai më tha se mendonte vetëm të kthehej në shtëpi te pula e

skuqur dhe pureja e patateve e nënës së tij. Jam i sigurt se ky djalë më i ri pati një përvojë të ngjashme dhe e kuptoi se çfarë i mungonte. Por ai nuk kishte asnjë pretendim të mëtejshëm mbi pasurinë, pasi kishte marrë tashmë gjithçka që i takonte nga pasuria e babait të tij. Kështu ai mendoi për një plan. Ai do të kthehej në shtëpi dhe do t'i lutej të atit që ta punësonte si shërbëtor. Në mendjen e tij, të punonte si punëtor krahu, si rrogëtar, ishte mundësia e tij e vetme.

Atëherë erdhi në vete dhe tha: «Sa punëtorëve mëditës të atit tim u tepron buka, kurse unë po vdes nga uria! Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë dhe do t'i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir; trajtomë si një nga mëditësit e tu». U çua, pra, dhe shkoi tek i ati.

Kështu ai kthehet në shtëpi me planin e tij dhe për t'iu lutur të atit për një mundësi që të paktën të punojë në këmbim të një vendi për të fjetur dhe ushqimit për të ngrënë. Por Bibla tregon një përfundim të mahnitshëm të kësaj historie. Ndërsa i afrohet shtëpisë së tij, babai i tij e sheh që nga larg dhe vrapon për ta takuar me një përqaqim të madh. Nga kjo pikë e tutje, historia duhet të quhet historia e dashurisë së Atit, sepse e përqafoi edhe pse ai ishte i mbuluar me pleh derrash. Duke vepruar kështu, dëgjuesit judenj të Jezusit e kuptuan se përqaqimi do ta bënte babanë të papastër frymërisht. Por ky baba u bë me dëshirë i papastër për të birin. Më pas ai kërkon rrobën më të bukur që ka dhe ia hedh të birit për të mbuluar papastërtinë e tij. Ai mori unazën e vulës që përfaqësonte autoritetin e tij dhe e vendosi përsëri në gishtin e djalit të tij. Ai i jep sandale për të veshur, që nënkupton se ai ka akses përsëri në të gjithë pasurinë. Por është gjëja e fundit që i jep babai i tij që e bën djalin e madh të zemërohet. Babai kërkon që të theret viçi i majmur dhe të shërbehet me rastin e kthimit të djalit. Djalit më të vogël, edhe pse nuk e meriton, i rijepet pozita dhe përfitimet e të qenit bir, nderohet hapur dhe lirisht si bir dhe i kthehet plotësisht pozita e mëparshme si bir në shtëpi.

Atëherë, çfarë lidhje ka e gjithë kjo me racionin e dyfishtë? Gjithçka. Jezusi përdori një histori të djalit më të vogël që iku dhe u kthye, sepse dëgjuesit e Tij, kultura hebraike, do ta kuptonin se çfarë nënkuptonte

historia dhe atë që unë do të të tregoj tani. Në kulturën hebraike, djali më i madh do të merrte automatikisht një racion të dyfishtë. Nëse të kujtohet, djali i madh nuk u largua, por ishte djali i vogël që u largua dhe u kthye. Duhet të të kujtohet edhe se kur u largua, ai mori me vete pjesën e tij takuese të pasurisë, pjesën e tij takuese. Ai tani nuk kishte asnjë pretendim tjetër mbi pasurinë apo ndonjë gjë tjetër të saj. Por kur djali i vogël u kthye dhe babai e mirëpriti si bir dhe, konkretisht, i dha viçin e majmur për të festuar kthimin e tij, djali i madh u tërbua. Në mendjen e djalit të madh, ai viç i përkiste atij pasi ishte pjesë e pjesës së tij të pasurisë.

Ja se cila është ideja. Edhe pse vëllai më i vogël e kishte marrë tashmë pjesën e tij të pasurisë, ai u mirëpriti si djalë dhe tani po shijonte një racion të dytë. Kjo do të thotë se ai në fakt mori një pjesë të dyfishtë të pasurisë. Nga këndvështrimi i vëllait të madh, kjo nuk ishte e drejtë dhe në zemërim e sipër, ai ia shpreh këtë babait të tij. Ai pretendon se ka qenë besnik duke punuar për të gjatë gjithë këtyre viteve dhe se ky vëlla më i ri nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka turpëruar familjen. Atëherë, pse duhet të merrte një pjesë të dyfishtë?

A ishte e drejtë kjo? Nga këndvështrimi i sistemit të mallkimit tokësor të mundit dhe djersës, të gjithë do të thoshim se nuk ishte. Mbase do të mbanim anën e djalit të madh, i cili kishte punuar me besnikëri dhe mund të pretendonte se i ishte bërë padrejtësi bazuar në atë që kishte bërë për të atin.

Por mbi ç'bazë gjykojmë se çfarë është e drejtë? A nuk është babai ai që gjykon dhe vendos se kujt dëshiron t'ia japë miratimin e Tij? Trajnimi në sistemin e mallkimit të tokës që do të kishim bërë të gjithë do të nënkuptonte që, nëse babai i jepte djalit më të ri një pjesë tjetër të pasurisë, djalit të madh do t'i mbetej më pak. Por nuk është ky rasti. Babai është aq i pasur, saqë edhe shërbëtorët kanë më shumë sesa duhet. Sa më shumë ka për djemtë!

Satani nuk do që ti ta dish se sa i madh është Perëndia ynë ose se kush je në të vërtetë. Ai ka ushqyer gënjeshtër për Atin tonë që në fillim. Politikat e sigurimit pretendojnë se kur ndodhin fatkeqësitë, ato janë një vepër e Perëndisë. Organizatat fetare pretendojnë se Zoti është i kënaqur me një betim varfërie. Njerëzit pretendojnë se Perëndia u bën gjëra të këqija njerëzve të mirë. Satani do të donte që të mos e

shohësh se kush je dhe sa i madh është Ati yt, që të mos vish në vete e të kthehesh tek Ai me gjithë zemrën tënde. Mund të të siguroj se kur të kthehesh tek Ai, do të gjesh të njëjtën pritje që pati ky djalë më i ri në këtë histori.

“Kush është djali më i madh?”, - thua ti. Le të shohim nëse mund ta kuptosh.

Djali i tij i madh ishte në ara; dhe kur u kthye dhe iu afrua shtëpisë, dëgjoi këngë e valle. Atëherë thirri një shërbëtor dhe e pyeti ç'ishte e gjitha kjo. Dhe ai i tha: «U kthye yt vëlla dhe yt atë theri viçin e majmur, sepse iu kthye djali shëndoshë e mirë».

Kur i dëgjoj këto, ai u zemërua dhe nuk desh të hynte; atëherë i ati doli dhe iu lut të hynte. Por ai iu përgjigj të atit dhe tha: «Ja, u bënë kaq vite që unë të shërbej dhe kurrë s'kam shkelur asnjë nga urdhrat e tu, e megjithatë kurrë s'më dhe një kec për të bërë një festë me miqtë e mi. Por, kur u kthye ky djali yt, që prishi pasurinë tënde me prostituta, ti there për të viçin e majmur».

Atëherë i ati i tha: “O bir, ti je gjithmonë me mua, dhe çdo gjë që kam është jotja. Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse ky vëllai yt kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri”.

Djali më i madh thotë se gjatë gjithë këtyre viteve ai ka qenë skllav i të atit, por gjatë gjithë asaj kohe babai i tij nuk i ka dhënë as edhe një kec për të festuar me miqtë e tij. Më lejo ta interpretoj atë që thotë ai. “Baba, je i padrejtë!” Por vër re se çfarë thotë babai në këmbim. “Ti je gjithmonë me mua, dhe GJITHÇKA QË KAM është e jotja.”

Ndalo!!!!

Atëherë, a mund ta kuptosh se kush është djali më i madh? Djali më i madh ka qenë shumë i zënë duke u bërë skllavi i babait të tij me një perceptim të gabuar vetëdrejtësie për të shijuar në të vërtetë mirësinë e

**SATANI NUK DO QË TI TA
DISH SE SA I MADH ËSHTË
PERËNDIA YNË OSE SE KUSH
JE NË TË VËRTETË.**

babait të tij. Gjithçka që babai ka, ka qenë e tij gjatë gjithë kohës.

Ke të drejtë, djali më i madh përfaqëson ligjin e besëlidhjes së parë. Djali i parë nuk i gëzoi kurrë përfitimet e shtëpisë së babait të tij, sepse ishte shumë i zënë duke punuar për të marrë miratimin e babait të tij. Megjithëse djali më i madh kishte të drejtën e racionit të dyfishtë, atë e gëzoi vetëm djali më i vogël.

Ti je djali më i vogël!

Ti e ke racionin e dyfishtë. Ti je djali që pranohet jo në bazë të asaj që bën, por në bazë të identitetit tënd në Krishtin – një bir apo bijë e Perëndisë, që gëzon një trashëgimi për të cilën nuk të është dashur të punosh, por që e merr lirisht nga Ati yt.

KAPITULLI 9

MËSE MJAFTUESHËM!

E kuptoj që mund të jesh dyshues për titullin e këtij kapitulli, por kjo është vendmbërritja jote, të kesh mëse mjaftueshëm. Jo sepse po të tregoj skemën më të fundit, më të fortë të fitimit të parave, por sepse si fëmijë i Perëndisë, është e drejta jote ligjore ta shijosh mirësinë dhe begatinë e shtëpisë së Atit tënd. Koncepti i racionit të dyfishtë, të kesh më shumë se sa duhet, mund të duket i pamundur për t'u përfytyruar tani në krahasim me vendin ku e sheh veten në këtë moment të jetës sate. Por këtu duhet të fillosh udhëtimin tënd drejt lirisë – në mendimet e tua. Nëse mendimet e tua nuk pajtohen me Fjalën e Perëndisë, ti nuk do të gëzosh kurrë përfitimet e Tij.

**KONCEPTI I RACIONIT TË
DYFISHTË, TË KESH MË
SHUMË SE SA DUHET, MUND
TË DUKET I PAMUNDUR PËR
T'U PËRFYTYRUAR TANI
NË KRAHASIM ME VENDIN
KU E SHEH VETEN NË KËTË
MOMENT TË JETËS SATE.**

Prandaj, ngriji sytë nga ajo që sheh përreth teje dhe vendosi në atë që Perëndia thotë se është e jotja në Mbretërinë e Tij. Mjaft debatove me atë që thotë Zoti, për shkak se nuk e sheh atë në jetën tënde. Në vend të

kësaj, fillo të debatosh me rrethanat e tua me Fjalën e Perëndisë, duke besuar se ato duhet të përputhen me gjithçka që Perëndia thotë se janë të tuat. Unë jam një njeri si ti, që thjesht bëri atë që po të them të bësh. Besoje atë që thotë Perëndia! Fjala e Perëndisë nuk mund të dështojë dhe ajo do të sjellë një ndryshim në çdo rrethanë. Për shembull, këtu është një email që kam marrë nga një dëgjuese e cila ishte skeptike nëse i kishte dëgjuar të gjitha, apo jo?

“Do të përpiqem t’i përmbledh 22 vjet vështirësi në sa më pak fjali të mundem. Unë dhe bashkëshorti im u rritëm në familje të krishtera dhe e frekuentonim kishën rregullisht. Ne ishim të përfshirë edhe te grupi i të rinjve, shkolla e së dielës, etj. Kur u martuam, viti ynë i parë financiarisht ishte i mirë ... kjo ka qenë më shumë se 22 vjet më parë. Që atëherë, “çështja e parave” ka qenë një burim i vazhdueshëm dhimbjeje dhe mundimi dhe besimi im ishte lëkundej gjithmonë sepse nuk mund ta kuptoja pse nuk ndodhnin ato që thoshin Shkrimet e Shenjta se duhej të ndodhnin. Nëse Fjala e Perëndisë ishte e përjetshme dhe e pashkatërrueshme dhe Ai është i njëjtë dje, sot dhe përgjithmonë, atëherë çfarë ndodhi? Ose ishte martir, ose gënjeshtar, ose i çmendur!

Të kapërcejmë tek 28 janari i vitit 2013 ... Unë i thashë burrit tim: “Ose Zoti do të shfaqet, ose do të largohem.” ... E kisha mbyllur me kishën dhe Perëndinë. Kur dola nga shtëpia për të kryer disa punë, burri im më në fund ia vuri veshin nxitjes së Frymës të Shenjtë dhe thirri një mikën tonë të dashur për të folur. Pasi ai mbaroi, ajo tha se kishte diçka për ne për ta dëgjuar - Gary Keese. Ajo ndau dëshminë e saj për atë që i kishte ndodhur. Kështu, kur u ktheva në shtëpi, burri im më tha atë që ajo i kishte thënë dhe se ai do të shkonte të nesërmen për ta marrë.

Nuk e di se çfarë ndodhi (sepse kisha dëgjuar mjaftueshëm nga pastorët dhe mësuesit për të gjitha “gjërat shpirtërore”), por e mora atë në telefon dhe e pyeta nëse mund të na priste atë mbrëmje. Në mes të një nate me shumë borë, arrita të shkoja në shtëpinë e saj. Ndërsa po i jepja makinës, i thashë Zotit: Shpresoj të jetë gjëja e duhur!”

Të nesërmen, filluam të dëgjonim dhe të dy u tronditëm shumë. Gjithçka filloi të kishte kuptim. Të gjitha ato vargje: besimi, kapja fort pas rrëfimit. Të gjitha pjesët e mozaikut më në fund zunë vend. Ne kishim dëgjuar për Mbretërinë disa vite më parë, POR askush

nuk u mundua të na mësonte PROCESIN ... se si të arrihej tek “REZULTATI! Ti e bëre!”

Kështu që menjëherë, ne e vumë në zbatim atë që mësuam ... na duheshin para për pagesën e hipotekës. Ishte e enjte dhe burri im kishte mbaruar disa punë të vogla në shtëpinë e prindërve të mi... ata ngulmonin të dinin se sa duhet t'i jepnin burrit tim (ata e dinin se gjërat ishin të vështira). Unë u thashë atyre: “Sa të doni.” Nuk mjaftonte për të paguar pagesën e hipotekës... POR ishte ende vetëm e enjte.

Të premten kishim lënë një takim për t'u takuar me shoqen që na huazoi CD-të. Pati një stuhi të madhe dëbore, por si bashkëshorti im, edhe unë donim të uleshim dhe të flisnim me të për Mbretërinë dhe mënyrën se si funksiononte.

Përpara se të largoheshim, ajo deshi të lutej dhe na dha një çek... Zoti ia kishte ngulitur në zemër që të mbillte në jetën tonë. Kjo na habiti fare. Pastaj hapëm çekun... ishte MËSE MJAFTUESHËM për të paguar hipotekën dhe faturat e tjera më të vogla!

I thashë burrit tim se kjo ishte gjithçka që më duhej! Bëra një fotografi të çekut që të më kujtonte besnikërinë e Tij. Epo, armikut nuk i pëlqeu ajo që pa dhe menjëherë (dhe me të vërtetë menjëherë!!!!) u përpoq të na e vidhte farën. Ne kishim vendosur se kjo ishte e vërteta dhe nuk do të thoshim asgjë që do të shkatërronte të ardhmen tonë. Ai ishte i pamëshirshëm ... por ne i mbajtëm këmbët të palëvizura dhe mburojën të ngritur.

(Tani, para se të vazhdoj, kam nevojë që ti të kuptosh se unë isha një italiane kokëfortë, e ngopur me “mësimet e mirëqenies” që kisha dëgjuar ... dhe burri im e dinte këtë. Mrekullia e vërtetë ishte se e kuptova plotësisht dhe nuk e lëshova ... ndonjëherë burri im më shikon dhe pyet veten se çfarë ndodhi vallë!

Ne e çliruam besimin tonë dhe mbollëm për të marrë një kontratë për kompaninë tonë të ndërtimit më 13 mars, një kontratë të menjëhershme prej 150 000 dollarësh për të shlyer faturat e prapambetura, taksat, etj. Më 5 prill 2013, morëm dy kontrata, totali i të cilave arrinte në 450 000 dollarë, brenda NJË DITE !!!!! Kjo ishte vetëm pas dy muajsh që kur filluam të zbatonim parimet e Mbretërisë.

Ne i përfshimë fëmijët tanë dhe ata e panë “rezultatit”. Tanimë,

ata kanë bërë listën e tyre dhe kanë marrë nga kumbaratë e tyre për të mbjellë për atë që duan. Ne kemi vargje në çdo dhomë dhe fëmija ynë pesëvjeçar shikon nga ata dhe shpall: “Besoj se e kam marrë”.

Ne jemi shumë mirënjohës që tani kemi më shumë para për të dhënë dhe që jemi një ditë më afër shlyerjes së borxheve dhe që jemi në gjendje t’i kryejmë detyrat tona!

Faleminderit, Pastor Geri, që gjetët kohë për t’u përgjigjur emaileve që ju kisha dërguar. Ne e kuptojmë se koha juaj është e kufizuar dhe fakti që gjetët kohë për ta bërë këtë tregon se sa shumë dëshironi të ndani këtë mesazh të pabesueshëm të Mbretërisë së madhe të Perëndisë.”

Unë marr emaile të tilla çdo ditë. Njerëz si ti dhe unë po zbulojmë të vërtetën se kush janë ata në Krishtin, po mësojnë se si funksionon Mbretëria e Perëndisë dhe po shijojnë përfitimet. Pra, si e zbuluam Drenda dhe unë parimin e racionit të dyfishtë? Unë do të ta tregoj në këtë kapitull dhe e di që historitë tona do të të duken inkurajuese.

Kur Drenda dhe unë filluam t’i mësojmë ligjet dhe parimet nga Mbretëria e Perëndisë, jeta jonë u transformua rrënjësisht. Siç e thashë në pjesën e parë të këtij libri, kaluam nga të jetuarit me minimumin e mundshëm, duke u përballur me krizat e panikut, antidepresantë dhe dëshpërim të thellë në një jetë me qëllim dhe providencë. Ne pamë që ndodhnin vazhdimisht gjëra, që na bënë të ndalonim dhe të thoshim: “A e pe këtë? Uaa!” Ne do ta shihnim vazhdimisht Mbretërinë e Perëndisë të funksiononte ashtu siç thotë Bibla dhe do të bënim pyetje: “Si, ose, pse ndodhi kjo?” ose “Cilin parim kemi përdorur?” Edhe pse po shijonim më shumë se mjaftueshëm, në të vërtetë nuk e pamë racionin e dyfishtë aq qartë sa në tregimet që do të të tregoj. Ne po shijonim racionin e dyfishtë, megjithatë, thjesht nuk dinim ta quanim atë që po shihnim racionin e dyfishtë derisa Perëndia arriti të na e rriste kuptueshmërinë për të. Përpara se të shpjegoj se si Perëndia na ndihmoi ta kuptojmë racionin e dyfishtë në një mënyrë më të gjerë, dua të rishikoj përsëri për një minutë shkrimin e shenjtë kyç. (Fjalët në kllapa janë shënimet e mia, jo pjesë e shkrimit të shenjtë.)

*Mbetet, pra, një pushim i së shtunës për popullin e Perëndisë.
Sepse kush ka hyrë në prehjen (besimi) e tij, ka bërë pushim edhe ai*

nga veprat e veta (sistemi i mallkimit të tokës me mundim e djerë dhe mbijetesë), ashtu si Perëndia nga të tijat (sepse Ai e kreu punën).

- Hebrejve 4:9-10

Tashmë ti e di se ky pushim i shabatit është një premtim për çdo besimtar të Dhiatës së Re në Krishtin dhe nuk është vetëm një gjë e Dhiatës së Vjetër. Ti e di gjithashtu se shabati nuk është i mundur pa pasur më shumë se mjaftueshëm, ose siç pamë tek Eksodi 16, racionin e dyfishtë. Të lutem, mos e ngatërro të jetuarit me racionin e dyfishtë sikur nënkupton se në çdo rast do të kesh një tepriçë të madhe parash në dorë kur Perëndia të kërkon të zhvillosh një projekt.

Ka pasur raste në jetën time kur Jezusi më ka thënë të ecja përpara për një projekt kur nuk kisha para në bankë. Më vonë kuptova se Perëndia nuk ishte kurrë në ankth për paratë dhe e dinte se nga do të vinin ato. Por Ai nuk lejonte që të shfaqeshin, që armiku të mos përpiquej t'i vidhte përpara se të ishin me të vërtetë të nevojshme. Më lejo të të këshilloj, merr vendimin për të ecur përpara në një situatë të tillë vetëm nëse je i sigurt se e ke dëgjuar Frymën e Shenjtë të të thotë ta bësh këtë. E përsëris, nëse Jezusi nuk të thotë të ecësh përpara për një projekt pa i pasur fondet, mos vazhdo më tej. Prit që të vijë koha e Perëndisë dhe providenca të jetë në dispozicion.

Në përgjithësi, ne si besimtarë jemi thirrur të mbijetojmë me tepriçën financiare në jetën tonë. Ne nuk jemi të varfër, por të aftë të jemi bujarë në çdo rast ashtu siç është Ati ynë. E përmend këtë vetëm sepse kam marrë kaq shumë emaile të njerëzve që janë nxituar dhe e kanë humbur kohën e Perëndisë. Dëgjo, vetëm se Perëndia të tregon diçka nuk do të thotë se është koha për ta zhvilluar atë. Shumë herë, Ai të tregon diçka për të të dhënë drejtim dhe kohë për përgatitje. Sipas përvojës sime, koha është po aq e rëndësishme sa edhe dëgjimi i drejtimit në fillim.

Kur Jezusi e filloi shërbesën e Tij në qytetin e Tij të lindjes, pasi u pagëzua në lumin Jordan nga Gjon Pagëzori dhe pas 40 ditëve e netëve në shkretëtirë, Ai shkoi në sinagogën e tij lokale, mori pergamenën e Isaias dhe e hapi te kapitulli gjashtëdhjetë e një dhe lexoi. Këtë ngjarje e gjejmë të regjistruar te Lluca 4:18–21.

“Fryma e Zotit është mbi mua, sepse ai më vajosi për të ungjillizuar të varfrit; ai më dërgoi për të shëruar ata që e kanë zemrën të thyer, për të shpallur çlirimin e të burgosurve dhe kthimin e të parit të verbërve, për të çliruar përsëri të shtypurit, dhe për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit”.

Pastaj, si e mbylli librin dhe ia dha shërbyesit, u ul; dhe sytë e të gjithëve në sinagogë u drejtuan mbi të. Atëherë ai nisi të thotë: “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaja”.

Sigurisht, ata u zemëruan me Të sepse nënkuptoi se vargjet i referoheshin Atij. Por kushtoji vëmendje se ku ndaloj së lexuari Jezusi. Vargjet një deri në dy të Isaias 61 në të vërtetë thonë:

Më ka dërguar të lidh plagën e atyre që e kanë zemrën të thyer, për të shpallur çlirimin e të burgosurve dhe kthimin e të parit të verbërve, për të çliruar përsëri të shtypurit, dhe për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit.

Vër re se Jezusi u ndal në mes të një fjalie. Ai nuk lexoi “dhe ditën e hakmarrjes të Perëndisë tonë”. Pse? Sepse donte të ndalej në pjesën e parë të asaj fjalie, “viti i hirit të Zotit”. Cili është viti i hirit të Zotit? Viti i Jubileut! Jezusi në thelb po deklaronte se gjithçka që na tregonte hija e Ditës së Shabatit, viti shabatik dhe viti jubilar ishte përmbushur më parë dhe në këtë kohë, sepse Ai kishte ardhur. I gjithë kapitulli 61 i Isaias na tregon se çfarë ka bërë Jezusi për ne. Në lidhje me racionin e dyfishtë, hidhi një sy vargjeve shtatë deri në nëntë.

Në vend të turpit tuaj do të keni një nderim të dyfishtë; në vend të hutimit do të ngazëllojnë në trashëgiminë e tyre. Prandaj në vendin e tyre do të zotërojnë dyfishin dhe do të kenë një ngazëllim të përjetshëm. Sepse unë, Zoti, e dua drejtësinë, urrej vjedhjen në olokaust: unë do t’u jap atyre me besnikmëri shpërblimin dhe do të bëj me ta një besëlidhje të përjetshme. Pasardhësit e tyre do të jenë të njohur ndër kombet dhe brezi i tyre ndër popuj; tërë ata që do t’i shohin do t’i njohin, sepse ata janë një fis i bekuar nga Zoti.

- Isaias 61:7-9

Sigurisht që e kuptoj ç'do të thotë të turpërohesh për shkak të çështjeve sflitëse financiare. Shumë herë jam gjendur i poshtëruar dhe i turpëruar për gjendjen tonë financiare. Më kujtohet një herë që kisha mbledhur rreth 20 nga miqtë tanë për një darkë në një restorant lokal. Nuk më kujtohet rasti i veçantë që po festonim, por kisha pranuar të paguaja për darkën. Mbaj mend që isha shumë i tensionuar gjatë darkës, sepse me të vërtetë nuk kisha para për të organizuar një darkë të tillë.

Paratë që prisja të vinin nga një marrëveshje biznesi për të cilën po punoja ishin vonuar. E vetmja kartë krediti që kisha nuk ishte e anuluar, por e kishte arritur limitin dhe nuk isha i sigurt nëse do të funksiononte edhe një herë apo jo. Sigurisht, në fund të vaktit karta u refuzua. M'u desh t'i kërkoja me përlulësi, plotësisht i poshtëruar, njërit prej të ftuarve të mi që të paguante për darkën.

Oh, unë kam shumë histori të tilla, por nuk jam i sigurt nëse ke mjaft shami pranë për t'i llogaritur. Por lavdi Perëndisë, nëpërmjet Jezusit, të gjithë ata që na shohin do të duhet të pranojnë se ne jemi një popull që Zoti e ka bekuar!

Racioni i dyfishtë është i yti, Jezusi është pushimi yt i së shtunës dhe Ai është racioni yt i dyfishtë! Nëse e ke lexuar ndonjë nga librat e mi të mëparshëm, e di se Zoti më mësoi shumë për Mbretërinë përmes gjuetisë së drerëve. Në fakt, gjuetia e drerëve ishte mjeti që Perëndia përdori për ta tërhequr në fillim vëmendjen time te Mbretëria. Kisha vite që gjuaja drerë por pa sukses. Megjithatë po shpenzoja kohë dhe para në përpjekjet e mia, në përfundim nuk kisha as sukses dhe as gjah. Dhe të jem plotësisht i sinqertë, nuk do të kisha kurrë sukses. Në një vit të veçantë, ndërsa po mendoja për sezonin e ardhshëm të gjuetisë së drerëve, Zoti më foli dhe më tha: "Pse nuk më lë të të ndihmoj me

**VETËM NGAQË PERËNDIA TË
TREGON DIÇKA NUK DO TË
THOTË SE ËSHTË KOHA PËR TA
ZHVILLUAR ATË. SHUMË HERË,
AI TË TREGON DIÇKA PËR TË TË
DHËNË DREJTIM DHE KOHË PËR
PËRGATITJE.**

gjuetinë e drerëve këtë vit!?” Natyrisht, nuk e kisha idenë se çfarë do të thoshte kjo, por Ai më tha të merrja një çek dhe të shkruaja: “Për drerin e vitit 1987” në hapësirën ku shkruhet qëllimi i çekut, së bashku me një shumë të caktuar parash, dhe më pas t’ia dërgoja me postë një shërbimi ku Ai po më drejtonte ta dërgoja. Ai më tha gjithashtu që unë dhe Drenda t’i vendosnim duart mbi atë çek dhe të shpallnim vargun te Marku 11:24 ndërsa luteshim mbi të.

Mark 11:24 thotë:

Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkoni duke lutur, besoni se do t’i merrni dhe ju do t’i merrni.

Për t’i rënë shkurt kësaj historie të gjatë, shkova në një vend krejtësisht të panjohur atë vit dhe e kapa drerin tim pas rreth 40 minutash. Drenda dhe unë i kemi ndjekur këto hapa për 30 vitet e fundit dhe që nga ajo kohë e kam kapur gjithmonë drerin tim për 30 deri në 40 minuta çdo vit. Përgjatë viteve, kam parë Perëndinë të bëjë disa gjëra mjaft të mahnitshme gjatë gjuetisë dhe kam mësuar mjaft mësimet rreth ligjeve të Mbretërisë edhe përmes gjuetisë. (Të gjitha ato histori të hershme janë regjistruar në librin tim *Faith Hunt*.)

Zakonisht preferoj të gjuaj me harqe në ngjyrat e ngrohta të vjeshtës, më pas të gjuaj në sezonin e armëve të ftohta këtu në Ohio. Maksimumi i numrit të drerëve që mund të kapësh është tepër bujar në Ohio, dhe në cilindo vit, maksimumi është gjashtë drerë në vit. Nuk më është dashur kurrë të kapë qaq shumë drerë për të ushqyer familjen time. Zakonisht, mjaftojnë dy ose tre drerë në vit që të mbushet frigoriferi im. Për ta vlerësuar atë që do të të them më poshtë, duhet të dish se gjatë gjuetisë në ato vite nuk kisha qëlluar kurrë dy drerë nga i njëjti pozicion në pemë, në të njëjtën gjueti në mëngjes ose në mbrëmje. Meqë ra fjala, nëse nuk je gjuetar, po, ne gjuajmë me hark nga pozicioni i uljes i caktuar në pemë. Zakonisht, kur vrisja një dre, largohesha nga pylli dhe kthehesha një ditë tjetër dhe kapja një tjetër. Por Zoti donte të më mësonte diçka në këtë gjueti të veçantë në mbrëmje.

Ishte një nga ato ditët e përsosura të gjuetisë së vjeshtës, me një

mbulesë të hollë resh dhe një shi të lehtë që e spërkaste tokën herë pas here. Ishte një e diel në mbrëmje, isha pak i lodhur nga kryerja e shërbimeve të shumta në kishë atë mëngjes dhe mezi prisja të shkoja në pyll. Drenda po shkonte për të psonisur për disa gjëra, dhe ajo dhe unë kishim rënë dakord që kjo do të ishte një natë e mirë për të vendosur pak mish dreri në ngrirje. Po vishja kamuflazhin tim dhe po mblidhja gjërat e mia ndërsa ajo shkoi te makina. Dola jashtë ndërkohë që ajo po nxirrte makinën. Ndërsa e ndezi makinën, ajo uli dritaren dhe më tha: “Racioni i dyfishtë”. Nuk e dija pse e tha këtë, megjithëse më vonë tha se dëgjoi Zotin t’ia thoshte në atë moment dhe u ndje e shtyrë të ma thoshte mua.

Ne kishim “mbjellë” për tre drerë atë vit dhe kjo ishte dita e parë e gjuetisë jashtë për atë sezon. I dhashë një puthje të shpejtë dhe i thashë se isha dakord dhe u nisa drejt pyllit tonë. Unë gjuaj në tokën time, kështu që e dija shumë mirë se ku po shkoja. Teksa u ngjita në vendin tim në pemë, shfryva nja dy herë për të ulëritur. Brenda 15 minutash, një ekzemplar i madh 3-4 vjeçar u afrua duke vrapuar; unë mora shënjestër nga 40 metra larg dhe dreri im u rrëzua. Kjo ishte e mrekullueshme! Zbrita poshtë dhe eca deri te dreri, por më pas m’u kujtua ajo që kishte thënë Drenda, racioni i dyfishtë, kështu që e lashë drerin aty ku kishte rënë dhe u ktheva te pema ime dhe u ngjita përsëri në pozicion.

Mendova se, me gjithë rrëmujën që kisha bërë duke zbritur, duke ecur përreth, dhe pastaj duke u kthyer në vendin në pemë dhe duke u ngjitur lart, pa përmendur të gjithë aromën që ndoshta kisha shpërndarë përreth, do të kisha një shans të papërfillshëm për të vrarë një tjetër në ato pak minuta të mbetura para se të ndalohej gjuetia për shkak se po binte mbrëmja. Por brenda 15 minutave që qëndroja në pemë, një dre mashkull erdhi drejt e nën pemën time dhe unë e rrëzova atë me një goditje të përsosur. Uau, dy të shtëna dhe dy drerë njëri pas tjetrit nga e njëjta pemë. Nuk e kisha bërë kurrë më parë këtë gjë. Kjo më tërhoqi vëmendjen dhe e dija se ishte racioni i dyfishtë që më kishte përmendur Drenda.

Në pesë vitet e ardhshme, pata të njëjtën përvojë. Sa herë që dilja për të gjuajtur me hark, tanimë kapja dy drerë nga i njëjti pozicion në

pemë pak minuta njëri pas tjetrit. E dija se kjo nuk ishte normale dhe fillova të ndalem te racioni i dyfishtë, duke kuptuar se edhe një herë Perëndia po më mësonte një tjetër mësim rreth Mbretërisë së Tij.

Më kanë pëlqyer gjithmonë armët dhe, natyrisht, më pëlqen të gjuaj. Kam koleksionin tim të armëve që i përdor në gjueti dhe isha mjaft i kënaqur me armët që zotëroja. Unë dhe Drenda kemi 24 hektarë tokë me rreth 10 hektarë pyje dhe 6 hektarë të tjera moçalishtë. Në çdo vjeshtë, kënetat mund të jetë e thatë ose plot me ujë, në varësi se sa e lagësht ishte vera.

Në një vit të veçantë, ne patëm një verë mjaft të lagësht, kështu që kënetat ishin plot me ujë me ardhjen e sezonit të rosave të vjeshtës. Kishte gjithmonë rosa që vinin në kënetë çdo vit që kishte ujë, por në të vërtetë nuk u kisha kushtuar shumë vëmendje. Por këtë vit, kishte tufa të mëdha që vinin në kënetë meqë lartësia e ujit ishte ngritur, dhe unë nuk mund të rezistoj. Megjithatë në të kaluarën nuk jam përpjekur asnjëherë që t'i gjuaj, mendova të zbres në kënetë dhe të provoj gjuetinë e rosave. Epo, gjuetia ishte e mrekullueshme. Kishte rosa kudo dhe ne bëmë disa darka me mish rose atë vit.

Gjatë gjuetisë së rosave atë vit, zbulova se shumë herë rosat kalonin jashtë rrezes së çiftes. Po përdorja çiftin time të përditshme, me shumë përdorime, të cilën zakonisht e përdorja për lepujt dhe fazanët, por ndërsa rosat fluturuan pak jashtë rrezes së çiftes, m'u kujtua se kisha dëgjuar për një lloj më të ri pushke gjahu që ishte krijuar vetëm për gjueti rosash. Ato ishin të kamufluara dhe mund të gjuanin disa rosa me më shumë fishekë në një karikator më të madh, gjë që lejonte gjuajtje në distanca më të largëta. Mbaj mend që mendova se mbase duhet t'i provoja ndonjëherë.

Epo, ndodhesha në një dyqan lokal mallrash sportive një muaj pasi mbaroi sezoni i rosave, kur pashë një raft me pushkë të etiketuara si çifte për shpendë uji. I pashë pak, por me një çmim prej 2000 dollarësh dhe me faktin që çiftja nuk do të më duhej edhe për dhjetë muaj të tjerë deri kur të hapej sezoni i rosave, vendosa të prisja për ta bërë blerjen. Por pa u menduar, thashë me zë të lartë: “Zot, do ta doja atë.” Nuk e mendova gjatë ndërsa dola nga dyqani, por disa javë më vonë po flisja në një takim shitjesh në nivel korporate, jo në një mbledhje kishe, në

një mbledhje të shitjeve në nivel korporate. Në fund të prezantimit tim, drejtori i përgjithshëm më falënderoi që fola dhe tha: “Dua t’ju falënderojmë që folët sonte me një dhuratë.” U habita kur ai solli pikërisht pushkën e gjahut që kisha parë në dyqanin e mallrave sportive vetëm disa javë më parë. Fjalët e mia: “Zot, unë do ta kem atë” dhe fakti që kisha dhuruar armë në të kaluarën solli atë rezultat.

Në librin e parë të kësaj serie, “Revolucioni juaj financiar: Fuqia e besnikërisë”, unë flas për parimin që bëri që të shfaqej ajo çifte. Unë e quaj atë parimi i draprit dhe gjendet te Marku 4:26–29. Do të të sugjeroja të marrësh një kopje të librit nëse nuk e ke lexuar tashmë. Ajo çifte që u shfaq ishte e mahnitshme me siguri, por nuk është historia e vërtetë ku dua të përqendrohem. Por kjo e nxiti historinë që dua të të tregoj.

Pasi u shfaq ajo armë dhe pasi kuptova se si e kisha vënë në lëvizje atë rezultat, një ditë mendova për një çast për çdo çifte tjetër që do të doja ta kisha pasur. Në fund të fundit, kisha dhuruar dhjetëra çifte, kështu që mendova të eksperimentoja me ligjet e Mbretërisë. E vetmja armë që nuk kisha në koleksionin tim ishte një pushkë gjahu me karikator, me dy pozicione. Ato janë armë gjahu të bukura dhe zakonisht nuk janë as të lira. Kështu që thashë: “Zot, do të doja të kisha një nga ato çiftet e bukura me dy pozicione!”

Rreth një muaj më vonë, mora një telefonatë nga një partner i shërbimit i cili më tha se donte të më blinte një pushkë gjahu, një me dy pozicione. Isha i emocionuar dhe ai tha se do ta dërgonte me postë. Epo, disa ditë më vonë mora me postë dy pushkë gjahu të bukura me dy pozicione, thjesht të mrekullueshme! Vër re se mora dy pushkë gjahu. “Ua”, mendova. E telefonova partnerin dhe e falënderova për pushkët e bukura që kishte dërguar. Brenda pak ditësh dërgoi edhe dy të tjera. Kur e telefonova për ta falënderuar përsëri, ai tha: “Më bëri aq shumë përshtypje që më telefonove personalisht për të më falënderuar, sa që doja të të dërgoja edhe dy të tjera.” U mahnita me dhuratat, por kisha filluar të shihja një model këtu. Dy pushkë gjahu çdo herë? Tingëllon si racion i dyfishtë.

Rreth dy muaj më parë, po jepja mësim në një kishë në mëngjes dhe më pas do të jepja mësim në të njëjtin qytet në një kishë tjetër atë

mbrëmje. Pas shërbesës së mëngjesit, një burrë vjen drejt meje dhe më thotë: “Unë do të të dërgoj një armë gjahu të bukur gjysmëautomatike Browning që kam.” Përsëri, u emocionova. Çuditërisht, në shërbesën e mbrëmjes në kishën tjetër, një burrë më afrohet dhe më thotë: “Kam sjellë një pushkë të re fringo që është ende në kuti, që dua të ta jap.” Ishte një Marlin 30/30 e bukur, me dylbi, një armë që e kam admiruar shpesh, por nuk e kam pasur kurrë. Përsëri, u befasova, por po e kapja – racioni i dyfishtë.

Sërish, disa javë pas kësaj, ndodhi e njëjta gjë—më dhanë dy pushkë gjahu në të njëjtën ditë. Epo, gjithçka që mund të them është se jam një njeri i bekuar me armë gjahu të shkëlqyera. Por si çdo për histori që tregoj, gjithmonë pyes: “Si ndodhi kjo?” Sigurisht, ta kam thënë tashmë se kam dhuruar (mbjellë) shumë armë në të kaluarën, por kurrë nuk kisha thënë: “Do ta marr atë, Zot”, deri atëherë. Përsëri, ky është parimi i draprit që duhet ta dish. Por përtej parimit të draprit, po merrja racionin e dyfishtë në një mënyrë shumë të dallueshme dhe të dukshme dhe doja të dija saktësisht se si po e bëja këtë. Besoj se Zoti më tregoi se shumë prej nesh e anashkalojmë këtë aspekt shumë të rëndësishëm të korrjes nga Mbretëria, ndaj do të kaloj pak kohë në kapitullin tjetër duke e trajtuar këtë temë. Por para se ta bëj, më duhet vetëm të ndaj me ty se si vazhdoi ai vit.

Pasi më erdhën pushkët me postë, ndodhi kjo histori - dhe është një nga historitë më të mahnitshme që kanë ndodhur në lidhje me shfaqjen e racionit të dyfishtë në një mënyrë të qartë, të dukshme, pa bërë pyetje: kjo është një shembull i racionit të dyfishtë. Kjo histori ka të bëjë me automjetet e mia, sidomos me Cadillac Escalade me ngjyrë perlë të bardhë që ma dhuruan, që e përmenda disa kapituj më parë. Siç e thashë edhe më herët në libër, unë dhe Drenda nuk jemi vërtet të dhënë pas makinave. Ne zakonisht i ngasim ato derisa të ndalojnë së punuari ose kur pamja e tyre të mos jetë më e mirë.

Dhe përsëri në këtë histori, më duhet të përmend se Drenda dhe unë kishim dhuruar disa makina më parë dhe nuk kishim bërë një kërkesë të qartë me besim se çfarë besonim se do të korrnim nga ai dhurim. Por nëse të kujtohet ajo histori, kur ngamë makinën Escalade të marrë me qira gjatë konferencës sonë dhe thamë: “Na pëlqen kjo;

ne mendojmë se duhet të blejmë një nga këto”, vërtet nuk prisnim që dikush të na telefononte dhe të thoshte se donte të na blinte një të tillë. Por, sigurisht, kjo është ajo që ndodhi. Dhe, sigurisht, ne nuk i kishim thënë askujt që donim një të tillë. Pra, siç të thashë më herët, versioni Escalade ngjyrë perle të bardhë, i shkurtër, u shfaq dhe ishte dhe është thjesht i mrekullueshëm. E adhuroj.

Por ajo histori ka edhe një hollësi tjetër të mahnitshme që ndodhi verën që kaloi. Deri verën e kaluar kishim rreth një vit e gjysmë që e ngisnim këtë makinë Escalade dhe një ditë vura re se drita për të kontrolluar motorin u ndez. “Nuk ka problem”, mendova, por doja që ta kontrolloja, kështu që kërkova që një distributor ta shikonte.

Ata thanë se nuk ishte aspak problem. Sensori po tërhiqte pak naftë në marmitë, por nuk do të shkaktonte problem. Motori do të rronte për aq kohë sa do të doja ta drejtoja makinën. I pyeta pse thithte naftë. Makinës sime Escalade i kishin vënë një sistem shkarkimi gazesh të veçantë dhe ata menduan se kjo mund të ishte një arsye pse po ndodhte. Përsëri, më thanë se vetë motori ishte në rregull dhe parashikohej që motori të rronte për një kohë të gjatë.

Një ditë, në një bisedë të rastësishme me njeriun që më kishte dhënë automjetin, përmenda problemin e dritës së sensorit. Ai tha: “Po, e kam parë që të ndodhë me automjete të tjera GMC.” “Në fakt”, tha ai, “është mjaft e zakonshme te modelet e vjetra.” Ai vazhdoi duke thënë se kjo nuk do të ndikonte në asnjë mënyrë në makinë dhe se duhet të jem në gjendje ta drejtoj mjetin për 10 vitet e ardhshme ose më gjatë pa asnjë problem.

Ai e dinte që Drenda dhe unë kemi një shtëpi në Florida që sapo e kisha blerë. U ula aty i habitur ndërsa ai më pas tha: “A e di çfarë? Shkoni me këtë makinë deri në Florida dhe përdoreni atje dhe unë do t’ju blej një tjetër për ta përdorur këtu në Ohajo.” Po, tani kam dy makina Escalade në ngjyrë perlë të bardhë, versioni i shkurtër, që janë

UNË NDJEK MBRETIN DHE MBRETËRINË E TIJ, POR NË MBRETËRI GJEJ MËSE MJAFTUESHËM, RACIONIN E DYFISHTË!

të përsosura në çdo aspekt, përveç dritës së sensorit që ndizet herë pas here tek e para. Të dyja janë të përsosura në çdo aspekt! Përsëri, ishte një nga ato çastet kur pyet “A e pe atë?” Unë dhe Drenda duhet ta pickojmë veten teksa i ngasim ato automjete të bukura. Ne nuk kemi paguar për asnjërën prej atyre automjeteve. Por në këtë rast, ne e dinim se ishte racioni i dyfishtë.

Nuk po t’i tregoj këto histori për t’u mburrur në asnjë mënyrë, por mik, jam i bekuar! Po e shijoj racionin e dyfishtë, që siç ti e di tashmë, do të thotë të kesh mëse mjaftueshëm. Unë kam një kasafortë plot me armë, të cilat janë mëse të mjaftueshme. Unë kam dy makina Escalade identike që nuk i kam paguar. Mendoj se je dakord që kjo është mëse mjaftueshëm! Dhe nuk është se po të inkurajoj të kërkosh gjëra materiale, nuk po të inkurajoj. Unë nuk jam i fiksuar pas gjërave dhe as nuk i adhuroj, as nuk i kërkoj me ngulm. Unë ndjek Mbretin dhe Mbretërinë e Tij, por në Mbretëri gjej mëse mjaftueshëm, racionin e dyfishtë!

Prit, nuk kam mbaruar ende së dëshmuari për mirësinë e Zotit dhe për racionin e dyfishtë.

Gruaja ime kishte 20 vjet që dëshironte një shtëpi plazhi. Jo, më lejo ta riformuloj. Ajo ka gjithë jetën që e ka dashur! Ajo e adhuron oqeanin! Gjithsesi, ajo ka vite që shikon prona buzë oqeanit. Në të kaluarën, kur gjente një shtëpi me çmim të mirë, paratë tona ishin të bllokuara në projektet e shërbimit dhe ne prisnim. Epo, këtë vit po lutesha në bodrum ndërsa po ngisja biçikletën e stërvitjes. Krejt papritur, Zoti la tek unë një mbresë shumë të fortë: “Thuaji Drendës të shkojë në Florida, në qytetin ku dëshironte të kishte një shtëpi dhe thuaji ta blejë shtëpinë buzë oqeanit këtë javë.” Ua, këtë javë? Ndjeva një urgjencë të fortë në shpirtin tim kur e dëgjova këtë. Kështu që i thashë Drendës atë që Zoti më kishte thënë dhe kontaktuam një mikeshën tonë që jetonte në atë qytet për të parë nëse ajo do të donte ta shoqëronte Drendën për disa ditë për të parë shtëpi. Ajo tha se do ta bënte me kënaqësi.

Kështu Drenda hyri në internet dhe bëri një listë me rreth 25 shtëpi që donte t’u hidhte një sy. Kur arriti, Drenda e ngushtoi listën e saj me 25 shtëpi në 5 që konsideroheshin si mundësi dhe një që ajo

e adhuronte. Në këtë pikë, shkova atje me avion dhe u bashkua me të dhe ajo më tregoi 5 shtëpitë dhe atë që i pëlqente. Ne zbritëm nga 5 në 2 – ajo që i pëlqente dhe një shtëpi tjetër që ishte shumë e bukur, por jo aq e bukur sa ajo që donte. Më duhet ta pranoj se kur pashë shtëpinë që ajo e pëlqente, e dija se i përshtatej Drendës dhe përfundua duke bërë një ofertë. Pronari e pranoi ofertën tonë dhe po bënim kontratën për blerjen e shtëpisë sonë të re.

Disa javë më vonë, kur ishim në shtëpi në Ohajo duke pushuar, Drenda gulçoi dhe tha: “Kjo është shtëpia ime!” “E di”, i thashë, “kjo është shtëpia jote. Zoti më tha se duhej të ta blija shtëpinë buzë oqeanit javën që të thashë të shkoje pranë oqeanit.”

“Jo”, tha ajo, “ti nuk po e kupton; ajo është shtëpia ime.” Ajo vazhdoi të shpjegonte se kishte disa vite që kërkonte shtëpi në atë zonë dhe një ditë pa një foto të shtëpisë që po blinim në një reklamë të pasurive të paluajtshme. Kur e pa, i pëlqeu. Asaj i pëlqente gjithçka rreth saj, arkitektura mesdhetare spanjolle, planimetria, vendndodhja, gjithçka. Asaj iu kujtua se kishte vënë gishtin mbi atë foto dhe kishte thënë: “Zot, unë e dua atë shtëpi!” Por e dinte se shtëpia ishte shumë e shtrenjtë dhe ne i kishim përdorur paratë tona në projekte të tjera, kështu që ajo vazhdoi të shikonte shtëpi që ishin brenda fashës sonë të çmimeve në atë kohë. Por asnjë shtëpi tjetër nuk i ngjiti dhe nuk arritëm kurrë në pikën që të lidhnim një kontratë. Nuk kishim ende paqe për një shtëpi.

Duhet të dish gjithashtu se ne kishim mbjellë farë për një shtëpi në plazh, buzë oqeanit, në këtë qytet më shumë se dy vjet më parë. Rrëfimi ynë gjatë kësaj kohe ishte se ne kemi një shtëpi plazhi në këtë qytet, e kemi tashmë dhe e kemi marrë ditën që mbollëm për të. Më kujtohet saktësisht vendi dhe çasti që u kapëm për dore dhe ramë dakord në emër të shtëpisë së plazhit të Drendës buzë oqeanit. Por tani që po lidhnim kontratën, Drendës iu kujtua papritur fotografia që kishte parë dy vite më parë dhe kuptoi se kjo ishte e njëjta shtëpi, shtëpia e saj!

Pasi e hetuam historikun e shtëpisë, zbuluam se disa vite më parë pronari kishte tentuar vërtet ta shiste shtëpinë, por nuk i ishte shitur dhe e hoqi nga tregu. Në atë kohë Drenda e kishte parë foton e shtëpisë në listën e pasurive të paluajtshme. Por pronari kishte vendosur ta nxirrte

sërish për shitje dhe kjo shpjegon pse pata një urgjencë të papritur për ta dërguar Drendën pranë oqeanit me udhëzimet: “Ti duhet të blesh një shtëpi këtë javë”. Ajo mund të të thotë se nuk e kam zakon që t’i shpenzoj kështu paratë. Koha është gjithçka. Kësaj herë, paratë e mia nuk ishin të bllokuara në projekte të tjera dhe ishin në dispozicion për shtëpinë. Jam i sigurt se kishte shumë njerëz që po e shikonin atë shtëpi dhe kjo ishte arsyeja e ngutjes. Çuditërisht, çmimi nuk ishte rritur nga çmimi i listuar dy vjet më parë kur ajo e pa për herë të parë. Besoj se Zoti po e ruante për të!

Por këtu vjen racioni i dyfishtë i historisë. Ndërsa prisnim të nënshkruanim kontratën për shtëpinë tonë, morëm një telefonatë nga nëna e Drendës. Ata kishin një shtëpi në Kanada prej 32 vitesh. Ne kishim qenë atje disa herë dhe na pëlqente shtëpia dhe vendndodhja. Shtëpia ndodhet në një ishull, e rrethuar nga uji. Në fakt, oqeani është rreth 10 metra nga veranda e pasme. Prindërit e Drendës po plakeshin dhe vendosën se nuk donin ta mirëmbanin dhe të shpenzonin për një shtëpi kaq larg. Ata erdhën te ne dhe na pyetën nëse kishim ndonjë interes për ta blerë dhe unë u thashë jo. Ishte 31 orë me makinë larg Ohajos dhe, megjithëse më pëlqente vendi, thjesht mendova se nuk do të ishte

**MOS MENDO SE RACIONI I
DYFISHTË KUFIZOHET NË
ZOTËRIMIN E DY GJËRAVE
TË TË NJËJTIT LLOJ. NË
FAKT, RACION I DYFISHTË
DO TË THOTË TË KESH
MËSE MJAFTUESHËM.**

një vend ku do të shkoja shpesh për shkak se sa zgjaste udhëtimi. Kështu ata e nxorën shtëpinë për shitje me një agjent imobiliar, por pasi e lanë për shitje për dy vite, asnjë blerës nuk tregoi interes të vërtetë.

Kështu tani, ndërsa ne prisnim të nënshkruanim për shtëpinë tonë buzë oqeanit, ata na telefonuan dhe na shpjeguan se ishin përpjekur ta shisnin shtëpinë, por pa sukses, dhe do të ishin të gatshëm ta

përgjysmonin çmimin nëse donim ta blinim dhe ta mbanim në familje. Po mendoja që fëmijët e mi ishin rritur duke shkuar atje dhe është një vend i bukur. Kështu që unë dhe Drenda u lutëm për këtë dhe thamë se do ta blinim. Kishim mjaftueshëm para në dorë për të bërë blerjen.

Përveç kësaj, kishim blerë një avion për kompaninë time një vit më parë, që na lejonte të shkonim atje për 5 orë në vend të 31 orëve që duheshin me makinë. Kjo e bëri shumë më të mundshme vajtjen atje.

Pasi i blemë të dyja shtëpitë, një ditë isha i ulur në zyrën time, kur papritmas e kuptova: “Prit një minutë, ky është racioni i dyfishtë!” Gruaja ime kishte vite që ëndërronte një shtëpi buzë oqeanit. Tani, brenda dy muajve, ajo mori një shtëpi që është në pjesën jugore të Shteteve të Bashkuara, e cila është e ngrohtë në dimër, por shumë e nxehtë për ta përdorur në verë. Por shtëpia në Kanada ka temperaturën e përsosur në verë, por shumë e ftohtë në dimër. Kuptuam që ajo tani ka një shtëpi buzë oqeanit për të dy stinët. E pabesueshme. Sigurisht që thamë: “A e pe këtë?” pasi u lidhën të dyja kontratat. Mendoj se je dakord që kjo pa pamjen dhe aromën e racionit të dyfishtë! E mahnitshme!

Unë kam përdorur disa shembuj se si Zoti solli dy gjëra nga i njëjti lloj për mua dhe Drendën, që besoj se Perëndia i përdori për të na lejuar të shohim qartë racionin e dyfishtë në veprim. Por dua të sigurohem që ti nuk mendon se racioni i dyfishtë kufizohet në zotërimin e dy gjërave të të njëjtit lloj. Në fakt, racioni i dyfishtë do të thotë të kesh mëse mjaftueshëm. Perëndia po i përdorte këta shembuj shumë të dallueshëm të dy gjërave për të tërhequr vëmendjen time rreth racionit të dyfishtë. Pra, pavarësisht se çfarë është, bollëku që jepet është racioni i dyfishtë. Shpresoj se po e kupton realitetin e racionit të dyfishtë dhe pushimit të shabatit. Jeta është kaq e mahnitshme në Mbretëri! Ndërsa shkruaj këtë kapitull, jam ulur në shtëpinë tonë në Kanada, duke parë oqeanin nga dritarja. Ka pulëbardha dhe rosa që luajnë përgjatë bregut vetëm 22 metra larg shtëpisë. Ka paqe, nuk ka përpjekje, është e paguar dhe një bekim. Mua më është ngarkuar një detyrë, të shpërndaj lajmin e mirë për Mbretërinë e Atit tim, një bir në shtëpinë e Tij, një qytetar i Mbretërisë së Tij të madhe dhe po shijoj racionin e dyfishtë!

Drenda dhe unë mund të shkruanim kaq shumë histori se si Mbretëria e Perëndisë dhe ligjet që e drejtojnë atë kanë ndikuar në jetën tonë, si dhe të mijëra njerëzve që na i dërgojnë në email historitë e tyre. Siç e tregova, ti mund t'i lexosh të gjitha këto gjëra në Bibël, por është kaq emocionuese të shohësh Biblën të shpaloset para syve të tu.

Këtu do të doja të shtoja diçka. Është vërtet e rrezikshme për mua t'ua tregoj njerëzve se si Perëndia më ka bekuar mua dhe Drendën dhe udhëtimin që kemi bërë. Njerëzit shumë herë e kuptojnë gabim. Ata ndonjëherë mund të mendojnë se ne jemi krenarë ose mburravacë. Ose mendojnë se ne kemi marrë të dhjetat ose ofertat e tyre dhe i kemi shpenzuar për veten tonë. Të lutem kuptoje se unë dhe Drenda nuk marrim para nga transmetimi ynë televiziv dhe nuk marrim para nga shitja e burimeve tona. Po, ne marrim një rrogë, natyrisht, nga kisha që drejtojmë. Por ne zotërojmë biznese prej shumë kohësh dhe Perëndia i bekon ato. Thjesht doja të sigurohesha që ta njohësh zemrën tonë teksa t'i tregojmë këto histori personale. E ndjeva se kisha nevojë të ta tregoja atë që kemi parë të ndodhë në të vërtetë dhe çfarë na mësoi Perëndia për ato ngjarje. Rezultatet që po ndaj me ty nuk janë rezultatet e Gary dhe Drenda Keese; ne nuk jemi aq të zotë! Jo, ajo që kemi parë dhe ajo që po shijojmë është rezultat i Atit tonë dhe Mbretërisë së Tij në jetën tonë. Ne i tregojmë këto histori sepse duam që ti të kuptosh! Hej, ne erdhëm nga hiçi dhe e vetmja arsye që po e shkruaj këtë libër je ti! Unë dua që ti ta dish se si funksionon, në mënyrë që ta kuptosh dhe të marrësh gjithçka që Perëndia ka edhe për ty.

Kuptoje që e urrej varfërinë me gjithë shpirt. Ato nëntë vite të jetesës në stres dhe frikë të vazhdueshme ishin me të vërtetë një ferr i përjetuar në tokë! Shpresoj se do të mbash mend se pushimi i shabatit është i yti ashtu si edhe i imi! Në kapitullin tjetër, unë do të të ndihmoj ta kuptosh se si ta përdorësh pushimin e shabatit.

Dua të shtoj edhe diçka tjetër në këtë kapitull. Ndërkohë që mbarova së shkruari fjalinë e mësipërme, sekretarja ime hyri në zyrën time dhe tha se kishte ardhur një kuti për mua. U befasova kur e hapa dhe gjeta dy armë gjahu shumë të bukura. Ua, kjo ishte inkurajuese! M'u duk sikur Perëndia e vulosi me një "Amen" atë që sapo kisha thënë.

Pasi ky libër kaloi në shtypshkronjë dhe unë mora sasinë e parë të librave të mi, u emocionova kur i dhashë mësim për herë të parë këto parime në konferencën tonë "Revolucioni i Atlantës". Isha i emocionuar edhe që e kisha librin tim të ri me vete për t'ua dhënë njerëzve. Teksa po bëhesha gati të zbrisja në sallë për të folur, sekretarja

ime më thirri dhe më tha se kishte një telefonatë për mua nga zotëria që më kishte dhënë kompletin e parë të çifteve dhe më tha se ai donte të fliste me mua menjëherë. Kështu që i bëra një telefonatë të shpejtë. Ai ishte aq i emocionuar ndërsa më shpjegonte se sapo kishte qenë në zyrën e UPS-së dhe më kishte dërguar dy çifte të tjera! Përveç kësaj, ai i kishte dërguar edhe Drendës një çifte dhe, për shkak se e dinte që ajo nuk gjuante, i dërgoi 1500 dollarë në kartëmonedha njëqind dollarëshe. Unë u trondita. Ndjeva se edhe një herë Perëndia po ma konfirmonte atë që po bëja dhe, në një farë mënyre, më thoshte të vazhdoja. Njerëzit duhet t'i dinë këto gjëra - Perëndia dëshiron që ti ta dish këtë! Gjithsesi, kur arrita në shtëpi, u emocionova kur e hapa kutinë. Mua dhe Drendës sapo na kishin dhuruar dy çiftet më të bukura e të njëjta të tipit Browning me dy pozicione që kisha parë ndonjëherë. Ishin fringo të reja. Unë kisha gjithashtu një kalibrues gjysmë-automatik 20 ngjyrë floriri të tipit Browning dhe, natyrisht, Drenda kishte 1500 dollarë. Racioni i dyfishtë!

Ti mund të pyesësh veten pse kaq shumë çifte. Epo, duhet të pranoj se tani kam shumë pushkë gjahu shumë të bukura, dhe as të lira, dhe të njëjtën pyetje e bëra edhe unë. Perëndia më bëri të ditur se Ai kishte dërguar kaq shumë armë gjahu shumë të shtrenjta dhe të bukura për të më lënë të shihja sa të mëdha ishin burimet e Tij, se providenca e Tij është përtej asaj që prisja dhe përtej mbijetesës. E kuptoj! E shoh!

KAPITULLI 10

MISTERI I RACIONIT TË DYFISHTË

E kam trajtuar tashmë se çfarë është pushimi i shabatit dhe si është i mundur nëpërmjet racionit të dyfishtë. Pyetja që duhet të jetë në mendjen tënde është: “Si mund ta shfrytëzosh racionin e dyfishtë?” Epo, më vjen mirë që pyete! Për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje, le të kthehemi te historia ku Jezusi ushqeu 5000 burra me pesë bukë dhe dy peshq.

Duke qenë se u bë vonë, dishepujt e tij iu afruan dhe i thanë: “Ky vend është i shkretë, dhe tashmë është vonë. Lejoi këta njerëz që të shkojnë në fushat dhe në fshatrat rreth e qark që të blejnë bukë, se s’kanë gjë për të ngrënë”.

Por ai, duke iu përgjigjur, u tha atyre: “U jepni ju të hanë!” Ata i thanë: “A duhet të shkojmë ne të blejmë për dyqind denarë bukë dhe t’u japim të hanë?”.

Dhe ai u tha atyre: “Sa bukë keni? Shkoni e shikoni”.

Ata, mbasi shikuan, thanë: “Pesë bukë e dy peshq”.

Atëherë ai i urdhëroi ata që t’i rregullojnë të gjithë, ulur në grupe, mbi barin e njomë. Kështu ata u ulën në grupe nga njëqind e nga pesëdhjetë. Pastaj ai mori pesë bukët dhe dy peshqit, i ngriti sytë nga qielli, i bekoi; i theu bukët dhe ua dha dishepujve të vet,

që t'ua shpërndanin atyre; ua ndau gjithashtu dy peshqit të gjithëve. Të gjithë hëngrën sa u ngopën. Dhe mblodhën dymbëdhjetë shporta me copa buke dhe me mbetje peshku. Ata që hëngrën nga ato bukë ishin pesë mijë burra.

- Marku 6:35-44

Ne folëm më herët për këtë histori, por ajo përmban disa të dhëna vërtet të rëndësishme për racionin e dyfishtë. Në tregim, Jezusi i

**KA NJË MËNYRË MË TË MIRË SESA
TË SYNOSH PËR TË QENË I KËNAQUR.
NUK MUND TË NDËRTOSH SHUMË ME
MENDËSINË E KËNAQJES. VIZIONI
ËSHTË ENDE I KUFIZUAR NË NIVELIN
E KËNAQËSISË SË PËRQENDRIMIT
VETËM NË TË SOTMEN.**

shumëzoi në mënyrë të mbinatyrshtme bukën dhe peshkun dhe njerëzit hëngrën të gjithë derisa u ngopën.

Ma merr mendja se ishin rreth 20 000 njerëz, duke përfshirë gratë dhe fëmijët; dhe që kaq shumë njerëz të ushqehen me pesë bukë dhe dy peshq derisa të gjithë u ngopën, është

sigurisht dhe absolutisht një gjë e Perëndisë. Dhe për këtë, ne mund të kremtojmë Mbretërinë dhe mënyrën se si funksionoi ajo. Por vetëm të ushqyerit e njerëzve nuk është e gjithë tabloja e asaj që ndodhi dhe, nëse ndalon këtu, do ta humbasësh racionin e dyfishtë. Le të gërmojmë pak më tej.

Të gjithë hëngrën sa u ngopën. Dhe mblodhën dymbëdhjetë shporta me copa buke dhe me mbetje peshku. Ata që hëngrën nga ato bukë ishin pesë mijë burra.

Pra, çfarë po na thotë teksti? Se pasi u ngopën të gjithë, u mblodhën 12 kosha plot bukë dhe copa peshku. Përkufizimi i racionit të dyfishtë është të ketë më shumë nga sa mjafton. Mjaftueshëm do të thotë të ngopesh, por 12 kosha të mbetura pasi populli u ngop është racioni

i dyfishtë, më shumë nga sa mjafton. Të lutem, lëre këtë ndryshim të arrijë në vetëdijen tënde për pak. Dua që ti të kesh dyfishtë në mendjen tënde një pasqyrë të qartë të vargut të ngopjes, të racionit të. Nuk kam kohë këtu për t' u thelluar shumë se si Jezusi e solli fuqinë e Mbretërisë në atë situatë për të përmbushur pjesën e parë të kësaj historie – u ushqyen 5000 njerëz. Por mund ta gjesh shpjegimin e plotë në librin e parë të kësaj serie, të quajtur *Revolucioni juaj financiar: Fuqia e besnikërisë*.

Në vend të kësaj, unë dua të përqendrohem në racionin e dyfishtë, gufimin dhe se si ndodhi në këtë histori. Po, është një histori e mahnitshme – 20 000 njerëz të gjithë të ngopur, e mahnitshme! Por Mbretëria ofron më shumë sesa ngopjen, megjithëse sigurisht që duhet të jesh i kënaqur përpara se të kalosh te gufimi. Të jesh i kënaqur është shumë mirë, por po nesër? Ajo që po përpiqem të them është se nëse qëllimi yt është vetëm të ngopesh, çfarë ndodh kur të kesh përsëri uri? Shumë të krishterë janë në gjendjen e të qenit të ngopur, por e humbasin racionin e dyfishtë. Racioni i dyfishtë është ai që e sjell prehjen e shabatit të Perëndisë. Të jesh i ngopur është vetëm një zgjidhje e përkohshme. Nuk e zgjidh problemin e providencës. Dijenia se do të të marrë sërish uria, edhe pse aktualisht nuk je i uritur, ia hap derën frikës, duke bërë që të vraposh dhe të punosh me një mendësi mbijetese. Jo, ka një mënyrë më të mirë për të jetuar sesa thjesht të synosh të jesh i ngopur. Nuk mund të ndërtosh shumë me mendësinë e ngopjes. Vizioni është ende i kufizuar në nivelin e të qenit i ngopur, të fokusimit vetëm tek e sotmja. Të kesh qëllimin për të qenë i ngopur është një qëllim mbijetese në sistemin e mallkimit të tokës me mund e djersë.

Të ngopesh do të thotë të hash sa për sot; racioni i dyfishtë do të thotë të ndërtosh për nesër!

Më lejo të të jap një shembull se si mendon kultura dhe shumica e kishës. Pyet këdo se si po ecën financiarisht dhe do të marrësh shumë përgjigje, ndoshta jo shumë të mira. Por nëse merr një përgjigje të mirë, dikush që thotë, “Jemi shkëlqyeshëm”, pyete atë: “Sa kohë ke që e ke shlyer shtëpinë tënde?” Ai ndoshta do të t' i ngulë sytë e do të të

thonë: “Epo, nuk e kam shlyer shtëpinë. Unë thjesht doja të thosha se ne po paguajmë të gjitha faturat tona dhe kemi disa para në bankë.” “Shkëlqyeshëm!” i thua ti, “Qenke vërtet mirë. Më thuaj, a ke mbi 10 000 dollarë në bankë?” Sigurisht, askush nuk do ta bënte këtë pyetje, ma merr mendja, por nëse e bën dhe do të të përgjigjej, do të të thoshte: “Jo, por ne kemi 800 dollarë.” Seriozisht, këta njerëz mendojnë se janë mirë financiarisht sepse kanë një makinë të bukur, një shtëpi të bukur dhe disa dollarë në bankë. Ata po jetojnë një mënyrë jetese të kënaqur. Por ka më shumë! Po sikur ta kesh paguar shtëpinë tënde dhe të kesh 100 000 dollarë në bankë, ose 500 000 dollarë në bankë? Kjo do të ishte pamja e jetës me bollëk për shumicën e njerëzve. Të jesh i kënaqur është fantastike dhe e nevojshme, por të kesh 12 kosha me bukë dhe peshk në dollapin e ushqimeve është mëse e mjaftueshme dhe sjell paqe!

Një ditë u ula me një klient dhe po diskutonim financat e tij. Teksa po shqyrtoja borxhet e tij, vura re se ai kishte rreth 40 000 dollarë borxh në kartën e kreditit. Dhe ndërsa po shqyrtoja asetet e tij, vura re se ai kishte rreth 40 000 dollarë para të thata në llogarinë e tij rrjedhëse. “Xho”, i thashë, “kjo është shumë e thjeshtë. Ti ke para për t’i shlyer plotësisht të tre kartat e tua të kreditit. Norma e interesit për borxhin e kartës së kreditit është 18% dhe norma e interesit në llogarinë tënde rrjedhëse është 1%. Paguani kartat e kreditit me para!” Por a e di çfarë? Xho tha se nuk donte ta bënte këtë. Mbeta aty i habitur dhe e pyeta pse. Ai tha se duke pasur para në llogarinë e tij rrjedhëse ai ndihej i sigurt dhe më i pasur financiarisht. Po e shikoja. “Çfarë do të thuash që të bën të ndihesh i pasur? Ky është një iluzion. Edhe pse ti ke 40 000 dollarë në llogarinë tënde rrjedhëse, në të vërtetë nuk ke 40 000 dollarë sepse u detyrohesh kompanive të kartave tuaja të kreditit 40 000 dollarë. Perceptimi yt është i rremë dhe po paguan shumë para për të besuar një mashtrim.”

Folëm për rreth një orë dhe ai nuk arriti ta kuptonte pse duhej të merrte parasysh të përdorte të paktën pjesën më të madhe të llogarisë së tij rrjedhëse për të shlyer borxhin, për të cilin më kujtoi se kishte punuar shumë. Hoqa dorë pas një ore tjetër dhe shkova në shtëpi. Ai mashtronte veten; nuk kishte asnjë siguri në përpjekjen për t’i mbajtur

ato para në llogarinë e tij rrjedhëse. Oh, e di që ndihej mirë kur i vinte deklarata me postë ku thuhej se kishte 40 000 dollarë në bankë. Por për të krijuar një tablo të vërtetë të gjendjes së tij, atij iu desh të hapte edhe faturat e kartës së kreditit.

Kënaqësia është madhështore dhe mund të të joshë në një ndjenjë të rreme sigurie. Ti duhet të jesh largpamës dhe të dish se ajo që sapo konsumove nuk do të mund të të sigurojë atë që do të të duhet pas pak orësh. Do të jesh sërish i uritur. Nëse po kërkon vetëm zgjidhjen e shpejtë, kënaqësinë e shpejtë të providencës, do të humbasësh të vetmen gjë që mund ta ndryshojë në të vërtetë jetën tënde: racioni i dyfishtë.

Ndërkohë që rriteshim në sistemin financiar të mallkimit të tokës me mund e djersë, ëndërruam një gjë, të ndalnim! E përmenda këtë në një kapitull të mëparshëm. Ne nuk ëndërronim për më shumë punë apo një mundësi tjetër, sepse, sinqerisht, tashmë ishim të mbingarkuar nga jeta dhe thjesht po mbaheshim fort deri në pushimet e radhës. Pra, skllëverit nuk ëndërrojnë më shumë punë. Skllëverit ëndërrojnë një gjë: natën e së premtes, jo mëngjesin e së hënës. Pse? Sepse skllëverit ëndërrojnë vetëm një gjë – të ndalojnë. Dëgjo, mendësia e të qenit i mbingarkuar dhe “mezi pres të ndaloj” nuk do të të çojë askund. Edhe nëse një engjëll do të të vinte në dhomën tënde të gjumit dhe do të të tregonte një ide nga Zoti, mendja jote do të të pengojë. Mbaje shënim këtë.

NË MËNYRË QË TË ARRISH RACIONIN E DYFISHTË: DUHET TË SHOHËSH PËRTEJ TË QENIT I PLOTËSUAR!

Kjo deklaratë është çelësi i racionit të dyfishtë. E di që nuk ka shumë kuptim tani, por do të ketë. Për të ta treguar se çfarë dua të them, dua t'i hedh një vështrim më shumë historisë së ushqyerjes së 5000 njerëzve nga libri i Gjonit, dhe jo nga libri i Markut. Në këndvështrimin e

Gjonit për tregimin, gjejmë të njëjtën histori, por me disa hollësi që nuk i gjejmë në variantin e Markut.

Pastaj Jezusi mori bukët dhe, pasi falenderoi, ua ndau dishepujve dhe dishepujt njerëzve të ulur; të njëjtën gjë bënë edhe me peshqit, aq sa deshën. Dhe mbasi ata u ngopën, Jezusi u tha dishepujve të vet: "Mblidhni copat që tepruan, që të mos shkojë dëm asgjë".

- Gjoni 6:11-12

Në këtë version të tregimit, ne shohim se ishte Jezusi që u tha atyre të shkonin dhe t'i mblidhnin copat, ose tepricat, dhe të mos shpërdoronin asgjë. Dua që ta kuptosh këtë. Atij iu desh t'ua thoshte ta bënin këtë sepse ata nuk e kuptuan mundësinë. Vendose veten në vendin e tyre. Je i plotësuar dhe i kënaqur dhe gjithçka që dëshiron të bësh është të shtrihesh dhe të marrësh një sy gjumë. Për shkak se je trajnuar për mallkimin e tokës dhe mendësinë e skllavit, kur ndihesh i kënaqur, është koha të ndalosh. Pra, mendësia e skllavit funksionon vetëm kur duhet, dhe kur nuk duhet, kur ngopet, ndalet. Jezusit iu desh t'ua thoshte ta mblidhnin atë që ishte pikërisht para syve të tyre. Copat ishin përreth tyre në tokë, por ata nuk bënë asnjë përpjekje për t'i marrë. Por gjithsesi, në mendjet e tyre, për çfarë vlenin copat veçse që t'u liheshin zogjve?

Jezusi po përpiqej t'u mësonte atyre diçka, diçka shumë të rëndësishme. Jezusi bën një koment pasi u thotë të mbledhin copat, që të mos shkojë dëm asgjë! Por çfarë do të thotë kjo? Të gjithë janë të ngopur, të gjithë janë të kënaqur dhe askush nuk dëshiron më shumë bukë dhe peshk, të paktën tani. Por këtu është problemi - nuk ka pushim shabati pa mbledhur më shumë nga sa të nevojitet. Kur izraelitët mblodhën manën në ditën e gjashtë, ata u udhëzuan të mblidhnin më shumë se ç'duhej. Mbledhja e më shumë se ç'duhej në atë ditë u bë providenca e tyre për ditën e shtatë, ditën e pushimit. Jezusi po i mësonte dishepujt e Tij të shikonin përtej të qenit të kënaqur dhe të shihnin sigurinë e plotë të Mbretërisë. E përsëris, të qenit i kënaqur nuk ndërton, kurse racioni i dyfishtë po. I kënaquri ka konsumuar bukën e të sotmes, por 12 koshat e mbetura të japin mundësi për nesër.

Këtu gjendet parimi kryesor që dua që ta shohësh.

Megjithëse dishepujt nuk i panë copëzat derisa Jezusi ua vuri në dukje, Perëndia ua **kishte dhënë tashmë pushimin e shabatit**, racionin e dyfishtë. Ata thjesht nuk e panë atë. Mbretëria e kishte siguruar tashmë ushqimin, shumëfishuar bukën dhe peshqit dhe ushqyer të gjithë ata njerëz, por Mbretëria e siguron gjithmonë racionin e dyfishtë. Perëndia nuk do të sigurojë asnjëherë vetëm sa për të ngopur; **Ai gjithmonë do të ofrojë më shumë se sa duhet**. Problemi është se ti mund të mos e shohësh atë!

Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t'ju derdhet në gj, sepse me atë masë që do të matni, do t'ju matet edhe juve gjithashtu"

- Lluca 6:38

Jepni dhe do t'ju jepet, një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur. Por ky varg nuk mbaron këtu. Masa e ngjeshur dhe e tundur është providenca jote për atë ditë. Por vargu vazhdon duke thënë, "gufuese!" Gufimi është racioni i dyfishtë. Perëndia e siguron gjithmonë racionin e dyfishtë, asnjëherë vetëm mjaftueshëm!!!! Por nëse nuk e kishe vënë re këtë dhe drithi po gufon, lëre të bjerë në tokë sikur të ishe plotësisht i përqendruar në pjesën e kënaqësisë para teje dhe i papërgatitur për të kapur atë që do të derdhet. Duke vepruar kështu, nuk do të arrish ta kapësh dhe shijosh racionin e dyfishtë. Por, nëse e ke kuptuar se si funksionon Mbretëria, duke ditur dhe duke parashikuar providencën e plotë, do të ishe i përgatitur për të vepruar dhe marrë gjithçka që ofron Perëndia.

Më lejo të të jap një shembull tjetër.

Dhe Simoni, duke u përgjigjur, i tha: "Mësues, u munduam gjithë natën dhe nuk zëmë asgjë; por, për fjalën tënde, do ta hedh rrjetën. Dhe, si bënë kështu, zunë një sasi aq të madhe peshku, sa po shqyhej rrjeta. Atëherë u bënë shenjë shokëve të tyre që ishin në barkën tjetër, që të vinin e t'i ndihmonin. Dhe ata erdhën dhe i mbushën të dy barkat aq sa gati po fundoseshin. Simon Pjetri, kur pa këtë, i ra ndër këmbë Jezusit dhe i tha: "Zot, largohu prej meje,

sepse jam njeri mëkatar”. Në të vërtetë Pjetri dhe të gjithë ata që ishin me të, habiteshin për shkak të sasisë së peshkut që kishin zënë. E njëjta gjë u ngjau edhe Jakobit dhe Gjonit, bijve të Zebedeut, që ishin shokë të Simonit.

- Lluca 5:5-10

Kjo është një pjesë e historisë që e lexuam më parë. Pjetri kishte dy varka që pothuajse u fundosën me peshq për shkak të Mbretërisë. Kjo binte në kundërshtim me njohurinë e tij rreth peshkimit dhe e habiti atë. Por çfarë do të ndodhte herën tjetër që Jezusi do të thoshte: “Hej, Pjetër, dil atje në ujërat e thella dhe do të mund të kapësh peshq sa të duash?” A mendon se ai do të merrte dy varka? Dyshoj. Ai do të mblidhte sa më shumë varka që mund të merrte hua nga miqtë e tij. Pse? Sepse ai do të kishte një pritshmëri dhe njohuri tjetër për mënyrën se si funksionon Mbretëria.

Qëllimi i gjithë këtij diskutimi është të sigurohem që e kupton se ti nuk po e sheh të gjithë providencën që po dërgon Zoti. Natyrisht, në pjesën më të madhe të kohës kjo providencë nuk do të jetë në formën e kartëmonedhave të dollarit. Por do të jetë në formën e ideve, caktimeve hyjnore dhe drejtimit nga Fryma e Shenjtë. Nëse nuk jemi të përgatitur me një kuptim të duhur të racionit të dyfishtë, ne thjesht do t’u qasemi, sepse aq lejon trajnimi ynë për mbijetesë në mallkimin e tokës.

Në historinë e shumëzimit të bukës, Jezusi po përpiqet t’u mësojë dishepujve të Tij se si funksionon Mbretëria, çfarë të presin dhe çfarë të parashikojnë. Për shkak se mendësia e tyre e skllavërisë nuk e shihte potencialin e gjithë bukës që gjendej përreth, Atij iu desh t’i udhëzonte që të shikonin: “Çfarë shihni? Shikoni! Ju nuk po i shihni të gjitha ato që Perëndia i ka përgatitur për ju.”

Dua të të kujtoj për një çast Eksodin 16, pasi ka edhe një gjë tjetër që dua të vë në dukje.

Kështu e mblidhnin çdo mëngjes; secili sipas nevojës së tij për ushqim; por kur dielli bëhej i nxehtë, mana e mblodhur shkrihej. Kështu ditën e gjashtë mblodhën një racion të dyfishtë buke, dy omerë për secilin prej tyre. Dhe të gjithë krerët e asamblesë erdhën

për t'ia referuar Moisiut. Atëherë ai u tha: "Kjo është ajo që ka thënë Zoti: Nesër është një ditë solemne pushimi, një e shtunë e shenjtë për Zotin; pignu sot atë që duhet të pignu dhe zieni atë që duhet të zieni; dhe çdo gjë që ju tepron, vëreni mënjanë dhe ruajeni deri nesër".

Ata pra e ruajtën deri të nesërmen, ashtu si kishte urdhëruar Moisiu; dhe ushqimet e ruajtura nuk lëshuan erë të keqe dhe nuk prodhuan krimba. Moisiu tha: "Hajeni sot, se sot është e shtuna e shenjtë e Zotit; sot nuk do ta gjeni nëpër fushat. Mblidhni gjatë gjashtë ditëve; sepse ditën e shtatë nuk do ta gjeni më".

Dhe ditën e shtatë ndodhi që disa njerëz nga populli dolën për ta mbledhur, por nuk e gjetën. Atëherë Zoti i tha Moisiut: "Deri kur do të kundërshtoni të zbatoni urdhërimet e mia dhe ligjet e mia? Mos harroni që Zoti ju ka dhënë të shtunën; për këtë arsye ditën e gjashtë ju jep bukë për dy ditë. Secili të qëndrojë në vendin e tij; asnjëri të mos dalë nga çadra e tij ditën e shtatë". Kështu populli pushoi ditën e shtatë.

- Eksodi 16:21-30 (mana)

Siç e kemi thënë, racioni i dyfishtë është ai që e bëri të mundur pushimin e shabatit. Por çuditërisht, megjithëse Perëndia e kishte dhënë tashmë racionin e dyfishtë ditën e gjashtë, shumë prej tyre dolën duke e kërkuar dhe nuk gjetën asgjë në ditën e shabatit. Jo se Perëndia nuk ishte besnik për ta siguruar atë. Ata thjesht nuk e panë atë sepse nuk kishin një kuptueshmëri të duhur të racionit të dyfishtë të dhënë tashmë në ditën e gjashtë. Ata kishin mbledhur mjaftueshëm vetëm për një ditë, si zakonisht. Tani, duke qenë të uritur në ditën e shtatë, nuk gjetën fare. Ndoshta nga këndvështrimi i tyre Perëndia i kishte braktisur. Por Perëndia nuk i kishte braktisur; ata thjesht nuk kishin qenë të vetëdijshëm për parimin e racionit të dyfishtë. Po do ta kishin ditur, do të kishin planifikuar ndryshe.

Sa njerëz sot enden përreth duke u përpjekur të gjejnë atë që u nevojitet, pa e kuptuar se Perëndia e ka dërguar tashmë? Mendoj se është me të vërtetë interesante në këtë fragment që Perëndia në fakt është i zemëruar që ata nuk mblodhën sa duhet!!!! Pyes veten se si do të predikohej kjo në kishat tona.

Edhe ai që i jep farën mbjellësit dhe bukë për të ngrënë, ju dhëntë dhe e shumoftë farën tuaj, dhe i bëftë të rriten frytet e drejtësisë suaj; dhe atëherë do të pasuroheni për të qenë dorëdhënë, duke i sjellë nëpërmjet nesh falënderim Perëndisë.

- 2 Korintasve 9:10-11

Pali është mjaft i qartë këtu, ndërsa e shpjegon ndikimin e Mbretërisë së Perëndisë rreth të pasuruarit në çdo mënyrë, që të mund të jesh bujar në çdo rast. Miku im, kjo kërkon racionin e dyfishtë. Nuk mund të jesh bujar në çdo rast nëse nuk ke më shumë se mjaftueshëm.

Në një kapitull të mëparshëm, të tregova se si biznesi im kaloi nga një nivel prodhimi prej 3 deri në 4 milionë dollarë në vit me një nga shitësit tanë në mbi 11 milionë në vit me të njëjtin shitës. E gjithë kjo rritje ndodhi brenda vetëm një viti. Të tregova gjithashtu se si ndodhi kjo, se si Perëndia më dha një ëndërr natën dhe më tha se si ta bëja. Por tani më duhet të ta tregoj atë që më tha, sepse tani do të ketë kuptim për ty. Në ëndërrën time, Ai më dha thjesht dy fjalë (tre në anglisht). Po pra, vetëm dy fjalë. Ato dy fjalë ndryshuan të ardhurat e mia me qindra mijëra dollarë atë vit pa bërë më shumë marketing ose reklama sesa po bëja tashmë. Nuk ndryshova asgjë në lidhje me funksionimin e kompanisë sime, përveç vetes sime. Ato dy fjalë më udhëzuan për të ndryshuar mënyrën se si unë personalisht po bëja diçka dhe ai ndryshim e katërfishoi biznesin tonë dhe të ardhurat e mia. “Cilat janë dy fjalët?” mund të pyesësh. Thjesht këto: Kape momentin!

Po, kape momentin. “Kaq është? Këto dy fjalë i bënë të gjitha këto?” Po, ato e bënë. Pasi ta kuptosh se Perëndia dërgon GJITHMONË racionin e dyfishtë me providencën e Tij, do të kuptosh se çfarë po më thoshte Ai.

Kompania ime, si të gjitha kompanitë e shitjeve, e nxjerr fitimin e saj duke i ndihmuar njerëzit. Sa më e aftë të jetë një kompani për t’i ndihmuar njerëzit, aq më shumë para do të fitojnë ata. Edhe pse kjo është e vërtetë, është gjithashtu e vërtetë se shumë kompani shitjesh nuk arrijnë t’i përmbushin nevojat e klientëve të tyre ose për shkak të ndjekjes dhe shërbimit të dobët ndaj klientit ose mungesës së ndjekjes dhe fitimit të klientëve të rinj për firmën.

Në rastin tonë, ne ishim jashtëzakonisht të zënë dhe, megjithëse kjo nuk ishte një gjë e keqe, ndonjëherë nuk arrinim të përgjigjeshim brenda kohës më të shkurtër që do të kisha dashur për klientët tanë. Unë personalisht punoj me klientët tanë të investimeve dhe më pëlqen. Por për shkak të orarit tim, kur një klient i mundshëm investimi më telefonon dhe ma kalojnë për ta kontaktuar personalisht, ndonjëherë nuk arrij ta telefonoj brenda 24 orëve të para. Synimet e mia janë të mira, por thjesht nuk arrij që ta bëj.

**ZOTI PO MË THOSHTË SE
PJESA GUFUESE, PUSHIMI I
SHABATIT, ISHTE TASHMË
I SIGURUAR. UNË THJESHT
NUK PO E SHIKOJA ATË!**

Siç e di, kur njerëzit bëjnë pyetje, kompania që do ta fitojë biznesin e tyre është ajo që u jep përgjigje. Ndonjëherë vonesa për ta telefonuar një klient të mundshëm për të diskutuar për nevojat e tij personale për investime mund të jetë shumë vonë. Ai mund të ketë telefonuar dikë tjetër që ishte më i gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve. Ka shumë gjëra që mund të shkojnë keq, por zgjidhja do të ishte t'u gjendesh njerëzve me përgjigjet për ato që duan të dinë.

Pra, kur Zoti m'i dha ato dy fjalë, e kuptova se çfarë do të thoshte. Më duhej t'i shikoja gjërat ndryshe nëse vërtet doja të ngjitesha në atë skenë, ndër 10 të më mirët dhe do të merrja atë bonus prej 100 000 dollarësh. Më duhej të kapja momentin! Prandaj bëra një ndryshim në mënyrën se si i bëja gjërat. Vendosa rregullin që, nëse dikush më telefononte për këshilla investimi, unë do t'i telefonoja brenda disa minutash, nëse ishte e mundur, dhe do ta takoja menjëherë. Klientët e mi janë të shpërndarë në të gjithë vendin dhe ky ishte angazhimi më i vështirë për t'u mbajtur. Por unë u zotova për ta mbajtur. I telefonova menaxherit të kompanisë sime dhe i thashë atë që kishte thënë Zoti dhe i thashë që t'u thoshte të gjithë përfaqësuesve të mi që të kishin të njëjtin qëndrim për të shfrytëzuar çdo mundësi kur të shfaqej. Në fund të vitit, ne i fituam më shumë se 11 milionë që kërkoheshin për të qenë ndër 10 më të mirët për atë shitës. Por përveç kësaj, ne kishim siguruar edhe biznese shtesë prej milionash për shitësit tanë të tjerë.

Këtu gjendet momenti i madh i zbulimit. Ne nuk bëmë asgjë

ndryshe, por thjesht reaguam shpejt kur merrte një klient që donte të fliste me ne. Pra, Zoti po më thoshte se pjesa gufuese, pushimi i shabatit, ishte tashmë aty, Ai e kishte siguruar tashmë. Unë thjesht nuk po e shihja!

Pra, nuk ekziston një ligj i racionit të dyfishtë të Mbretërisë lidhur me mënyrën se si të vësh në lëvizje racionin e dyfishtë. Racioni i dyfishtë është gjithmonë aty. Perëndia siguron gjithmonë në nivelin e racionit të dyfishtë.

PERËNDIA NUK TË DËRAGON KURRË PROVIDENCË VETËM PËR SOT. AI GJITHMONË E DËRAGON RACIONIN E DYFISHTË ME TË!

E përsëris, problemi ynë është se ne nuk e shohim racionin e dyfishtë.

Por problemi më i madh ishte se nuk dinim as ta kërkonim!!!!

Më pëlqen ajo që tha Jezusi: “Të mos shkojë dëm asgjë!” Perëndia e dërgoi të gjithën dhe Ai dëshiron që ti ta kesh atë. Ai u mërzit që njerëzit po kërkonin manën ditën e shtatë, ndërkohë që Ai e kishte dërguar tashmë. Ai ia kujtoi Moisiut se e kishte dërguar atë në ditën e gjashtë që ata të mund ta mblidhnin dhe të shijonin pushimin e shabatit. Në thelb, Ai po u thoshte atyre: “Shabati nuk është për mua, është për ju. Prandaj ju dërgova racionin e dyfishtë.” Të duket sikur mund ta dëgjosh Jezusin duke thënë të njëjtën gjë. “Hej djema, mblidhni ato copa dhe merrini të gjitha. Perëndia jua dërgoi që ta merrni, që ta shijoni racionin e dyfishtë dhe të gjeni prehje.”

Në historinë e Jezusit që ushqeu 5000 veta me pesë bukët dhe dy peshqit, dishepujt nuk i panë tepricat. Ata as që i kërkonin. Por Jezusi u tha atyre se çfarë të mblidhnin dhe të korrat nuk humbën. Sot Fryma e Shenjtë duhet të na ndihmojë të shohim përtej të qenit të kënaqur dhe të kapim racionin e dyfishtë. Ai do të na vërë në dukje gjëra që nuk po

i shohim nëse do t'ia kërkojmë. Çelësi që shpresoj të kesh mësuar deri tani është se racioni i dyfishtë tashmë të është dhënë; por vetëm duhet ta marrësh atë.

Për shkak se racioni i dyfishtë është I VETMI shpëtim nga sistemi i mallkimit të tokës me mund e djersë, Satani e urren atë. Oh, ai mund të përpiqet t'i bindë të krishterët se nëse po i paguajnë faturat e tyre, po bëjnë dy punë për ta përballuar jetën, janë në rregull. Por një i krishterë që ka para për të mbështetur Mbretërinë e Perëndisë dhe jeton i lirë nga frika dhe shqetësimet financiare, ky po që është një person që ai dëshiron ta ndalojë. Synimi i Satanit është të të mbajë të falimentuar gjatë gjithë ditëve të jetës sate dhe skllav të një mënyrë jetese thjesht për mbijetesë ku nuk ke asnjë ndikim. Paraja është ndikim! Me siguri Satani do të donte të t'i pengonte bekimet e Perëndisë. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme që ta kuptosh atë që do të të them pas pak.

Racioni i dyfishtë është i fshehur!

Mirë, është koha për t'i lënë mënjane dishepujt. Kishte një arsye pse ata nuk e panë pjesën gufuese. Epo, sigurisht, siç kemi thënë, ata nuk po shikonin, por në fakt kishte një faktor tjetër. Zakonisht nuk i mbledhim tepricat! Dua të them, në mendjet e tyre, copat e bukës dhe të peshkut të lëna përreth ishin thjesht mbeturina.

Pse monedha që Pjetrit i duhej për të paguar taksat ishte e fshehur në gojën e një peshku? Kujt do t'i shkonte mendja ta kërkonte atje? Kujt do t'ia merrte mendja se dy varka me peshkatarë profesionistë që kishin peshkuar gjithë natën

dhe nuk kishin zënë asgjë, do të kapnin sasinë më të madhe të peshkut të jetës së tyre me fjalën e një rabini? Kush do ta mendonte se gruaja te 2 Mbretërve 4, e cila nuk kishte para, asgjë në shtëpinë e saj, përveç

**SYNIMI I SATANIT ËSHTË TË
TË MBAJË TË FALIMENTUAR
GJATË GJITHË DITËVE TË
JETËS SATE DHE SKLLAV
TË NJË MËNYRË JETESE
THJESHT PËR MBIJETESË KU
NUK KE ASNJË NDIKIM.**

pak vaji dhe në buzë të falimentimit, do të kishte në një farë mënyre aq shumë vaj sa të shlyente të gjithë borxhin e saj dhe të mund të jetonte pa borxhe?

Askush nuk do ta mendonte. Kush do ta kishte menduar se Gary Keesee, i cili u diplomua i parafundit i klasës së tij, do të ishte një milioner sot dhe do t'u fliste mijëra njerëzve në mbarë botën çdo ditë? Askush! Në të gjitha këto histori, Perëndia e përdori të papriturën për të ndryshuar situatën përreth.

Nëse gufimi, racioni i dyfishtë do të ishte i dukshëm, i lënë në vend të hapur, Satani do ta kishte parë dhe do të ishte munduar ta pengonte dhe ta vidhte atë. Kjo është arsyeja pse Perëndia nuk i zbulon hapur thesaret e Tij. Ato janë të fshehura. Satani nuk e duron që ti të jesh i kënaqur dhe të shijosh providencën, sepse ai me të vërtetë e urren nëse ti e merr pjesën që gufon dhe pushimin e shabatit.

Më lejo të tregoj diçka që duhet ta kuptosh në lidhje me mënyrën se si vepron Perëndia në mbretërinë e tokës.

Dhe ne flasim dituri në mes njerëzish të pjekur, por jo diturinë e kësaj kohe dhe as të pushtetarëve të kësaj kohe, që nuk arrin asgjë, por flasim diturinë e Perëndisë të fshehur në mister, që Perëndia e kishte paracaktuar përpara kohërash për laudinë tonë.

- 1 Korintasve 2:7-8

Ky fragment na tregon qartë se, nëse Satani do ta kishte ditur planin e Perëndisë, ai do ta kishte ndryshuar taktikën! Kjo është arsyeja pse Perëndia duhet të punojë në fshehtësi. Satani do të reagonte ndaj çdo gjëje të dukshme. Providenca jote e bollshme nuk mund të bëhet e dukshme deri në momentin që ti do ta marrësh dhe mbledhësh atë për të njëjtën arsye. Kam një thënie që e them prej vitesh. Thesaret e Zotit janë të fshehura, jo nga ti, por për ty.

Fshehur nga ti për ty!

Shumë njerëz më thonë se dëshirojnë që Perëndia të mos priste deri në orën e mesnatës për t'i sjellë përgjigjet e Tij. Por miku im, Perëndia

nuk është i shqetësuar. Ai e di se kur skadon fatura dhe është në dobinë tënde që Perëndia të mos e tregojë dorën e Tij shumë herët që të mos e pengojë Satani.

Do të të jap thesaret e territ dhe pasuritë e fshehura në vende të fshehta, me qëllim që ti të njohësh që unë jam Zoti, Perëndia i Izraelit, që të thërret me emër.

- Isaia 45:3

Pasuri të ruajtura në vende të fshehta? Hej, ky është më i mirë se skenari më i mirë i një filmi të Hollivudit. Më lejo të të jap një shembull se si Perëndia më ndihmoi ta merrja racionin e dyfishtë në jetën time si sipërmarrës. Vite më parë, isha ulur duke parë deklaratën vjetore të fitimeve dhe humbjeve të kompanisë sime të shërbimeve financiare. Megjithëse isha i kënaqur, nuk kisha borxhe dhe kisha ca para në bankë, e dija që kishte më shumë. Pashë kaq shumë projekte që doja t'i finançoja në Mbretëri, aq shumë për të bërë dhe të gjitha kushtonin para.

Ndërsa u luta për të, Zoti filloi të punonte me mua për termin *teprica*. Në fillim nuk e kuptoja se çfarë po thoshte, por duke u lutur gjatë dhe duke dëgjuar, e kuptova. Tepricat si në historinë që sapo lexuam u anashkaluan. Ato shiheshin si të pavlefshme - ose për shkak të energjisë që do të duhej për t'i mbledhur ndërkohë që perceptoheshin si të pavlefshme, ose ngaqë vlera e tyre bazohej në një sistem vlerash të vjetruar. Ose ndoshta, një perceptim i gabuar dhe i kufizuar i përdorimit të tyre të mundshëm e kufizoi kuptueshmërinë e rritjes së mundshme të vlerës së tyre nga ai që ishte perceptimi i tyre aktual.

Jam i sigurt se keni dëgjuar njerëz ta thonë shumë herë këtë gjë: "Kjo është mënyra se si e kemi bërë gjithmonë." Epo, mund të të them se racioni i dyfishtë mbase nuk do të vijë kështu.

Ndërsa i pashë të dhënat, Zoti m'i hapi sytë ndaj shumë tepricave që po lija në tavolinë, të cilat duhej t'i merrja. Një nga prioritetet që kemi për çdo klient është të bëjmë një profil të plotë të të dhënave për të për të parë se çfarë asetesh mund të ketë si dhe të borxhit. Më pas, bëjmë një analizë për të kërkuar çdo vlerë monetare që mund ta ripozicionojmë

për të eliminuar borxhin. Sigurisht, në fletën e të dhënave shënojmë statusin aktual të hipotekës dhe normën e interesit, duke përfshirë kushtet e kredisë. Në atë kohë, ne i këshillonim gjithashtu klientët tanë që të merrnin një lloj kredie me kolateral shtëpinë për të shlyer borxhin e kartës së kreditit me normë të lartë interesi, duke ulur kështu normën e tyre neto të interesit nga një normë tipike 21% në një normë 6% në atë kohë. Kjo manovër i siguron familjes mesatare një kursim 500 deri në 600 dollarë në muaj. Kur shfaqej kjo situatë, ne i kthenim klientët tanë në bankat e tyre për të siguruar kredinë e konsolidimit të borxhit.

Ndërsa po i studioja të dhënat, Fryma e Shenjtë ma vuri në dukje një çështje të hipotekës. “Pse nuk e trajton atë çështje të hipotekës?” E mendova dhe kishte kuptim. Ne e kishim besimin e klientëve; ne i kishim të dhënat e tyre; dhe në fund, ne ishim ata që po sugjeronim që në radhë të parë të rifinanconin borxhin e tyre.

Për të zhvilluar këtë aspekt të biznesit do të më duhej të mësoja një biznes krejtësisht të ri, të kaloja kurse licencimi dhe trajnimi dhe shumë më tepër. Thjesht nuk kisha kohë për t’i bërë të gjitha këto. Por ndërsa vazhdova të lutem për këtë, Zoti më nguliti mbresën që të punësoja dikë tjetër për të krijuar dhe drejtuar kompaninë time hipotekore, gjë që bëra. Përballimi i punës së hipotekës vetë në atë vit të parë solli një të ardhur neto shtesë prej 160 000 dollarësh. Këto ishin para që nuk do t’i kisha pasur kurrë nëse nuk do ta kisha lejuar Frymën e Shenjtë të vinte në dukje një tepricë që e kisha para syve, por nuk e kisha parë kurrë.

Vazhdova të kapja shumë elemente të tjera që përbënin tepricat që më tregoi Fryma e Shenjtë. Një tepricë që po anashkaloja, për shkak të ideve paragjyquese që kisha mësuar ose dëgjuar nga njerëz të tjerë që thoshin se nuk ia vlente të përfshihesha në atë fushë, u bë një sukses i madh për ne. Kur më në fund u ula dhe e pashë, kuptova se të gjitha informacionet që kisha dëgjuar për këtë fushë prodhimi ishin të gabuara dhe ishte, në fakt, një përshtatje e shkëlqyer për kompaninë tonë. Maje, ajo tepricë ka prodhuar më shumë të ardhura sesa modeli im kryesor i biznesit, duke sjellë miliona dollarë. Ishte me të vërtetë një tepricë shumë miliona dollarëshe!

Prandaj më lejo të ta bëj shumë të qartë. Racioni i dyfishtë kapet përmes zbulesës! Zbulesa është thjesht diçka që Fryma e Shenjtë po

të tregon, të cilën nuk do ta kishe kuptuar vetë. Pra, Fryma e Shenjtë zbulon ose hap sytë e tu për diçka që nuk e dije. Kjo quhet njohuri e zbuluesës.

Zbulesa është çelësi i racionit të dyfishtë!

Më pas njerëzit më pyesin: “Si ta dëgjoj Frymën e Shenjtë? Si mund të dëgjoj se si t’i arrij këto ide dhe mundësi të fshehura?” Pyetje të shkëlqyera. Nuk kam kohë në këtë libër për të folur me hollësi në lidhje me dëgjimin e zërit të Perëndisë. Prandaj do të të drejtoj te një libër tjetër që kam shkruar, me titull, *Pagëzimi i Frymës së Shenjtë*. Mund ta blesh përmes Amazon ose faqes sonë të internetit. Në atë libër, ti do të gjesh më shumë informacion në lidhje me mënyrën se si punon Fryma e Shenjtë për të na zbuluar planet e fshehura të Perëndisë, në mënyrë që ne të mund të përparojmë pikërisht këtu në mbretërinë e tokës, pikërisht nën hundën e Satanit; dhe ai nuk mund të bëjë asgjë për këtë. Por për të të drejtuar në drejtimin e duhur, le t’i hedhim një sy vargut te **1 Korintasve 14:2**.

Sepse ai që flet një gjuhë tjetër nuk u flet njerëzve, por Perëndisë; sepse askush nuk e kupton, por ai në frymë flet mistere.

Vargu 4 thotë:

Ai që flet një gjuhë tjetër ndërton veten e tij.

Fjala “ndërtoj” do të thotë të sjellësh udhëzim ose kuptueshmëri. Unë kam nevojë për të, edhe ti gjithashtu. Kur Bibla flet këtu për të folurit në gjuhë ose, siç e përshkruan Pali, për t’u lutur në Frymë, unë dua të të inkurajoj që, pavarësisht se çfarë ke dëgjuar për këtë funksion të Frymës së Shenjtë, nëse dikush të ka thënë se ka kaluar bashkë me apostujt ose se është nga djalli, lexoje Biblën tënde! Të lutesh në Frymë është thjesht Fryma e Shenjtë që lutet nëpërmjet teje në mbretërinë e tokës për të kryer vullnetin e Tij, pa dijeninë e djallit për atë që po ndodh. Lutja në Frymë është një çelës kryesor për të dëgjuar zbuluesë

nga qielli dhe unë të inkurajoj ta studiosh atë që kam thënë. Dhe nëse ke pyetje, merre librin tim dhe e di se do të të ndihmojë të fitosh më shumë njohuri mbi këtë funksion të mahnitshëm të Frymës së Shenjtë në jetën tonë.

Dëshiroj ta përfundoj këtë libër me dy vargje të shkrimit të shenjtë që përmbledhin në thelb këtë kapitull.

Tani atij që, sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë, atij i qoftë laudia në kishën në Krishtin Jezus për të gjitha brezat, në jetë të jetëve. Amen.

- Efesianëve 3:20-21

Asnjëherë nuk mund të kërkosh diçka që nuk e ke menduar. Aktualisht kam dy aeroplanë, një aeroplan më të vogël që e përdor për argëtim dhe aeroplanin tim të biznesit me të cilin fluturoj anembanë vendit. Kur po mendoja të blija një aeroplan për biznes, u trondita nga çmimi. Aeroplanët nuk janë të lirë! Fillova të përgatitem dhe të mendoj: “Mund të punoj edhe pa aeroplan. Në fund të fundit, janë shumë para.” Por unë fluturoja çdo javë në linja ajrore komerciale dhe në një muaj fluturova 23 herë. Ishte rraskapitëse. Po, mund të them se kam pasur providencë. Të gjitha fluturimet e mia ishin të paguara; paratë për të paguar për to nuk përbënin problem. Por udhëtimi im me linja ajrore ishte bërë gjithçka tjetër veçse çlodhës. Fluturimet anuloheshin ose vonoheshin dhe ishte një kokëçarje. Ky nuk ishte pushimi i shabatit që më duhej.

Më në fund, pranova se në këtë rast po e kufizoja Perëndinë. Ai është Perëndia i racionit të dyfishtë. Më vjen keq ta them se Drenda dhe unë u lëkundëm për më shumë se një vit për blerjen e aeroplanit. Më në fund, Perëndia na tërhoqi vëmendjen në atë aeroplan dhe na tha se kishte dy vjet që po përpiqej të na e jepte atë aeroplan! U penduam dhe e morëm vendimin tonë. Ne mbollëm farën tonë për aeroplanin e duhur për punë që e donim dhe na nevojitej; dhe pasi e bëmë, e morëm brenda dy muajsh. Gjatë asaj kohe, Perëndia më dha njohuri dhe hir për disa marrëveshje biznesi dhe paratë ishin aty kur më duheshin.

Po, Perëndia është Perëndia i racionit të dyfishtë. A solli kjo ndonjë ndryshim? Epo, ndryshimi që solli në jetën time mundësia për ta përdorur aeroplanin tim në vend të fluturimeve komerciale do të ishte si ta krahasosh me ngarjen e biçikletës ose ngarjen e një makine për në një takim 80 km larg. Vërtet! Dhe Perëndia kishte dy vjet që përpiquej të ma jepte atë, ndërsa unë thjesht shihja se isha i ngopur dhe vazhdoja i verbër ndaj racionit të dyfishtë që Perëndia kishte siguruar tashmë për mua. Thjesht duhej ta shihja.

Mbase ti po nget një makinë që ka aq shumë nevojë për riparim, saqë lutesh që të ndizet në mëngjes. Ndalo së pari llogarinë e zbrazët bankare dhe së marri vendime për mbijetesë bazuar në këtë. Në vend të kësaj, lëre Perëndinë e racionit të dyfishtë të të tregojë tepricat, gjërat e fshehura që duhet të dish për të qenë i lirë dhe për të shijuar paqen dhe pushimin e shabatit. Ai do të ta japë planin dhe do të të tregojë si të veprosh nëse thjesht ia kërkon Atij. Siç tha Jezusi: “Të mos shkojë kot asgjë!” Racioni i dyfishtë është siguruar më parë për ty!

Mbetet, pra, një pushim i së shtunës për popullin e Perëndisë. Sepse kush ka hyrë në prehjen e tij, ka bërë pushim edhe ai nga veprat e veta, ashtu si Perëndia nga të tijat.

- Hebrejve 4:9-10

Unë besoj se ky libër ka qenë një bekim për ty dhe ecjen tënde me Zotin Jezu Krisht. Siç e thashë në libër, ky është i dyti në serinë “Revolucioni juaj financiar”. Do të jenë gjithsej pesë, kështu që vazhdo të kërkosh për librin tjetër në faqen tonë të internetit. Gjithashtu, konsideroje të bëhesh një anëtar i Team Revolution, programi ynë i mentorimit. Mund të gjesh gjithashtu më shumë informacion në lidhje me Team Revolution në faqet tona të internetit.

Gary dhe Drenda Keesee zotërojnë dhe operojnë “Forward Financial Group” në New Albany, Ohajo, 1-(800)-815-0818.

Gary dhe Drenda Keesee drejtojnë kishën “Faith Life Church” në New Albany, Ohajo.

Për materiale të tjera nga Gary dhe Drenda Keesee, shko te faqja FaithLifeNow.com, GaryKeesee.com, ose Drenda.com.

Tituj të tjerë nga Gary Keese:

- Fuqia e Besnikërisë
- Power of Strategy
- Power of Generosity
- Power of Provision
- Unfinished Business

Vizito **FLNFree.com**
për të shkarkuar
më shumë mësimë
në gjuhën tënde!



A dëshiron më tepër mësimë FALAS në gjuhën tënde?

Vizito **FLNFree.com**

REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Fuqia e Prehjes

A je i lodhur?

- I lodhur së renduri më kot?
- I lodhur se ndihesh sikur ke ngecur?
- I lodhur nga shqetësimet?
- I lodhur nga të mos qenit i lumtur?

Nuk ke pse jeton më kështu.

Bashkoju Gary Keesee në këtë rrugëtim të mrekullueshëm zbulimi, dhe MËSO NJË SISTEM TË RI – i cili do të revolucionojë jetën tënde, njësoj siç ndodhi me jetën e tij mbas nëntë vitesh lodhjeje dhe i rrënuar financiarisht, fizikisht, dhe emocionalisht.

Zbulo:

1. Si ndryshoi gjithçka për Gary-in – si kaloi të qenit tërësisht i dëshpëruar, financiarisht dhe fizikisht, në i shëndetshëm dhe i plotë, duke paguar kesh për makinat, duke ndërtuar shtëpinë e tij plotësisht i lirë nga borxhet, hapja e shumë kompanive, dhe mësimi i qindra mijërave për të jetuar në Mbretëri . . . për të jetuar në prehje.
2. Si gjithçka mund të ndryshojë edhe për TY – si mund të jetosh një jetë prehjeje.

Edhe nëse të gjithë ata që ti njeh po jetojnë të lodhur dhe vrapojnë për të mbijetuar, ti nuk ke pse të jetosh ashtu.

Duke kuptuar parimet bazë të Prehjes Shabatike, mund të shikosh rezultate reale në jetën tënde. Mund të jetosh në një vend ku nevojat e tua përmbushen; i lirë nga vrapimi pa rezultat; i lirë të gjesh dhe të kesh sukses në qëllimin dhe pasionin tënd, ku shkëlqen mbas mbijetesës; dhe ku i demonstroi botës rezultate që janë të ndryshme nga ato që shikon normalisht.

Mos qëndro i ngecur. Mos vazhdo të jetosh i lodhur.

Zbulo një mënyrë të re jetese!



Gary Keesee është një autor, folës, sipërmarrës, ekspert financiar, dhe pastor që ka një pasion për të ndihmuar njerëzit të jenë fitimtarë në jetë, veçanërisht në fushat e besimit, familjes, dhe financave. Gary dhe gruaja e tij, Drenda, kanë ngritur një sërë biznesesh të suksesshëm, dhe janë themelues të Faith Life Now, që prodhon dy programe televizive – Fixing the Money Thing dhe Drenda, marrin pjesë në konferenca kudo në botë, dhe kanë burime praktike. Çifti Keesee gjithashtu pastoron kishën Faith Life Church pranë Columbus, Ohio.